

# **Raport për Komisionin e Posaçëm të Reformës Territoriale**

## **Konsolidimi i Reformës Territoriale në Shqipëri**

**Tetor 2022**

## Tabela e Përmbajtjes

Falenderime.....	4
Ekipi .....	4
Pritshmëritë.....	5
I.    Përmbledhje Ekzekutive .....	6
Rekomandime .....	6
Fakte dhe shifra rreth Shqipërisë.....	7
II.   Hyrje .....	9
II.I    Momenti dhe arsyet për të rishikuar ndarjen territoriale.....	10
II.II   Parakushtet për rishikimin e reformës .....	11
II.III  Vlerësimi paraprak i ndikimit të reformës së rekomanduar .....	15
III.  Metodologjia.....	16
IV.   Pregatitja për rishikimin e reformës territoriale .....	17
IV.I    Kriteret për riorganizmin e ri territorial dhe prespektiva .....	19
IV.II   Praktikat e rishikimit dhe riorganizmit të territorit të vendeve të BE .....	26
IV.III  Vendimmarrja.....	33
V.    Analiza dhe hapat.....	34
1.    Identifikimi i qëllimeve të reformës në detaje dhe arsyet për rishikim.....	34
2.    Diagnoza e situatës aktuale dhe drithijet e reformës .....	34
3.    Kuadri metodologjik.....	35
4.    Fushat e identifikuar për tu analizuar .....	35
5.    Gjendja “ideale” ku duhet të arrijmë.....	35
V.I    Boshllëqe nga reforma e vitit 2014 dhe prespektiva.....	36
1.    Identifikimi i boshllëqeve.....	36
2.    Boshllëqet nga kufijtë territorialë administrativë .....	36
3.    Boshllëqet administrative .....	38
4.    Përmbledhje dhe analizimi i boshllëqeve dhe prespektivës .....	39
V.II   Pushteti ekonomik i bashkive.....	41
V.III  Çfarë pritet nga krijimi bashkive te reja? .....	42
-Shërbimet dhe funksionet e tjera.....	44
Përfaqësimi qytetar në vendimmarrje .....	44
Ngarkesa administrative në kolonat e arkitekturës së shtetit .....	45
Riorganizimi territorial përballë risqeve .....	45
Modeli dhe Nivelet e pushtetit vendor, boshllëku dhe prespektiva.....	45

VI	Reformimi i nivelit të dytë dhe rajonet zhvillimore.....	46
VI.I	Konfigurimi aktual .....	47
	Praktika në vende të ndryshme .....	48
	Kuadri ligjor për nivelin e dytë.....	48
	Konsolidimi i nivelit të dytë midis avantazheve dhe disavantazheve .....	49
	Perspektiva Evropiane .....	49
	Përgjegjësitë, funksionet dhe shpenzimet për nivelin e dytë.....	52
VII.	Reformimi i nivelit të parë.....	54
VII.I	Fakte shifra të dhëna krahasimore për bashkitë sot dhe pas ndryshimeve. 54	
	Ku ndodh riorganizimi i bashkive?.....	56
VII.II	Tipologjia e bashkive të reja.....	57
	Shpërndarja e popullsisë sipas qarqeve, numri i bashkive dhe popullsia mesatare për bashki .....	60
	Përfaqësimi zgjedhor në bashkitë e reja .....	62
VIII	Riorganizimi i nivelit të dytë .....	65
	Përfaqësimi politik i nivelit të dytë.....	67
IX.	Procesi i reformës dhe afati kohor.....	70
	-Përgatitja e dispozitave kalimtare.....	72
	-Zbatimi dhe vlerësimi .....	73
X.	Propozime dhe rekomandime konkrete mbi modelin e pushtetit vendor në Shqipëri .....	73
	<b>A: Sistemi territorial</b> .....	73
	<b>B: Sistemi Administrativ</b> .....	73
	<b>C: Sistemi Zgjedhor</b> .....	73
	<b>Opsionet për konsolidimin e pushtetit vendor</b> .....	75
Anekse	.....	81
	Harta me 6 rajone.....	100
	Harta me 3 rajone .....	101
	Termet e Referencës.....	102
Referenca	.....	104

## Falenderime

Dëshirojmë t'ju shprehim falenderime të gjithë bashkëpunëtorëve në të 12 qarqet, 61 bashkitë dhe njësitë administrative për mendimet, opinionet dhe sugjerimet e tyre mbi riorganizimin territorial të Shqipërisë.

Falenderimi shkon edhe për cilindo qytetar që është takuar nga ne dhe ata që na kanë kontaktuar për të dhënë mendime mbi këtë çështje.

Falenderimi shkon për të gjithë aktorët, institucionet, organizatat, universitetet, akademinë, bashkitë etj. që prezantuan dhe bënë sugjerime mbi dinamikën e qeverisjes vendore, nevojën për rishikime në aspektin administrativ dhe territorial të pushtetit vendor.

Një falenderim i veçantë shkon për anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës Territoriale dhe për kontributin e tyre, si dhe dy bashkëkryetaret e këtij Komisioni znj. Anila Denaj dhe znj. Dhurata Cupi.

## Ekipi

Ekipi i cili punoi mbi këtë studim për riorganizimin territorial të Shqipërisë përbëhej nga:

**Agron Haxhimali** Ekspert i Pushtetit Vendor, Profesor për qeverisjen vendore dhe legjislacionin urban në Universitetin Polis. Z. Haxhimali ka një eksperiencë shumë të gjatë në pushtetin vendor, në legjislativ dhe ekzekutiv, ka marrë pjesë në shumë reforma të pushtetit vendor në këto 25 vite, në hartimin e shumë ligjeve me ndikim në pushtetin vendor, dhe është autor i shumë studimeve dhe botimeve mbi qeverisjen vendore. Eksperiencat e tij në fushën e reformimit të pushtetit vendor dhe decentralizimit është evidente edhe jashtë Shqipërisë.

### **Ma. Roland Bejko**

Roland Bejko është pedagog në Kolegjin Universitar Luarasi, dhe Universitetin e Tiranës. Është Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për Zhvillimin Rajonal (CRD) me të cilën ka disa bashkëpunime në fushën e menaxhimit të mbetjeve, mjedisit të pastër, demokracisë lokale, me USAID dhe fondacionin Conrad Adenauer Stiftung. Ka ushtruar detyrën e Prefektit për disa vite në Qarkun Berat. Ka qenë Drejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Politikave të Decentralizimit dhe Integritit në Ministrinë e Brendshme. Është themelues i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe bashkëhartues i ligjit për Nëpunësin Civil më 2013. Ka kryer studime mbi reformën administrative dhe decentralizimin në Francë në Prefekturën Loraine, në kuadër të ndjekjes së studimeve në Shkollën Nacionale të Administrimit në Francë. (ENA). Është autor i shumë shkrimeve për çështjet e vetqeverisjes vendore, decentralizimit, dhe demokracisë vendore si dhe pjesëmarrës në shumë debate dhe intervista televizive mbi këto tema.

## Pritshmëritë

Në këndvështrimin tonë raporti siguron, plotëson dhe ofron kushte për:

- a) politika të qarta në nivele përkatëse gjithëpërfshirëse dhe bashkëkohore.
- b) instrumenta ligjore efektive për riorganizimin territorial në funksion të përkthimit të politikave në praktikë, që janë të integruara me standardet kombëtare dhe pasqyrojnë angazhimet drejt proceseve integruese të vendit drejt BE.
- c) Procese të qarta për vlerësimin dhe, sipas nevojës, rishikimin e rregullave dhe legjislacionit, veçanërisht për të shmangur ndikimin disproporcional në përfaqësim dhe shpërndarje shërbimesh publike vendore ndërmjet zonave urbane dhe rurale.
- d) Përshtatshmëri ndaj pritshmërive të arsyeshme të komuniteteve bazuar në histori, traditë dhe zakone, si dhe ndarje të burimeve të disponueshme dhe kapaciteteve për zbatim.

## I. Përmbledhje Ekzekutive

Nga analiza e bërë arrijmë në këtë përmbledhje:

1. Shqipëria ka shanse të mëdha që të përmirësojë përfaqësimin, të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, në përmirësimin e cilësisë dhe të aksesit të qytetarëve në shërbimet publike vendore, në pjesëmarrje dhe vendimmarrje në të gjithë territorin e saj.
2. Riorganizimi i bashkive dhe krijimi i bashkive të reja rurale do të krijojne kushte për zhvillimin ekonomik lokal, rural, agroturizëm, dhe rigjallërim të jetës sociale, ekonomike dhe politike, me pritshmëri për të “frenuar” shpopullimin.
3. Reduktimi i pabarazive midis zonave rurale dhe urbane, si edhe krijimi i kushteve të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe kontroll të territorit në të gjithë vendin.
4. Rritja e kapaciteteve të administratës publike vendore, si dhe forcimi i strukturave administrative dhe komunitare sa më afër qytetarëve, ofrojnë shanse për rininë, grupet e tjera shoqërore dhe vazhdimësinë e komuniteteve.
5. Përmirësim të demokracisë vendore nëpërmjet rritjes së potencialeve përfaqësuese në vendimmarrjet lokale, llogaridhënies dhe instrumentave të tjerë demokratikë.
6. Detyrimet e qeverisjes vendore mbi rolin e tyre për integrim në BE plotësohen më mirë me reformimin dhe riorganizimin territorial.

### Rekomandime

**1. Rekomandim mbi modelin e pushtetit vendor.** Bazuar në analizën tonë në këtë raport, mendojmë dhe rekomandojmë që Shqipëria duhet të mbajë pushtetin vendor me dy nivele, ta zhvillojë e forcojë akoma më shumë qeverisjen me shumë nivele.

**2. Rekomandimi mbi riorganizimin territorial të nivelit të parë të pushtetit vendor.** Siç kemi arsyetuar dhe argumentuar në raportin me fakte, shifra, dhe krahasime me vende të zhvilluara, bazuar në kontekstin dhe ndjeshmërinë kombëtare dhe lokale, në nevojën për të ofruar qeverisjen vendore të qytetari, rekomandojmë riorganizimin e bashkive aktuale dhe krijimin e 33 bashkive të reja. Sugjerimi ynë qëndron për 94 bashki shërbyese dhe përfaqësuese për nivelin e parë të pushtetit vendor në Shqipëri (lista e bashkive në aneks).

**3. Rekomandimi mbi riorganizimin e nivelit të dytë të pushtetit vendor.** Përsa i përket reformimit të nivelit të dytë të pushtetit vendor, rekomandojmë si të domosdoshëm ndërhyrjen kushtetuese dhe ligjore për organizimin dhe funksionimin e tij në funksion të rritjes së performancës së këtij niveli, për politika dhe kohezion social.

Ne prezantojmë dy skenarë për nivelin e dytë:

- Skenari A:** Shqipëria të ndahet nga pikëpamja administrative e pushtetit vendor të nivelit të dytë me 6 Qarqe të mëdha/rajone. (skenari A aneks)
- Skenari B:** Shqipëria të ndahet në 3 rajone, që sërish do të jenë niveli i dytë i pushtetit vendor. (skenari B aneks).

**4. Rekomandime të tjera:**

1. Hartimi dhe miratimi i ligjit për referendimet lokale.
2. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për funksionimin e të dy niveleve të pushtetit vendor në funksion të riorganizimit.
3. Buxheti nga të ardhurat kombëtare për bashkitë dhe nivelin e dytë duhet të dyfishohet që vitin tjetër.
4. Strategjia Kombëtare e Decentralizimit duhet të jetë koherente me zhvillimet, dhe të marrë në konsideratë ushtrimin për decentralizim asimetrik ndër të tjera.
5. Bashkisë së Kryeqytetit ti jepet status i veçantë.
6. Për të shtuar vëmëndjen dhe rritur rëndësinë që ka dinamika e pushtetit vendor i sugjerojmë qeverisë rikthimin e një Ministrie dedikuar pushtetit vendor.

## Fakte dhe shifra rreth Shqipërisë

<b>Popullsia:</b>	2 793 592 banorë (INSTAT 2020)
	4 571 786 banore (sipas RGJC gusht 2022)
Mosha 0-14 vjeç:	17.4%
Mosha mbi 65 vjeç:	14.2%
Jetëgjatësia në lindje:	78.6 vjeç

### Shpërndarja e të ardhurave

(Koeficienti Gini):	38.4 për 2012 (INSTAT 33.2 për 2020)
Shkalla e papunësisë:	11.9 %.
Përqindja e grave në Kuvend:	29.5%.

### Prosperiteti: Rritja e prodhimit

PBB:	15.3 miliardë USD
PBB për frymë:	13 680 USD
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve:	31.6% e PBB
Importi i mallrave dhe shërbimeve:	45.3% e PBB
Remitancat:	9.6% e PBB

### Zhvillimi i qëndrueshëm financiar

Të ardhurat publike:	27.4% e PBB
Shpenzimet publike:	29.4 e PBB
Borxhi publik:	66.7 e PBB
Kreditimi i sektorit privat:	34.4e PBB
Të ardhurat tatimore:	18.3% e PBB

### Paqja dhe institucionet: Forcimi i qeverisjes

Numri i vrasjeve për 100 000 banorë:	2.3
Indeksi i perceptimit të korrupsionit:	35
% e popullsisë që ndihet e sigurtë të ecë vetëm natën është 63%.	

### Ruajtja e natyrës

Sipërfaqja e tokës:	28 000 km <sup>2</sup>
Sipërfaqja pyjore:	28.8% e sipërfaqes totale
Clirimi i karbonit nga djegja e karburantit:	1.5-ton për frymë

**Buxheti pushtetit vendor 2022** (Burimi Ministria Financave)

Buxheti vendor për vitin 2022 është:

Të ardhurat 60 290 milionë lekë, nga të cilat:

- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 18 723 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale 9 305 milionë lekë;
- të ardhura të tjera 32 262 milionë lekë;

Shpenzimet 60 290 milionë lekë.

*Pesha e buxhetit vendor nga 2.1% e PBB-së në vitin 2013 në 3.2% të PBB-së në vitin 2022.*



## II. Hyrje

Qeverisja vendore në Shqipëri, përpara viteve 90, në thelb ishte një qeverisje e kontrolluar, me organe të kufizuara vetqeverisëse (këshillat popullore) brenda kuadrit të një sistemi vendimmarrës thellësisht të centralizuar, qeverisje kjo e ngarkuar për menaxhimin e zbatimit të planeve ekonomike të detajuara të qeverisë në çdo sektor ekonomik. Gjatë 30 viteve demokraci, pushteti vendor ka kaluar disa faza reformimi administrativ dhe territorial dhe ka gdhendur historikun e tij të ndarjes territoriale.

Pas viteve '90, mund të themi se qeverisja vendore ka kaluar në tre faza të zhvillimit.

**Faza parë** i përket periudhës 1992-2000 me Ligjin organik nr. 7572 i vitit 1992 dhe vendimin e KM nr.269 datë 25.6.1992 për ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe kishim 314 komuna, 44 bashki dhe 36 rrethe. Në këtë fazë, decentralizimi fiskal dhe reformat ekonomike qëndrojnë në disavantazh përkundëjt atij politik.

Në këtë kohë (Gusht 1992) u krijuan të parat organe te qeverisjes vendore (sipas Ligjit 7572/1992 mbi “Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal”). Kjo duhet të gjykohej si një arritje tepër e rëndësishme. Organeve vendore iu kaluan disa nga shërbimet dhe funksionet me përfitim të drejtpërdrejtë për publikun, së bashku me më shumë autonomi administrative dhe financiare. Megjithatë, përkundëjt qëndrueshmërisë së autonomise dhe mozaikut politike, autonomia fiskale dhe administrative mbeti tejet e kufizuar.

Ndryshimi kryesor strukturor i reformës në pushtetin vendor ishte përvijimi i rolit të të dy niveleve të qeverisjes vendore:

1. Bashkive dhe Komunave iu shtuan funksionet, si organe të nivelit të parë të qeverisjes me përgjegjësi të drejtpërdrejta dhe me më shumë autoritet dhe
2. Këshilli i Rrethit u përvijua si një organ me një rol më shumë koordinativ po jo vetëm.

Në vitet e para të tranzicionit, vëmendja u përqëndrua kryesisht në reformat qendrore për ngritjen e institucioneve kryesore (legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit), sipas modeleve demokratike, si dhe në reformat bazë ekonomike (stabiliteti makroekonomik, sistemi bankar, privatizimi, etj). Si rrjedhim, vëmendja dhe kujdesi për reformat në qeverisjen vendore mbeti më e ulët. Megjithatë, në këtë periudhë u miratuan një numër ligjesh dhe vendimesh të Këshillit të Ministrave, të cilët përcaktuan pak a shumë kompetencat dhe autoritetin e organeve të qeverisjes vendore.

**Faza e dytë** i përket viteve 2000-2015 me Ligjin Organik nr. 8652 të vitit 2000. Kjo periudhë nisi me zhvillimin e rëndësishëm të Ratifikimit të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore në 1999. Statusi i pushtetit vendor filloi të ndryshonte dhe me hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së re të Shqipërisë. Sipas Kushtetutës, Shqipëria është shtet unitar me dy nivele të pushtetit vendor: bashkia/komuna në nivelin e parë dhe qarku në një nivel më të lartë. Pushteti vendor në Shqipëri bazohet në parimin e decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Që nga viti 1999/2000, u hodhën disa hapa të rëndësishëm për të krijuar njësitë autonome të pushtetit vendor me autoritetin e plotë për të administruar një pjesë të rëndësishme të sektorit publik. Modeli shqiptar i decentralizimit u formua, edhe më tej në Strategjinë Kombëtare për Decentralizimin dhe Autonominë Vendore, e cila u miratua nga Qeveria qendrore në vitin 2000. Në këtë periudhë kishim 308 komuna, 65 bashki dhe 12 qarqe të cilat u krijuan këtë periudhë nga ‘reformimi’ i 36 rretheve,

**Faza e tretë** i përket periudhës 2015 dhe aktualisht, pra periudhës së zbatimit të reformës territoriale me Ligjet nr.115/2014 për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në republikën e shqipërisë si dhe 139/2015 “per vetqeversijne vendore” periudhë në të cilën kemi 61 Bashki që përfaqësonin nivelin e parë të pushtetit vendor dhe 12 Qarqet që përfaqësonin nivelin e dytë të pushtetit vendor, që kjo reformë nuk i preku.

Reforma territoriale administrative e 2014 kishte për qëllim sistemimin e territorit nëpër kufij të rinj administrativ duke riorganizuar njësitë e qeverisjes vendore që konsideroheshin shumë të fragmetizuara çka sillte si pasojë faktin se shërbimet publike të ofruara për komunitetet lokale nuk ishin të kënaqshme dhe nuk kishte ekonomi shkalle por kishte shpenzime të tepërta administrative.

Për të adresuar këto probleme dhe për të përmirësuar qeverisjen vendore, qeveria është angazhuar në përgatitjen e strategjisë ndërsektoriale të decentralizimit, dhe ka ndërhyrë në kuadrin ligjor. Kësaj përpjekje i janë bashkangjitur dhe programe e projekte të ndryshme të asistencës teknike që duke njohur mirë rrethanat kanë planifikuar ndërhyrje në aspekte të ndryshme. Këto përpjekje i kanë dhënë deri diku një formësim kësaj reforme.

Por dhe pas përpjekjeve deri diku të harmonizuara të qeverisë dhe donatorëve sërish dhe pas 7 viteve nga reforma, panorama vendore paraqitet me dritëhijet e saj në disa drejtime kryesore si:

1. Mungesë e theksuar përfaqësimi të komuniteteve të ish komunave (njësive administrative) në vendimmarrjet në këshillat e qarqeve etj.
2. Realizimi i autonomisë (decentralizimi fiskal dhe administrativ);
3. Sasia, cilësia dhe shtrirja e shërbimeve e paqëndrueshme,
4. Përfaqësimi qytetar në proceset vendimarrës dhe llogaridhënies te organet drejtuese vendore;
5. Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet ndër-institucionale për dialog real, respektimi i ndarjes së pushteteve, paanshmëria etj.
6. Shpërndarja e shërbimeve publike e disbalancuar ndërmejt zonave urbane dhe rurale,
7. Kontrolli i territorit dhe qeverisja sa më pranë qytetarit, transparenca etj.
8. Ekonomia e shkallës në dilemë të madhe dhe larg objektivit.

## **II.I Momenti dhe arsyet për të rishikuar ndarjen territoriale**

*A u përmbushën premtimet dhe a e realizoi ndikimin e saj reforma që riorganizoi nivelin e parë të pushtetit vendor në 61 bashki?*

Shumica e bashkive vazhdojnë të vuajnë nga sistemet e qeverisjes jo të kënaqshme dhe shpesh jofunksionale, duke përfshirë shpërndarjen e papërshtatshme të burimeve, sistemet joefikase të të ardhurave dhe ofrimin e dobët të shërbimeve jetike publike. Një qeverisje e tillë e dobët çon në rezultate të padëshiruara për aksesin në shërbimet publike nga të varfërit dhe të pafavorizuar të shoqërisë. Nevoja për të mbuluar dhe administruar në mënyrë efektive territore të largëta nga qendra mbetet koherente, transporti publik, strehimi, mirëmbajtja e rrugëve rurale, etj vazhdojnë të jenë kërkesë e vazhdueshme; inovacioni si një shtytës kryesor

i produktivitetit vendor lë mjaft për të dëshiruar në zonat përtej qyteteve etj.

*A duhet që Reforma e vitit 2014 duhej domosdoshmërisht të përfshinte edhe këshillat e qarqeve si nivelin e dytë të pushtetit vendor?*

Por, para se të ndërmerrej konfiguracioni i ri territorial, a duhej që politika të përcaktonte qartë së pari se cili do të ishte modeli më efektiv dhe efikas i pushtetit vendor në Shqipëri? Natyralitetit dhe kulturës kombëtare të Shqipërisë i shkon një pushtet vendor me një nivel, pra vetëm bashki? Apo edhe me nivelin e dytë; qarqe apo rajone? Dhe si mund të riorganizohen të dy këto nivele me qëllim që të sigurojmë një vazhdimësi dhe qëndrueshmëri të reformës territoriale administrative në funksion të çdo qytetari kudo ai jeton?

Reforma e 2014 u bë pa konsensusin e gjerë dhe politik ndërsa autoritetet qendrore qëndrojnë më të forta në objektivin e tyre dhe larg nga aftësia për të krijuar konsensus midis interesave të ndryshme, pasi aktorë të ndryshëm shpesh janë në një lloj pozite të vetos, duke qenë në gjendje të ndikojnë të paktën në një pjesë të rëndësishme të reformës, e cila mund të ndikohet në të gjithë paketën e reformës. Sot është evident ndikimi nga mungesa e konsensusit ndaj rikthehet në vëmendje interesi për ti korrigjuar gabimet që secili aktor ka mbi supet e tij.

Fitimi i mbështetjes popullore për reformën ndikon në strategjinë e reformës. Kuptohet që ka një interes publik nga prezenca e madhe e këtij debati në të gjithë mediat kombëtare dhe lokale që kërkon një zgjidhje. Një zgjidhje e mirë për të rikorrigjuar ndarjen territoriale është një qasje nga poshtë-lart bazuar në ekspertizën taktike dhe profesionale, jashtë çdo interesi partiak, në krahasim me reformën e 2014 më qasje të fortë nga lart-poshtë.

Nga ana tjetër, edhe fakti që 8 vite nuk mjaftojnë për tu bindur mbi suksesin e reformës konsiderohen. Ne nuk e shmangim këtë dilemë të efektit në raport me kohën. Por përpiqemi të japim rrugëzgjdhje efektive dhe boshllëqeve të padëshiruara që solli kjo reformë gjatë 8 viteve, dhe të plotësojmë këto në kohën e duhur, dhe jo të presim, pasi mund të thellohen potencialisht këto boshllëqe me kalimin e kohës, dhe kjo na çon në efekte më të padëshiruara. Pra, është momenti për terapi të kujdesshme tani për të patur një pushtet të shëndetshëm në vazhdimësi.

**Qëllimi i këtij studimi dhe produkti final është:**

- a. Propozimi i *modelit* të pushtetit vendor në Shqipëri,
- b. Propozojmë rishikime, *korrigjime dhe riorganizimin e ri territorialo-administrativ* për nivelin e parë dhe të dytë të pushtetit vendor, dhe rekomandime për çështje administrative dhe rregullatore.

## **II.II Parakushtet për rishikimin e reformës**

Dizajni i autoriteteve administrativo-territoriale (sipas udhëzime të proceseve për reformën territoriale administrative të Komitetit për Demokraci Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës) mund të hartohet në lidhje me një sërë parametrash: madhësia (territori, popullsia), funksionet (detyrat dhe kompetencat), autonomia (autoritetet shtetërore kundër vetëqeverisjes, varësitë fiskale dhe funksionale) dhe mënyra e funksionimi (prodhimi publik përkundër atij privat) etj.

Shumë me rëndësi është përcaktimi i modelit të pushtetit vendor në Shqipëri (me një nivel apo dy nivele). Mendojmë se është parakushti i parë i vendosur në tavolinë nga mazhoranca dhe opozita dhe faktorët e tjerë politikë dhe jo politikë.

Por, këto parametra varen reciprokisht nga njëri-tjetri. Zgjidhjet në lidhje me një parametër kanë lidhje me parametrat e tjerë.

Mbajtja e një numri të vogël njësisish vendore sa është sot (61 bashki) rëndon shumë mbi demokracinë lokale, por dhe pritshmëria për ekonomi shkalle ka mbetur iluzion. Mbajtja e një numri të madh të autoriteteve të vogla vendore në një vend me një popullsi të konsiderueshme (4.5 milion sipas RrGjC), dhe 2,8 milion sipas Census 2011- përfshin futjen dhe riorganizimin e nivelit të dytë të autoriteteve, sepse njësitë vendore janë shumë të vogla për t'u kujdesur për shumë shërbime publike dhe ato janë shumë për t'u kontrolluar efektivisht nga qeveria qendrore. Por kjo na siguron më shumë demokraci dhe përfaqësim dhe qeverisje me shumë nivele.

Në rastet kur vendoset një zgjidhje me dy nivele, disa funksione i duhen transferuar nivelit të dytë. Kështu psh. disa përgjegjësi ky nivel i merr nga qeveria qendrore, ndërkohë disa të tjera i merr nga njësi të qeverisjes vendore që nuk janë në gjendje ti performojnë këto shërbime. Kjo na çon në një qasje të decentralizimit asimetrik që është një qasje bashkëkohore.

Por, edhe nëse shkohet për një qeverisje vendore me një nivel, pra vetëm me bashki, ristrukturimi i autoriteteve territoriale duhet të udhëhiqet nga një vizion ose teori gjithëpërfshirëse e strukturës qeveritare dhe politike.

Plani fillestar i reformës territoriale nuk është përmbushur në të gjitha rastet. Kjo ka çuar në një situatë në të cilën ndryshime në numrin e njësisive vendore dhe shtesat e mëvonshme në paketën e reformës nuk bien ndesh dhe s'kanë pse të përdoren si argument kundër synimeve fillestare të reformës. Qëllimi është të përmirësojmë aty ku duhet dhe mundet. Por, situata e rënduar nga një kontekst i paqëndrueshëm politik dhe administrativ në nivelin qendror, nuk duhet të bëhet pengesë për riorganizimin territorial dhe thellimin e decentralizimit të qeverisjes vendore në këtë kohë.

Nga ky këndvështrim, studimi dhe ky raport është një përpjekje e rëndësishme për të ndjekur një kurs të qëndrueshëm të veprimeve reformuese të pushtetit vendor.

Tradita, identiteti dhe identifikimi lokal dhe i jetesës në komunitete lokale historike si në shumë vende nuk ka qenë e lehtë për t'u zhbërë. Ka një presion të madh sot për tu rikthyer sa më shumë në këto tradita jetese dhe riorganizimi territorial. *Në keto raste, është e rëndësishme të mbahet një qëndrim i qartë për rendin në të cilin janë fiksuar pikat e reformës.*

Një parakusht për reformën që rrallë është trajtuar në mënyrë eksplicite në rastet studimore është konteksti më i gjerë socio-ekonomik i reformës.

Shpërndarja e popullsisë brenda vendit në zona rurale dhe urbane ka një ndikim në llojin e ndarjes territoriale që mund të bëhet për të krijuar autoritete lokale të qëndrueshme. Konteksti dhe rrethanat shqiptare, faktet dhe shifrat tregojnë për një tendencë drejt urbanizimit nga pikpamja e demografisë, por nga pikpamja e kapitalit natyror, ai mbetet i palëvizur dhe duhet të trajtohet dhe të marrë një vëmendje më të madhe nëse i qasemi një riorganizimi territorial

kryesisht në zona rurale si instrumente dhe mekanizme juridikë, administrativë dhe kushtetues që sigurojnë një rishpërndarje të përgjegjësive dhe lehtësimim e ngarkesës funksionale të bashkive qëndrore.

Qasjet teknike dhe konsensuale të reformës ju kundërvihen dyshimeve popullore për vetë reformën, dhe kjo është një nga parakushtet drejt suksesit në korrigjimet eventuale të reformës territoriale.

Krijimi i njësive të reja vendore do të shoqërohet me një ndarje fleksibile të funksioneve, pra jo të gjitha autoriteteve vendore u jepen të njëjtat kompetenca dhe për këtë arsye ka qenë e mundur të akomodohen ndryshimet e brendshme brenda një vendi. Pra, nuk duhet të anashkalohet, por të bëhet e qartë për njësitë vendore mënyra e funksionimit brenda autoriteteve dhe juridiksionit territorial.

Mundësitë për të rregulluar disa nga parametrat e reformës varen deri diku nga konteksti kulturor. Besimi ose mosbesimi në autoritetet publike predispozon ndjenjën e publikut në favor të zgjidhjeve të ndryshme lokale.

Në rastet e Evropës Lindore, ndjenja të tilla duket se kanë favorizuar njësitë e vogla të qeverisjes vendore, të cilat nga ana e tyre kanë pasur një ndikim në llojin e përgjegjësive që u janë dhënë autoriteteve. Çështja e mbështetjes popullore për rishpërndarjen dhe riorganizimin duket se është e ngjashme në të gjithë Evropën. Autoritetet lokale ekzistuese, si rregull, mbështeten nga ndjenjat dhe interesat e veta për të qëndruar dhe kontrolluar territore sa më të mëdha. Kjo nuk është e përgjashme edhe në rastin tonë. Por duhet parë përtej këtij interesi dhe tendencave politike.

Një pjesë e arsytimit kundër riorganizimit është ngjyrosur gjithashtu nga supozimi se riorganizimi çon në humbje të kontrollit të pushtetit, dhe nuk kemi një racionalizim të marrëdhënieve ndër-institucionale mes njësive ekzistuese. Por opinioni publik dhe interesat e qytetarëve duhet prevalojnë mbi çdo rrugë të shkurtër ndërveprimi për interesa që nuk janë dobi publike.

Por, tjetër parakusht është pranimi nga qeveria që riorganizimi territorial i 2014 nga një reduktim i ‘guximshëm’ dhe “drastik” i numrit të njësive vendore (373 bashki dhe komuna dhe 12 qarqe) me qasje "të ashpër" nga lart-poshtë, të pranojë një mënyrë "të butë" që shkon për një rritje të arsyeshme të numrit të njësive vendore dhe reformim të nivelit të dytë të pushtetit vendor.

Përfitimi i kësaj qasjeje është se pushteteve vendore dhe popullsisë u jepet mundësia të përshtaten me politikën dhe kontekstin lokal, duke krijuar premisa për më shumë përfaqësim dhe demokraci lokale edhe në zona me potenciale të kufizuara ekonomike.

Në të njëjtën kohë, parakushte për riorganizimin duhet të jenë edhe pranimi i bashkimeve vullnetare që ofrojnë ekspozita të rëndësishme brenda fazave të mëvonshme të reformës.

Reforma aktuale e territorit ka shfaqur shqetësime të lidhura ngushtë me ndjenjën e komunitetit dhe traditat kulturore. Në kushte të turbullta ekonomike që po kalojmë do të dukej veçanërisht e papërshtatshme të merret në konsideratë argumenti klasik në favor të përfaqësimit dhe demokracisë lokale, që do të dukej si një oksigjenim i kulturës qytetare, por mund ta shikojmë si oksigjenim për të mbajtur këto identitete kulturore dhe historike të komuniteteve.

Është shumë e rëndësishme që reforma të kryhet këtë herë me gjithëpërfshirje politike dhe kjo të bëhet qasje sistematike. Raporti në fjalë prezanton argumenta dhe aftësi për të krijuar konsensus midis interesave të ndryshme, pasi aktorë të ndryshëm shpesh janë në një lloj pozite të vetos, duke qenë në gjendje të ndikojnë të paktën në një pjesë të rëndësishme të reformës, e cila mund të ndikojë në të gjithë paketën e reformës.

Një pikë e fundit në parakushtet është qasja ndaj modeleve nga vende të tjera. Është e vështirë të transferohen elementë nga një model i një vendi në modelin e një vendi tjetër. Për shkak të traditave historike dhe kulturore, i njëjti përfundim ka të bëjë me transferueshmërinë e të gjithë sistemeve administrative. Ndaj qasja jonë bazohet në parimin e përputhshmërisë me kontekstin lokal dhe kulturën kombëtare.

Sistemet administrative evropiane, modelet evropiane jugore, modelet evropiane kontinentale, modeli britanik dhe modelet skandinave ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe ndërvarësia ndërmjet komponentëve brenda sistemeve mund të funksionojë ndryshe.

Por, priremi të vlerësojmë dhe pranojmë praktikën më të mira që nxirren nga përvojat e të tjerëve në parime dhe rregulla procedurale.

### II.III Vlerësimi paraprak i ndikimit të reformës së rekomanduar

Zona e ndikimit	Ndikimi i pritur
Numri i njësive vendore	Nga 61 bashki që është sot në 94 bashki,
Popullsia mesatare	Ulet nga 75.000 në 50.000 për njësi vendore
Sipërfaqja mesatare	Ulet nga 471 km <sup>2</sup> në 315 km <sup>2</sup> për njësi vendore
Të ardhurat	Pritet një rritje graduale e të ardhurave nga taksat bujqësore
Shpenzimet	Shpenzimet do të mbajnë në rastin më minimal trendin që kanë dhe bashkitë sot bashkë me njësitë administrative.
Numri i të zgjedhurve vendorë	Rritet nga 61 kryetarë në 94 kryetarë, numri i këshilltarëve rritet nga 1607 në 2114
Bashkëpunimi Ndërkomunal	Potencialisht rritet, pasi rriten numri i njësive vendore për qark nga 5,1 bashki për qark në 7.4 bashki për qark. (jemi në llogjikën me 12 qarqe) nëse do të shkojmë për 6 qarqe të mëdha atëherë do të kemi 14.8 njësi për qark, çka shton dhe shtyn në rritje të bashkëpunimit ndërbashkiak, por nëse shkohet me ndarjen e nivelit të dytë në 3 rajone *Nuts 3, atëherë do të kemi 29.6 njësi bashkiake për rajon. Në këtë rast egoizmi për bashkëpunim ndërbashkiak më i zbehtë.
Decentralizimi Administrativ	Ky qëndron i lidhur me ideologjinë e politikës se sa pushtet do tju transferohet Bashkive. Por, ne mendojmë që bashkitë e reja do të kenë pushtet administrativ duke u caktuar një sërë detyrash këtyre bashkive, sidomos ato që lidhen me tipologjinë e jetës dhe ekonomisë në zona rurale, apo dhe aspekte të tjera rregullatore, që lidhen me bujqësinë, pyjet, kullotat, vadijten, sektorin e agrobiznesit, turizmin rural, rrugë rurale etj. Konfigurimi shton mundësinë për një qeverisje territoriale më të mirë dhe më të kontrolluar. Ky riorganizimin që prezantojmë krijon disa nyje të reja administrative dhe ekzekutuese.
Decentralizimi politik	Më shumë vendimmarrje dhe vendimmarrës për qytetarët, më shumë të zgjedhur, më shumë këshilla bashkiakë, më shumë alternativa dhe mozaik politik dhe politikash. Pesha e votës rritet shumë kur pushteti politik është afër. Dhe fuqia politike e vendimmarrjes është në presion më të lartë për interesat lokale.
Decentralizimi financiare	Bashkitë e reja, si dhe ato ekzistuese, do të gëzojnë pushtetin ekonomik dhe financiar që percakton legjislacioni sot. Do të jenë të lira të shpenzojnë të adhurat nga burimet e veta si dhe do të operojnë lirshëm me transfertat e pakushtëzuara. Pozitive me riorganizimin është fakti që fuqia ekonomike nga tarifrat dhe taksat bujqësore dhe të sektorëve ruralë do të jetë më e madhe.

### III. Metodologjia

Raporti synon të marrë në konsideratë dhe është bazuar në dinamikën dhe zhvillimet e fundit, si në kuadër të reformave në nivel qendror, por dhe të punës së organeve të vetëqeverisjes vendore dhe ndryshimeve të ndodhura gjatë periudhës 2015-2022. Kryesisht, raporti bazohet në analizimin e gjetjeve të identifikuar nga:

**Proces i gjerë konsultimi**, pune, takimesh të nisura në 2011 dhe deri më sot, me të zgjedhurit lokalë të kohës, në këshilla komunale, bashkiake dhe qarqesh, me intelektualë dhe zyrtarë të ndryshëm, me qytetarë në moshë kryesisht të vjetër dhe që kanë kaluar jetën e tyre sociale dhe administrative në dy sisteme, me takime me pushtetarë të niveleve të ndryshëm, politikanë edhe deputetë, në takime formale dhe informale.

**Punë e bërë në terren** nga vizita, takime, seminare dhe tryeza rajonale, debate mbi reformën.

**Mbledhja e fakteve** (historike dhe tradicionale) propozimeve, kërkesave apo sugjerimeve të grupeve të interesit, qytetarë apo komunitete në takime politike në të 12 qarqet e vendit. Intervista informale apo gjysëm të strukturuar.

**Raportime dhe analiza të mëparshme** në fushën e reformës territoriale administrative nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare si Raportet e ShKSh nga Skl int. (Shoqata Suedeze e Autoritetve Lokale dhe Rajonale financuar nga Sida, Coplan për rajonet, dhe raportet periodike mbi financat vendore, Raporte mbi Reformën Territoriale dhe Administrative 2014, Raportet nga projektet e asistencës ndërkombëtare në Shqipëri etj.

**Hulumtime** të raporteve, botimeve apo artikujve të ndryshëm të përgatitur si pjesë e projekteve apo e veprimtarisë së institucioneve të ndryshme publike që veprojnë në fushën e pushtetit vendor, vigjilenca ndaj mediave të shkruara dhe vizive kombëtare dhe lokale që kanë ndjekur dhe raportuar mbi problemet e vazhdueshme që ka shfaqur reforma territoriale.

**Rezultate krahasimore** të performancës së pushtetit vendor mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të Europës Juglindore, të mundësuar nga NALAS (Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Vendore për Europën Juglindore), CMRE-Këshilli i Bashkive dhe i Rajove të Evropës, Kongresit të Autoritetve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Toolkite të ndarjes territoriale, raportet dhe qëndrimet e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë etj.

**Puna e Komisionit të Posaçëm** në parlament për ndarjen territoriale, dëgjesat nga rreth 42 të ftuar si grupe interesi, akademia e shkencave, univeristete private dhe publike, bashkiake dhe ekspertë, organizata jo-fitimprurëse etj.

Gjatë gjithë kohës dhe në çdo rast, procesi i konsultimit nuk është kufizuar në një pyetje të thjeshtë (ose grup pyetjesh) të bëra mbi ndryshimet e propozuara (a jeni "pro" apo "kundër"?) ndarjes aktuale territoriale administrative.



Para se t'u kërkonim mendimin e tyre palëve të interesuara, kemi parë si të nevojshme dhe llogjike të fillonim me ofrimin e informacionit për komunitetet lokale por jo vetëm.

Është gjykuar se palët e interesuara duhet të marrin informacion bazë mbi:

- arsyet e reformës dhe riorganizimit,
- dilemat: ekonomi shkalle apo demokraci lokale dhe përfaqësim; bashkia e “madhe” e “mirë” dhe bashkia e “vogël” e “keqe”, secila ka bukurinë e vet.
- ndikimi i pritshëm në të gjithë vendin;
- ndikimin e pritshëm pozitiv në komunitetin e tyre;
- rreziqet e mundshme (pasojat negative) dhe masat e marra për minimizimin e tyre.
- të kuptuarit se "asnjë madhësi e vetme nuk i përshtatet të gjithëve" dhe se nuk ka një “çelës të artë”
- të kuptuarit se duhet të jemi pragmatikë dhe të përshtatemi me kushtet, kontekstin lokal;
- të nxisim kolektivisht mbështetjen e investimeve, dhe ideve inovatore të jetës dhe ekonomisë.
- të vendosim fermerin në qendër;
- të dëgjojmë çdo opinion, mendim dhe respektojmë ndjeshmërinë ndaj interesave vendore nga poshtë-lart.
- dhe jo për të gjitha kemi përgjigje;
- propozimet për reformë do të nisin me një vlerësim të kushteve dhe preferencave vendore dhe jo me një fokus ekskluziv mbi njësi të kategorive të caktuara (p.sh. njësitë e vogla/apo të mëdha, territor shumë i madh apo shumë i vogël etj)

#### **IV. Prgatitja për rishikimin e reformës territoriale**

Rishikimi i reformës administrative territoriale mundësohet lehtësisht nga tre aspekte që qëndrojnë fort në argumentim për të bërë korrigjime të ndarjes territoriale. **Aspekti i parë** është se këto ndryshime të propozuara mbështeten plotësisht në kuadrin ligjor të brendshëm dhe në konventat ndërkombëtare të njohura dhe pranuar nga Shqipëria, si më poshtë:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (përcaktime në nenet 108-113)

<https://www.parlament.al/Kuvendi/Kushtetuta>

Karta Evropiane e Vetqeverisjes Vendore të Këshillit të Evropës

<https://rm.coe.int/european-charter-of-local-self-government-alb-a6/16808d7b36>

Ligji 115/2014 “Për Ndarjen Administrative Territoriale”

[https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligj\\_115-2014\\_31.07.2014.pdf](https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligj_115-2014_31.07.2014.pdf)

Ligji 139/2015 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Vetqeverisjes Vendore”

<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore>

Konkretisht, në kreun XIV të ligjit 139/2015 bëhet specifikim shumë i saktë, dhe ligjvënësi ka patur parasysh mundësinë për ndryshime të mundshme bazuar në rrethana dhe kontekste të ndryshme me interes për qytetarët, interesa lokale dhe kombëtare. Kjo është një bazë e shëndetshme ligjore ndër të tjera për të bërë korrigjimet në hartën e ndarjes territoriale.

Konkretisht thuhet:

Neni 86

*Riorganizimi administrativo-territorial i vetëqeverisjes vendore*

*Ndarja administrativo-territoriale në fuqi mund të riorganizohet me ose pa ndryshim të kufijve ekzistues të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me interesat ekonomikë e socialë, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, për realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore ose për zbatimin e politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe më gjerë.*

Ndërsa në nenin 87- Riorganizimi me ndryshim kufijsh.

*Riorganizimi me ndryshim të kufijve bëhet kur:*

- a) një njësi e vetëqeverisjes vendore ndahet në mënyrë të plotë në dy a më shumë njësi më vete të vetëqeverisjes vendore;*
- b) dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore shkrihen për të formuar së bashku në territorin tyre një njësi të vetme të vetëqeverisjes vendore;*
- c) një pjesë e territorit të një njësie të vetëqeverisjes vendore kalon në territorin dhe administrimin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore;*
- ç) kërkohet një kombinim i rasteve të sipërpërmendura.*

Gjithashtu kemi qartësime edhe nga neni 88- Riorganizimi pa ndryshim kufijsh. *Riorganizimi pa ndryshim kufijsh bëhet në rastet e ndryshimit të emërimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose në rastet e ndryshimit të vendndodhjes së qendrës.*

Qasja jonë në këtë studim është bazuar në këtë kuadër ligjor sipas nenit 87 pika a (*ndahet në mënyrë të plotë në dy a më shumë njësi më vete të vetëqeverisjes vendore*); dhe pika c (*një pjesë e territorit të një njësie të vetëqeverisjes vendore kalon në territorin dhe administrimin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore*;) pra për ndryshim kufijsh që çojnë në ndarje të disa bashkive, dhe në krijimin e disa njësive të reja vendore, por edhe në riorganizim pa ndryshim kufijsh, pra korrigjime që nuk çojnë në krijimin e bashkive të reja.

**Aspekti i dytë** lidhet me faktin se ky rishikim i ndarjes nuk fillon nga zero, pra jemi një rrugë të njohur, kemi njohuri të mjaftueshme teknike dhe politike për të prodhuar një ndarje të qëndrueshme dhe pa cënuar vazhdimësinë e asnjë institucioni ekzistues, pra të 61 bashkive, dhe të bashkive te reja.

**Aspekti i tretë** vullneti i përbashkët i shprehur i mazhorancës dhe opozitës dhe i konkretizuar me krijimin e komisionit të posaçëm parlamentar bipartizan për të trajtuar dhe për tu dakortësuar me dhe mbi riorganizimin territorial në Republikën e Shqipërisë. “Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr.13/2022 vendosi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për Reformën Administrativo – Territoriale në Republikën e Shqipërisë.” (vendimi ne annex)

**Një aspekt tjetër** me rëndësi është dhe shqyrtimi i rekomandimeve të tjera si:

- Rekomandimi dhe komente nga The Congress of Local and Regional Authorities Monitoring Committee CG/MONO2(201 6)01 -prov Restricted 1 6 March 2016).
- Rekomandimi dhe koment\_Final COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Albania 2021 Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2021 Communication on EU

Enlargement Policy - Strasbourg, 19.10.2021 SWD (2021) 289-faqe 12. BE-ja imponon ndonjë kërkesë (rrallë) sa i përket organizimit territorial, i cili mund të shihet nga larmishmëria e marrëveshjeve në shtetet anëtare ekzistuese. Në të vërtetë Traktati mbi Bashkimin Evropian (neni 4) specifikon se Bashkimi Evropian do të respektojë identitetet kombëtare për sa i përket strukturave politike dhe kushtetuese të qeverive rajonale dhe lokale.

#### **IV.I Kriteret për riorganizimin e ri territorial dhe prespektiva**

Për efekt të këtij studimi janë parashikuar një sërë kriteresh që janë gjithpërfshirëse dhe mjaftueshëm shteruese. Kriteret e tilla thujasë janë bazë për të tilla reforma edhe në vende të tjera të zhvilluara. Ne kemi respektuar dhe kriteret që janë përdorur në reformën e 2014, të përcaktuar në Vendimin nr. 3 dt. 28.04.2014 ‘të Komisionit të Posaçëm të Reformës’ duke shtuar edhe kriteret e tjera që janë gjykuar të nevojshme.

Por, gjithashtu kemi bazuar në parimin që bashkitë ekzistuese të qëndrojnë si qendra me territor urban dhe rural dhe kjo ju përkon me zhvillimin strategjik për 20-30 vitet e ardhshme. Ndërsa përtej këtij territori propozohet krijimi i bashkive të tjera rurale që do të përbëjnë nje të zhvillimit administrativ dhe të ekonomisë rurale.

Në këtë matricë, qëllimi ynë nuk është vetëm të listojmë kriteret, por edhe të bëjmë një vlerësim dhe krahasim të tyre, dhe të japim opinione mbi prespektivën për secilin kriter që do të merret në konsideratë në riorganizimin e pushtetit vendor në të dy nivelet.

*Procesi i riorganizimit, ndarjes së bashkive dhe krijimit të bashkive të reja bëhet mbi bazë Qarku*

Kriteret	Vlerësimi				Shënime	
	Sh i rëndësishme	I rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Aspak i rëndësishëm	Situata aktuale	Prespektive
1. Efienca ekonomiko-financiare dhe ekonomia e shkallës së njësive territorialo-administrative		+			Raportet ndër vite për Financat Vendore tregojnë se organizimi aktual me 61 bashki nuk siguroi ekonomi shkalle edhe pse disa tregues fiskalë janë lehtësisht pozitivë (1/3 e bashkive janë me probleme financiare) disa në prag të vështirësive serioze financiare (ligji 68/2017) <a href="https://financat-lokale.al/sq/publikime">https://financat-lokale.al/sq/publikime</a>	Por propozimi që ne do të bëjmë për krijimin e njësive të reja potencialisht nuk do shkaktojë efekte negative ekonomike. Do kemi një rishpërndarje të të ardhurave kombëtare nëpërmjet transfertave por jo vetëm. Ligji për buxhetin.
2. Numri i popullsisë  Mjaftueshëm e madhe për të kryer të gjitha shërbimet e tipologjisë së zonave rurale kryesisht.			+		Reforma aktuale që vuri theksin te shkrirja e njësive të vogla krijoi disbalancim të madh ndërmjet njësive vetë dhe ndërmjet numrit të njësive vendore brenda një qarku. Por pajtohemi me parimin që nuk ka një masë që i përshtatet të gjithë njësive. Por numri është prioritet në raport me vlerat e tjera, dhe nuk është dhe duhet të jetë kriter eliminues.	Propozimet tona për njësitë e reja kanë një numër popullsie që është edhe më i lartë se sa gati 15 bashki sot që kanë më pak se 10.000 banorë, dhe akoma më i lartë se sa mesatarja e popullsisë për njësi vendore në 27 vendet e

				Numri mesatar i banorëve për bashki është 47.000. <i>*më poshtë krahasime me vende të tjera.</i>	BE (6850 banorë një njësi të qeverisjes vendore) Me numrin e bashkive që ne propozojmë të shtohen kjo mesatare ulet në 32.000.
3. Kriteri i përfshirjes dhe tipologjia e shërbimeve të zonave urbane dhe rurale	+			Reforma aktuale ka krijuar shpërndarje të pabarabartë të shërbimeve publike në zonat rurale ku sipas census 2011 jetojnë 48 % e popullsisë, dhe nga burimet tona rezulton se në shkallë kombëtare në 61 bashki vlera e investimit në zona rurale krahasuar me ato në zona urbane është diku te 20% në disa njësi, dmth aspak e përfillshme. Investimet në sektorin agrobujqësor, pyje dhe vaditje nuk kanë marrë vëmendjen e duhur nga bashkia qendër.	Propozimi ynë qëndron për një ndarje dhe krijim të njësive vendore kryesisht rurale që vijjnë si bashkim i disa njësive administrave me veprimtari ekonomike në zona rurale, me bazë të zhvillimit ekonomik bujqësinë dhe agroturizmin etj. Me nevoja shërbimesh për vaditje, rrugë rurale, shërbime për pyje e kullota, blegtori dhe shërbime të tjera sociale etj.
4. Vazhdimësia territoriale dhe distanca nga qendra	+			Ndarje aktuale ka krijuar problem me distancat fizike, por edhe në shumë raste me vazhdimësinë territoriale. Psh. Zall Herri si NjA që i përket bashkisë Tiranë, territorialisht duhet të qëndrojë me Bashkinë Kamez, apo NjA Paskuqan e bashkisë Kamëz për vazhdimësi territoriale i takon bashkisë Tiranë, pasi dhe tendenca e zhvillimit urban të Tiranës shkon nga veri perëndimi (korridori i 8 drejt Durrësit) etj.	Propozimi ynë bën korrigjime të tilla dhe sugjeron që brenda një periudhe 4 vjeçare (brenda mandatit tjetër 4 vjeçar të vendorëve) ligji të detyrojë të gjithë institucionet për të gjitha korrigjimet
5. Garantimi dhe respektimi i lidhjeve historike- tradicionale	+			Reforma aktuale me 61 Bashki ka ndikuar në këto lidhje historike dhe tradicionale, ndjeshmëria e qytetarëve ka një rënie në këtë	Krijimi i bashkive të reja është plotësisht në linjën e respektimit sa më të mundshëm të lidhjeve të

dhe ndjeshmëria e komuniteteve/homogjeniteti				aspekt dhe këto janë pritshmëritë kudo janë bërë të tilla reforma. Kjo është një nga arsytet frenuese që reforma të tilla bëhen rrallë dhe marrin shumë kohë. Edhe në shumë vende ka pasur rikthime në njësi ekzistuese apo rigrupime me afërsi në tradita apo jetesë në lokalitetet tradicionale. Propozimi ynë merr në konsideratë por nuk e ezauron plotësisht çdo kërkesë qytetare mbi këtë aspekt.	traditës, historisë dhe zakoneve në komunitete apo lokalitete të dikurshme. Por, për të shmangur dhe plotësuar çdo boshllëk në këtë aspekt dhe në respekt të ndjeshmërive qytetare ne do të propozojmë ndryshime ligjore përsa i përket referendumeve lokale. Sugjerojmë që pjesë e kësaj pakete konsensuale, ndër të tjera, të jetë dhe vullneti për ligjin e <i>referendumeve lokale</i> .
6. Mbrojtja e minoriteteve etnike		+		Reforma aktuale e ka respektuar këtë aspekt, por dhe në riorganizimin që ne do të prezantojmë respektohet përsëri mirë. Madje, propozimi që ne bëjmë nuk prek asnjë nga këto bashki.	Propozimi ynë nuk cënon aspak këtë aspekt dhe është në të njëjtën linjë me produktin e reformës së 2014
7. Rritja e përfaqësimit të qytetarëve në vendimmarrje		+		Para reformës kishin një përfaqësim të zgjeruar me 6000 këshilltarë dhe 373 të zgjedhur nominalisht. Reforma e 2014 solli 61 të zgjedhur nominalisht dhe 1600 këshilltarë. Pra, ka një ulje të ndjeshmerisë të përfaqësimit në total, por ndërkohë ky përfaqësim sot është i përqëndruar thujasë në zona urbane, duke lënë pa përfaqësim pjesën rurale.	Propozimi ynë çon në një rritje të numrit të këshilltarëve vendorë me 560, dhe të të zgjedhurve nominalisht (kryetarë) me jo më shumë se 33. Ajo që është shumë pozitive dhe e dobishme këtu, më shumë se sa sasia, është e lidhur me shpërndarjen e të zgjedhurve dhe rritjen e përfaqësimit në njësitë e reja që përfaqësojnë zona rurale. Kjo do të rrisë peshën e vendimmarrjes për

					zhvillimin rural dhe turizmin rural, por rrit edhe konkurrueshmërinë dhe simbiozitetin urban-rural.
8. Qeverisje kushtetuese sa më afër e mundshme për qytetaret	+			Krijimi i 61 bashkive në mënyrë të natyrshme çoi në largim të qeverisjes nga qytetari për arsye gjeografike dhe territoriale. Njësitë administrative në varësi të bashkive dëshmuuan me ekzistencën e tyre, nevojë për shërbime ndaj qytetarëve. Por, roli i tyre është aspak evident dhe funksional. Ato janë pa kompetenca, pa mjete financiare, pa pushtet për të vepruar në çdo shërbim që nevojitet nga qytetarët.	Krijimi i bashkive të reja si organe kushtetuese siç janë dhe sot 61 bashkitë ekzistuese, do të çojë në qeverisje më pranë qytetarit, me kompetenca dhe funksione mjaftueshëm, mjete dhe burime financiare për tju përgjigjur nevojave të komuniteteve në zona rurale. Kjo ndër të tjera sjell edhe një lehtësim për punën e bashkive në qendër, rrit fokusin dhe vëmendjen ndaj çështjeve urbane etj. Bashkitë e reja jo domosdoshmërisht mund të kenë të njëjtat kompetenca me bashkitë e qyteteve. Kërkohet rregullim ligjor që shkon për decentralizim asimetrik. Tjetër prespektivë këtu veçojmë edhe impaktin në “frenimin” e shpopullimit.
9. Riorganizimi i territorit do të bëhet mbi bazë qarku.	+			Është respektuar ky kriter në reformën e 2014.	Edhe studimi ynë mban po këtë kriter që çdo bashki e re të dalë

						nga ndarja e bashkisë brenda të njëjtit qark.
10. Kufinj të ish komunave/NJA që bashkohen për të krijuar bashkinë e re mbeten siç janë, dhe konsiderohen si një e tërë në njësinë vendore të re		+			Kriter ka qenë në reformën e 2014	Edhe ne i qëndrojmë këtij kriteri. Pra, bashkitë e reja kanë hartën e tyre të juridiksionit territorial ku përfshihen NJA, por bashkia konsiderohet si një e tërë.
11. Bashkitë ekzistuese azhurnojnë kufinj të ri në territorin që mbetet në koordinim me bashkinë e re.		+			Është sot në proces	Qeveria duhet të nxjerrë akte ligjore që shoqërohen me aktin për ndryshimet në ligjin për ndarjen e re dhe atë të funksionimit të pushtetit vendor por çdo rregullim dhe korrigjim kufijsh.
12. Ndryshime të tjera që lidhen me fshatrat që natyrisht dhe llogjikisht mund të bashkangjiten një njësi tjetër vendore, shikohen rast pas rasti bazuar në praktika ligjore.			+		Nuk ka të dhëna	Ka disa raste ku fshatra nga një njësi kërkojnë të jenë pjesë e një njësie tjetër. Sugjerojmë që të nxirren akte detyruese me afat që brenda mandatit 4 vjeçar të gjitha bashkitë, të bëjnë dakortësime me bashkinë fqinje për kërkesat e veçanta.



Vlerësimi i kriterëve është me rëndësi për riorganizimin territorial dhe konsolidimin e bashkive. Por asnjë kriter nuk duhet të përjashtojë tjetrin. Në qasjen tonë jemi përpjekur ti integrojmë për të gjetur një të mesme të “artë” për një konsolidim të qëndrueshëm. Për ne, propozimet për reformë do të nisin me një vlerësim të kushteve, preferencave dhe ndjeshmërive vendore dhe jo me një fokus ekskluziv mbi njësi të kategorive të caktuara (p. sh. njësitë e vogla) sikundër jo çdo njësi sado e madhe duhet domosdo të zvogëlohet.

Listimi i kriterëve për qasjen tonë, metodologjia që ne kemi përdorur, dhe vlerësimi jonë final, nuk kanë për qëllim të zhbëjnë reformën e vitit 2015. Ne i konsiderojmë propozimet tona si vazhdimësi të reformës për konsolidim të saj dhe forcim e qëndrueshmëri të pushtetit vendor. Por, në përmbledhje, ne arsyetojmë dhe analizojmë kriteret si një zinxhir që ndihmojnë njëri tjetrin dhe përjashtues.



Po kështu, ne mbështesim sërish bashkitë ekzistuese, që gëzojnë dhe funksionojnë mbi serinë e kriterëve më sipër. Ato do të mbeten entitete administrative siç janë, me territor urban dhe rural, (One town – one municipality) dhe disa njësi të tjera që krijohen nga bashkimi homogjen i disa ish-komunave (NjA) do të jenë entiteti më vete pothuajse me veprimtari në zonat rurale. (bashki pa qytet).

Pra, në çdo rast nuk është se ka një madhësi fikse në numër banorësh dhe sipërfaqe territori. Dhe kjo lidhje është vështirë të konfigurohet për të gjitha njësitë. Pra, në llogjikën tonë ne nuk bëjmë përpjestime popullsie dhe përpjestime të sipërfaqeve territoriale.

*Megjithatë, teoria sugjeron disa konkluzione të dobishme:*

Madhësia optimale e njësive vendore varet nga shkalla e përgjegjësive lokale, bashkitë tona kanë përgjegjësi thelbësore (së paku e shkuar) dhe ku nivelet më të larta të autoriteteve të decentralizuara luajnë një rol relativisht të vogël, rasti i këshillave të qarqeve.

Madhësia optimale nuk është qartësisht uniforme në të gjithë vendin, por varet nga një sërë faktorësh, duke përfshirë topografinë, demografinë, historinë, politikën vendore, dhe në fakt çdo gjë tjetër që mund të ndikojë në efikasitetin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe demokracisë lokale. Kjo sugjeron se kushtet lokale duhet të merren parasysh në hartimin e reformave, dhe kjo për studimin tonë është prioritet.

Shifra prej rreth 94 njësi vendore për gjithë vendin (ose me një mesatare të popullsisë prej rreth 32.000 banorë) është e bazuar, para së gjithash, në vlerësimin tonë për çka do të jetë e nevojshme për të bërë një ndryshim kuptimplotë të kapacitetit të njësive vendore, ndryshim i duhur për të përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore.

Por, është pjesërisht një çështje gjykimi. Siç është përmendur më sipër bazuar në literaturë çdo përpjekje për të rekomanduar një madhësi teorike optimale për njësitë vendore është e detyruar të dështojë. Pasi reforma e 2014 e dëshmoi dhe po e dëshmon dhe sot këtë fakt, ku bashki të "mëdha" janë në prag 'falimentimi'. (Vora dhe Kavaja)

Bashkitë e reja që krijohen nga ndjekja e këtyre kritereve janë thuajse me territor rural. Pra, janë bashki pa qytete pjesa më e madhe. Por, qendrat e këtyre bashkive të reja mund të jenë dhe disa janë fshatra (Borghì) <https://borghipiubelliditalia.it> me traditë historike dhe atraksione turistike që shërbejnë si epiqendër për turizmin në zona rurale. Por, në disa të tjera janë qyteza të vogla, apo qendra urbane në prespektivë në disa raste të tjera.

#### **IV.II Praktikrat e rishikimit dhe riorganizmit të territorit të vendeve të BE**

Reformat administrative-territoriale kanë qenë në agjendën e politikës dhe politikave reformuese të administratës publike në dekadat e fundit në kryesisht në vendet e Evropës Perëndimore që nga vitet 1970. (Paweł Swianiewicz Adam Gendźeń University of Warsaw, Faculty of Geography and Regional Studies and Alfonso Zardi for the centre of expertise for local government reform). Por ndryshime u vunë re edhe në Evropën Qendrore dhe Lindore në fund të të njëjtit shekull pas rënies së regjimeve jodemokratike.

Arsyet për ndryshime ishin të shumta. Vendet post-socialiste synonin të kthenin një shkallë të lartë të autonomisë bashkiake me koston e fragmentimit territorial, ku regjimet e mëparshme ishin totalisht të centralizuara me komandim të drejtpërdrejtë nga qendra. Tjetër arsye për këto ndryshime është karakterizuar nga dëshira dhe tendenca për modernizim, racionalizim dhe mbi të gjitha "ekonomi të shkallës".

Por edhe krizat financiare ishin një shtysë drejt reformave territoriale, me synimim për ulje të kostove, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe racionalizimin e proceseve vendimmarrëse, konkurrueshmërinë, rritje të kapaciteve burimore etj. Këto ndryshime diku më shumë e diku më pak kanë pasur ndikim në nivelet e ndryshme të qeverisjes në shumicën e shteteve evropiane, nga niveli i parë (niveli bashkiak ose komunal) tek ai i ndërmjetëm (qarku, krahina) deri në nivelin meso (rajon), duke përfshirë herë pas here edhe riorganizimin e shtetit, strukturat e veta periferike në nivel lokal.

Ndryshimet tentuan më së shumti të reduktonin numrin e qeverisjeve bashkiake/vendore nëpërmjet shkrirjes ose zgjerimit të bashkëpunimit ndërbashkiak, rezultati që shpesh ishte një reduktim drastik i numrit të njësive të qeverisjes vendore dhe një rritje në madhësinë dhe popullsinë e tyre gjeografike. Në disa raste - zona metropolitane - u bënë përpjekje specifike për të tërhequr bashkitë e vogla rreth bashkive më të mëdha me synimin për të krijuar 'metropole' të mëdha që do të përbënin 'nyje' për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin ekonomik. Por asgjë nuk ka qënë statike dhe ky proces ka ecur para dhe pas.

Praktika nga vende të ndryshme sipas tabelës më poshtë tregon qartë se ndryshimet kanë qënë evidente dhe në asnjë rast nuk është gjetur çelsi i artë. Ndryshimet në numrin e niveleve nënkombëtare të qeverisjes, për shembull, rrudhja e niveleve të ndërmjetme (provincat në Itali, departamentet në Francë, etj.) ose futja e niveleve shtesë (rajonet). Por kështu edhe rritje të numrit të bashkive apo rikthim të disa njësive vendore ekzistuese para reformave kanë ndodhur në shumë vende. Kudo qëndron dilema e madhe e reformës territoriale.

Bashki të mëdha dhe ekonomi shkalle përkundrejt bashki mjaftueshëm të mëdha dhe demokraci lokale.


Në tabelën më poshtë tregohet qartë dinamika e ndryshimit të numrit të njësive vendore në vende të ndryshme. Ky ndryshim ka ardhur si pasojë e rrethanave të brendshme kombëtare, rajonale dhe lokale, por në qendër ka qënë ndjeshmëria e komuniteteve.

## Ndryshimi i numrit të bashkive në Europë (Territorial Reforms in Europe –Toolkit)

	Numri i njësisve vendore						
	1990	1994	1998	2002	2006	2010	2014
Shqipëria	374	374	374	373	373	373	61***
Austria	2333	2353	2358	2358	2356	2356	2353
Belgjika	589	589	589	589	589	589	589
Bullgaria	279	255	262	264	264	264	264
Kroacia	172	499	545	550	556	556	556
Qipro	380	380	380	380	379	379	380
Cekia	4100	6230	6242	6254	6248	6250	6253
Danimarka	275	275	275	275	270	98	98
Estonia	255	254	247	241	227	226	213
Finlanda	460	455	452	448	431	342	320
Franca	36693	36688	36682	36682	36688	36685	36684
Gjeorgjia	1004	1004	1004	1004	69	69	71
Gjermania	15978	15915	14194	13299	12224	11882	11040
Greqia	5923	5921	1033	1033	1034	1034	325
Hungaria	1381**	3137	3154	3158	3168	3175	3177
Islanda	213	195	161	112	89	77	74
Irlanda	113	114	114	114	114	114	31
Italia	8094	8102	8099	8101	8101	8094	8071
Latvia	573	568	566	548	527	118	119
Lichtenstein	11	11	11	11	11	11	11
Lituania	58	58	58	60	60	60	60
Luksemburgu	118	118	118	118	116	116	106
Malta	67	67	68	68	68	68	68
Moldavia	959	959	959	649	898	898	898
Mali i Zi	21	21	21	21	21	21	23
Hollanda	672	636	548	496	458	431	403
Norvegjia	448	435	435	435	433	430	428
Polonia	2383	2475	2489	2491	2478	2479	2479
Portugalia	305	305	308	308	308	308	308
Rumania	2948	2948	2948	2966	3174	3181	3181
Serbia	145	145	145	145	145	145	145
Slovakia	2826	2858	2878	2891	2891	2890	2890
Slovenia	62	158	203	204	221	221	223
Spanja	8108	8108	8108	8114	8114	8815	8118
Suedia	284	286	288	289	290	290	290
Zvicra	2761	2761	2761	2726	2726	2584	2352
Maqedonia e Veriut	34	34	123	123	80	80	80
Turqia	2061	2754	3230	3243	3241	2966	1411
Ukrahina	10572	11338	11566	11615	11623	11622	11624
Mbretëria e Bashkuar	540	540	467	468	468	434	433

Buirimi: ” Toolkit për reformën territoriale në Evropë”

(<https://pl.scribd.com/doc/293560272/Local-Autonomy-Index-for-European-Countries-1990-2014>)



\*MKD = the former Yugoslav Republic of Macedonia, today North Macedonia

Ajo që bie në sy nga këto grafiqe është fakti se kudo ka pasur ndryshime. Këto ndryshime janë shoqëruar diku me rritje dhe diku me reduktim të numrit të njësisve vendore. **Ajo që bie në sy është rritja e numrit të njësisve vendore në Çeki, Ukrainë etj, por edhe rritja e numrit të bashkimeve në Maqedoninë e Veriut nga 34 në vitin 1990 në 80 në vitin 2014, vitin kur Shqipëria shkurtoi 308 komuna dhe 14 bashki.** Ajo çfarë duam të tregojmë me këto krahasime është vetëm fakti se reforma të tilla në territor nuk janë tabu për tu rishikuar.

Tabela. Reformat territoriale të nivelit bashkiak në Evropë pas vitit 1990

Buirimi: ” Toolkit për reformën territoriale në Evropë”

(<https://pl.scribd.com/doc/293560272/Local-Autonomy-Index-for-European-Countries-1990-2014>)

Nuk ka ndryshime të rëndësishme në organizimin territorial

Belgjika, Bullgaria, Qiproja, Franca, Gjermania (8 nga 13 Landet), Lihtenshtajni, Lituania, Malta, Mali i Zi, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Spanja, Suedia, Zvicra (12 nga 25 kantone)

Nuk ka ndryshime deri më tani, por reforma që janë duke u zhvilluar që mund të çojnë në konsolidim territorial	
Armenia (2), Estonia (4), Italia (1), Norvegjia (2), Ukraina (2)	
Konsolidim gradual gjatë viteve të ndryshme, pa asnjë moment të qartë e të vetëm reformimi	
Estonia (5), Finlanda, Gjermania (Länder e Mecklenburg, Sachsen, Sachsen-Anhalt, Thüringen), Islanda, Holanda, Zvicra (Kantonet e Bernës, Friburgut, Graubünden, Lucernë, St. Gallen, Solothurn, Ticino, Vaud, Valais) dhe Mbretëria e Bashkuar (aktualisht jo je BE).	
Fragmentimi në fillim të viteve 1990	
Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Sllovenia	
Reformat e bashkimit në një ose më shumë pjesë të vendeve federale	
Austri, Gjermani, Zvicër	
<b>Reforma territoriale me shkrirje të njëjësive vendore.</b>	<b>Viti</b>
Shqipëria	2015
Austria – Styria	2015
Danimarka	2007
Gjeorgjia (3)	2006
Gjermania - Brandenburg	1995, 2002-2004,
Greqia	1998, 2011
Irlanda	2014
Letonia	2009
Luksemburg	2011
Zvicra – Glarus Switzerland – Jura,	2011
Neuchatel	2009, 2013
Zvicra – Schaffhausen	2009
<b>Situata të tjera</b>	
Maqedonia e Veriut	Ndarje në 1996, bashkim në 2004
Moldavia	Bashkim në 1999, ndarje në 2003
Turqia	Ndarje në 1990, bashkim në 2014
Portugalia	Bashkimi i nivelit të sub-municipal (parish)

(1) Reforma në Itali ka të bëjë kryesisht me nivelin provincial dhe bashkëpunimin ndërkomunal, por mund të përfshijë edhe konsolidimin e nivelit komunal.


(2) Procesi i reformës filloi në 2014 në Norvegji, në 2015 në Ukrainë dhe në 2016 në Armeni, por procesi nuk ka përfunduar ende.

(3) Pas 2012, reforma e pjesshme e ri-fragmentimit në diskutim.

(4) Estonia, siç shpjegohet në tekst, është një rast specifik. Fillimisht pati një konsolidim gradual ‘vit pas viti’ dhe në 2016-2017 reforma hyri në një fazë tjetër.

Pavarësisht nga reformat territoriale dhe qëllimit të tyre, njësitë vendore ekzistojnë pasi ekzistojnë qytetarët, banorët kërkojnë shërbime dhe që votojnë drejtuesit e tyre. Në vende të ndryshme numri i banorëve për bashki është i ndryshëm. Më poshtë ne do të prezantojmë këto fakte për grup vendesh të ndryshme.

Tabela. Numri mesatar i popullsisë për njësi të qeverisjes vendore në nivelin e parë (burimi CMRE) [https://www.ccre.org/en/papiers/index\\_broch](https://www.ccre.org/en/papiers/index_broch)




Më poshtë do të paraqesim krahasimin e numrit të njësive vendore në vendet e Europës Juglindore.

Tabela. Ndarja territoriale në Vendet e Evropës Juglindore. (NALAS)

<http://www.nalas.eu/Publications/Books>

Vendi	Niveli i dytë	Niveli i parë
Shqipëria	12 qarqe	61 bashki
Bosnjë Hercegovinë	11 kantone	144 bashki
Republika Serbska	-	64 bashki
Bullgaria	-	265 bashki
Kroacia	21 qarqe	556 bashki e komuna
Kosova	-	38 komuna
Maqedonia	-	81 bashki
Moldavia	32 rajone, 1 provincë autonome	898 bashki e komuna
Rumania	41 qarqe	3181 komuna
Serbia	2 provinca autonome	145 bashki
Sllovenia	-	212 bashki
Turqia	51 Provinca Vetqeverisëse dhe 793 rajone vetqeverisëse	1398 bashki e komuna

Të dhënat më sipër tregojnë gjithashtu qartësi mbi popullsinë mesatarë për bashki në vendet e BE, të OECD dhe vendeve të tjera. Por në tabelën më sipër prezantohet jo vetëm numri i bashkive si nivel i parë i pushtetit vendor por edhe vendet që kanë nivel të dytë pushteti vendor. Pra, numri i bashkive dhe popullsia për bashki siç tregohet nuk janë tregues të fortë për të pasur një qeverisje të fortë. *Një pjesë e madhe e këtyre bashkive të vogla edhe në vendet e BE, apo OECD, etj, kanë pushtet financiar shumë herë më të madh se bashkitë tona me popullsi më të mëdha dhe numër bashkish më të vogël.*



Burimi: [http://www.nalas.eu/Publications/Books/Brief\\_2nd](http://www.nalas.eu/Publications/Books/Brief_2nd)



Pra problemet e pushtetit vendor jo detyrimisht janë të lidhura me madhësinë e bashkisë dhe numrin e bashkive në nivel kombëtar. Ndaj duhet gjithmonë saktësi dhe qartësi për të gjetur modelin më të mirë për të reformuar pushtetin vendor.

**Reformat territoriale në vende të ndryshme kanë pasur modele të ndryshme:**

Ka disa modele që aplikohen në bërjen e reformave administrative dhe territoriale. Vende të ndryshme aplikojnë modele të ndryshme.

a) **me shkrirje** të njësive të qeverisjes vendore, që çon në konsolidimin territorial nëpërmjet reduktimit të numrit të qeverisjes vendore. Rasti reformës së 2014 në Shqipëri është rasti tipik me një reduktim drastik të numrit të njësive vendore.

b) **me ndarjen** e njësive të qeverisjes vendore që çojnë në rritje të numrit të njësive dhe fragmentim territorial. Edhe ky rast ka qënë evident në vende të ndryshme. Rasti që ne po propozojmë në këtë studim i përket këtij modeli. Theksojmë se jemi tërësisht në përputhje me nenin 87 të Ligjit 139/2015. <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore>

c) **me bashkim**. Kjo është forma më demokratike. Kjo realizohet nga vullneti i vetë qytetarëve apo këshillave të NjQV. (rasti Bushat-Barbullush 2003).

d) **ndryshime të kufijve** gjeografikë të bashkive fqinje, **pa asnjë ndryshim në numrin** e njësive të qeverisjes vendore. Edhe studimi ynë qëndron në këto modele në disa bashki. Ky fakt dhe kërkesat qytetare na janë prezantuar, por në vazhdimësi duhet të mbyllet si proces i shoqëruar me akte ligjore nga qeveria qendrore dhe vetë bashkitë fqinje.

e) **rasti me ideal** është kur riorganizimi me cilëndo formë më sipër të bëhet me referendum lokal siç parashikon dhe neni 5 i Kartës Evropiane të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të KiE. Aktualisht vendit tonë i mungon kuadri ligjor dhe rregullator për referendumet lokale.

### IV.III Vendimmarrja

Politika ka folur, mazhoranca dhe opozita kanë një ‘dakortësi’ publike dhe ligjore, parlamenti ka miratuar komisionin e posaçëm dhe kalendarin e punimeve për të rishikuar reformën. Shtyrja e punimeve të komisionit deri më 21 tetor është një mundësi e mirë për të gjithë por dhe për ne ekspertët për të punuar dhe argumentuar nevojën për konsolidim të reformës territoriale. Raporti do të jetë në dispozicion të porositesit nga ana jonë në kohën e duhur. Ne do të jemi në dispozicion për çdo sqarim dhe prezantim të raportit, të bashkojme gjetjet dhe të kemi një raport konsensual dhe një miratim konsensual në komision dhe po kështu një miratim konsensual në parlament. Kjo do të siguronte qëndrueshmëri të ndarjes territoriale.

Duke qënë se zgjedhja periodike për vendorët do të jetë vitin tjetër në një nga të dielat e periudhës 15 prill-15 maj 2023, sugjerojmë që parlamenti të marrë në konsideratë këtë presion kohor, dhe të mobilizojë burimet për ti trajtuar dhe miratuar ndryshimet. Nga ana tjetër, qeveria duhet të azhurnojë Strategjinë e Decentralizimit e cila për fat të keq ka filluar përgatitjen pa konsideruar komisionin e posaçëm, duke injoruar ndikimin nga ndryshimet dhe vendimin e parlamentit. Kërkohet sinergji dhe koordinim në këtë aspekt.

Por, qeveria me miratimin e mundshëm të ndryshimeve, duhet të marrë vendime të shpejta që këto ndryshime të bëhen efektive për zgjedhjet e ardhshme vendore, me qëllim që të mos krijonë probleme në vazhdimësinë e shërbimeve dhe proceseve transferuese.

## V. Analiza dhe hapat

### 1. Identifikimi i qëllimeve të reformës në detaje dhe arsyet për rishikim

Literatura mbi reformat e bashkimit/ndarjes territoriale është e gjerë dhe mund të ndahet kryesisht në tre fusha fokusi.

Së pari, është hulumtimi mbi ndikimin e reformave territoriale në demokracinë lokale dhe zgjedhjet. Së dyti, efektet e dëshiruara ekonomike dhe administrative të reformave të bashkimit janë gjithashtu të kontestuara.

Së treti, efektet e reformave territoriale mbi identitetin janë studiuar gjerësisht në literaturë, gjë që nënkupton se reformat strukturore priren të çojnë në mosbesim social dhe një rënie të identitetit të komunitetit.

Identifikimin e ketyre qëllimeve dhe argumentave për rishikim do tju qasemi nëpërmjet metodës (GAP Assesment and GAP Plugging)– Vlerësimi i boshllëqeve dhe mbyllja e boshllëqeve.

### 2. Diagnoza e situatës aktuale dhe drithijet e reformës

Reforma territoriale është një çështje e nxehtë dhe delikate që duhej dhe duhet ende të adresohet në një debat konstruktiv kombëtar, dhe në institucionet ligjvënëse siç është duke u trajtuar aktualisht. Ecuria e pushtetit vendor duhet të vlerësohet nga dy këndvështrime, së pari nga efikasiteti i funksionimit dhe nga kapaciteti i decentralizimit real që mbart jo vetëm korniza ligjore por dhe e gjithë veprimtaria shtetërore në këtë drejtim. Pra sa vullnet ka qeveria për të decentralizuar dhe kjo tregon dhe shkallën e besimit ndaj pushtetit vendor.

Në këto rrethana, mbeten ende çështje të hapura për diskutim dhe rishikim ashtu si dhe ka progres e përmirësim në aspekte të caktuara. Çështje që mbeten ende për diskutim ndër të tjera janë:

- A është ndarja territoriale në 61 bashki ende një çështje për diskutim?
- A është ezauruese reforma e deritanishme e shtrirë vetëm në nivelin e parë të qeverises vendore, pa reformuar nivelin e dytë, qarqet, si premisa për zhvillimin dhe rajonalizimit në Shqipëri?
- A mund të garantojë reforma barazi në ofrimin e shërbimeve dhe kushte të njëjta jetese ndërmjet zonave urbane dhe rurale, dallim i cili nuk ekziston në vendet e zhvilluara?
- A siguroi reforma autonomi financiare dhe decentralizim fiskal?
- A janë plotësuar kërkesat dhe pritshmëritë e qytetarëve përmes efikasitetit në shërbime publike dhe efektivitetit të burimeve njerëzore?
- A ishin kriteret mbi të cilat u realizua ndarja e re të studiurara dhe analizuar mirë, dhe çfarë rezultatesh kemi 7 vjet pas zbatimit të saj?
- Ka vend për përmirësime dhe korrigjime? Çfarë mund t'i propozohet aktualisht politikës shqiptare në lidhje me rritjen e efikasitetit të reformës territoriale në nivelin e parë dhe të dytë të pushtetit vendor?

### 3. Kuadri metodologjik

Ky studim është i përcaktuar me qëllim të qartë; ne e dimë se cilët hapa duhet të ndërmerren paraprakisht dhe kështu jemi në gjendje të planifikojmë në detaje. Qasja jonë do të ndjekë tre parime të përgjithshme:

**Pragmatizmi:** Vlerësimi i boshllëqeve duhet të jetë realist në mënyrë që të ndihmojë komisionin e posaçëm të identifikojnë pengesat dhe boshllëqet që lidhen me ndarjen dhe riorganizimin territorial.

**Përgjegjshmëria:** Iniciativa politike dhe dakortësia për të ngritur komisionin e posaçëm dhe reformën territoriale ka surpriza dhe pengesa për të adresuar. Ne do të prezantojmë bindjen tonë profesionale dhe teknike, paanësi dhe adresimet ndaj interesave qytetare.

**Qartësia:** grupe të ndryshme brenda qeverisë por dhe agjensive që kanë qenë dhe janë të përfshira në reformën e territorit dhe të decentralizimit shfaqin disa interesa kontradiktore apo hezitime, apo presin të dinë tendencën e qeverisë mbi riorganizimin territorial.

Raporti ynë do të pasqyrojë me qartësi një analizë institucionale për vlerësimin e hendekut të krijuar nga reforma aktuale, për të qenë në gjendje të identifikojmë siç duhet rolet dhe ndërlidhjen mes tyre.

### 4. Fushat e identifikuar për tu analizuar

Qeverisja vendore ka në thelb të suksesit të saj progresin dhe harmonizimin në:

- a- efektivitet dhe efikasitet të demokracisë lokale, decentralizimit dhe përfaqësimit qytetar ;
- b- efektivitet dhe efikasitet të shërbimeve publike lokale.

Reforma e 2014 nuk i përmbushi këto 2 aspekte thelbësore. Shkurtimi i 373 subjekteve zgjedhore individuale (kryetare/kryetarë) njësisht vendore dhe 6000 këshilltare/këshilltarë) shënoi një ulje drastike përfaqësimi të qytetarëve kudo dhe sidomos në zonat rurale, të cilët edhe sot kanë një përfaqësim aspak domethënës në këshillat e qyteteve.

Edhe shërbimet publike në sasi nuk ishin aty ku u pretendua, dhe kostot administrative u rritën përkundrajt synimit për të kursyer 60 - 80 milionë dollarë kur u bë reforma në 2014, referuar raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, 2018 dhe kjo nuk ka tregues që është arritur. <https://panel.klsh.org.al/storage/phpVdzyFL.pdf>

### 5. Gjendja “ideale” ku duhet të arrijmë

Pushtet vendor i konsoliduar në kufinj të ri territorialë nëpërmjet riorganizimit dhe decentralizimit asimetrik apo rregullime të tjera. Ndaj, analiza dhe studimi duke marrë në konsideratë mos arritjet por dhe analizat më sipër identifikon si qëllim të saj përmirësimin e dy aspekteve për të patur më shumë:

- a. Më shumë demokraci dhe përfaqësim lokal të zonave rurale
- b. Më shumë shërbim efektiv në këto zonat rurale jashtë vëmendjes së bashkive të mëdha.

Kjo do të ishte një gjendje ideale që mund ta arrijmë me një riorganizim territorial të ri. Ne mendojmë se ky është vetëm një rishikim dhe korigjim i dimensionit territorial të ndarjes së vitit 2014.

Ky korrigjim apo korrektim kufijsh na çon në një qeverisje vendore më pranë qytetarëve në zona që aktualisht janë jashtë vëmendjes, jashtë shërbimeve dhe jashtë përfaqësimit zgjedhor.

## **V.I Boshllëqe nga reforma e vitit 2014 dhe prespektiva**

Mungesë përfaqësimi dhe mungesë shërbimesh në zona rurale, qeverisje larg qytetarit, paqartësi administrative, zyra të NjA pa asnjë funksion etj. Këto ndër të tjera e kanë origjinën nga së pari: çështje e kufijve territoriale, dhe së dyti: çështje administrative (ligjore/rregulative) dhe decentralizimi.

\*Fakti që nga 61 bashki, vetëm 2 të tilla (Kolonja dhe Mallakastra) kanë zbatuar këtë dispozitë si më poshtë: (Deri në datën 31 dhjetor 2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë administrative. Nga 1 janari 2018, këshilli i bashkisë ka kompetencën të vendosë për riorganizimin e administratave të njësisive administrative, të cilat mund të mbulojnë territorin e një ose më shumë njësisive administrative brenda bashkisë, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative.) është tregues i presionit të madh nga qytetarët për njësi shërbimi sa më afër, është tregues i pamundësisë, konfliktit dhe rreziqeve elektorale të Këshillit dhe Kryetarit, është tregues i ndjeshmërisë së komunteteve për të rezistuar dhe mbajtur jetën administrative sa më pranë.

Këto boshllëqe janë evidentuar nga disa burime të ndryshme cituar më poshtë që janë dhe referencë në këtë studim, por edhe nga pikëpamja e ekspertëve dhe të anëtarëve në grupin e punës.

### **1. Identifikimi i boshllëqeve**

Për efekt të këtij raporti ne jemi bazuar siç kemi shpjeguar në mjaft burime, raporte, por mbi të gjitha nga informacionet lokale, kërkesa dhe sugjerime nga aktorë të ndryshëm të cilët i kemi dëgjuar, dhe kemi mbajtur shënime, se çfarë nuk ka funksionuar gjatë këtyre viteve nga reforma. Analiza jonë është mbështetur në dy kategori boshllëqesh:

### **2. Boshllëqet nga kufijtë territorialë administrativë**

Më poshtë analizojmë një listë me boshllëqet që ka shfaqur reforma aktuale, referuar burimeve edhe mendimeve të ekspertëve, matja e tyre dhe prespektiva nga mbushja e këtyre boshllëqeve. Qëllimi është të shikojmë sa rëndësi ka çështja territoriale në jetën e qytetarëve.

<b>Nr</b>	<b>Boshllëqet nga kufijtë territorialë administrativë</b>	<b>Gjendja aktuale</b>	<b>Rëndësi Territorit/ kufijve</b>	<b>Prespektiva territorit/kufijve</b>
1	Demografia	Kemi një tendencë evidente largimesh, por edhe një masë interesi për rikthime (statistikë e Instat)	E lartë	Pjesërisht mund të stabilizohet
2	Infrastrukturë dhe rrugët rurale	Jashtë vëmendjes në zona rurale.	Sh e lartë	Përmirësohet
3	Infrastrukturë e gjelbër	E konsiderueshme natyralisht	Sh e lartë	Më e lartë
4	Largësi fizike	Shumë larg nga bashkia qendër	E lartë	Me përmirësim të ndjeshëm
5	Transporti	Relativisht mirë në qendër, kaotik në zona rurale	Mesatare	Përmirësohet
6	Përdorimi i tokës	Dobët/jo efektive	Sh e lartë	Ndjeshëm përmirësohet
7	Kapitali natyror dhe qeverisja territoriale	Indirekt, fillestar	E lartë	Përmirësohet
8	Ekonomia rurale	Dobët	Sh e lartë	Përmirësohet
9	Shërbimet lokale	Pjesërisht e zhvilluar	Sh e lartë	Përmirësohet
10	Teknologjia/ konektiviteti	Pjesërisht i zhvilluar	Lartë	Lehtësisht përmirësohet
11	Planifikimi dhe politikat bujqësore	Dobët	I lartë	Ndjeshëm përmirësohet
12	Agroturizmi	Dobët	Sh i lartë	Direkt përmirësohet
13	Mjedisi	Pjesërisht mirë natyralisht	I lartë	Ndikim i lehtë
14	Zhvillimi centrik	I fortë	I lartë	Ndikim Pozitiv
15	Balanca rural-urban	E theksuar	E madhe	E ndjeshme shumë
16	Konektiviteti	Pjesërisht i zhvilluar	I lartë	Mesatarisht
17	Mobiliteti	Stabilitet jo I fortë	I lartë	Pjesërisht
18	Historia/tradita/zakonet dhe zinxhiri i vlerave kulturore/homogjenitetit zonave	Me peshë të ulët	Sh e lartë	Ndjeshëm përmirësohet
19	Konkurrenca	Dobët	Mesatare	Pjesërisht mund të forcohet
20	Aksesueshmëri me qendrën	Relative	E lartë	Potencialisht më mirë
21	Akresi në rrugë rurale, pyje dhe kullota	Pjesërisht e zhvilluar	Sh i lartë	Ndikim direkt

22	Mbrojtja dhe rreziqet	Problematic	Sh i lartë	Pjesërisht më mirë
23	Kapacitetet njerëzore	Problematic	Sh i lartë	Pjesërisht përmirësohet
24	Inovacioni lokal (rural)	Dobët	Lartë	Lehtësisht forcohet
25	Rivitalizimi i fshatit	Dobët	Sh i lartë	Ndjeshëm më mirë
26	Ndërveprimi i fshatit me qytetin	Rastësore/ jo strategjik	Sh i lartë	Ndjeshëm forcohet
27	Krijimi i rrjeteve	Relativisht evident	I lartë	Tendencë për përmirësim
28	Tregu i punës	Kaotik	I lartë	Përmirësim të lehtë
29	Rinia dhe shpopullimi	I lartë	I lartë	Frenim i lehtë
30	Funksionaliteti i qarkut.	I ulët	E lartë	Ndikim indirekt
31	Kohezioni social	Ulët	I lartë	Ndikim pozitiv
32	Bashkëpunimi ndërkufitar	Ulët	I lartë	Përmirësim i ulët
33	Vaditja dhe kullimi	Ulët	Sh i lartë	Përmirësim i fortë
34	Pesha e votës dhe llogaridhënie	E ulët	Sh e madhe	Ndjeshëm forcohet
35*	*Numri i njësisve të qeverisjes vendore	Mesatar	E madhe	Pozitive

### 3. Boshllëqet administrative

Nr	Boshllëqet Administrative/rregullatore	Gjendja aktuale	Rëndësi Territorit/kufijve	Prespektiva territorit/ kufijve
1	Autonomia e vetqeverisjes:	E qëndrueshme në tërësi K/neni 108-113	Sh e lartë	Forcohet
	1.1 garancitë kushtetuese dhe ligjore	Parashikime evidente në kuadrin ligjor	Sh e lartë	Mbetet e lartë
	1.2 autonomi politike. administruese dhe përfaqësuese e NJA.	Zero	Sh e lartë	Përmirësohet ndjeshëm
	1.3 autonomi fiskale e NJA	Mesatare	Sh e lartë	Përmirësohet
	1.4 qëndrueshmëri dhe menaxhim financiar i NJA	Ulët	E lartë	Dukshëm përmirësohet
2	Kuadri ligjor i setit të funksioneve të transferuara. (2017)	Mirë	I lartë	Qartësohet

3	Vetëdecentralizimi i bashkive	Ulët	I lartë	Qartësohet evident
4	Dialogu ndërinstucional dhe bashkiak i NJA	Ulët	I lartë	Ndjeshëm i instucionalizuar
5	Burimet finaciare (ligji 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore)	Pamjaftueshëm	E lartë	Përmirësim të lehtë
6	Identifikimi i fermerëve dhe bizneseve bujqësore.	Dobët	E lartë	Përmirësim i fortë

*Duke patur parasysh rrethanat që vendi ynë po kalon nga përjetimi i një “tranzicioni” prej tre dekadash, dhe ndikimi jo i prekshëm nga reforma e vitit 2014, tani është evidente nevoja absolute për ta transformuar dhe konsoliduar pushtetin vendor në sistemin e ri territorial dhe të decentralizuar. Kjo vjen duke i përcaktuar pushtet territorial dhe riorganizmin territorial, pushtet financiar, administrativ dhe teknik pushteteve lokale, qasje dhe stile të reja, menaxheriale dhe instrumente të decentralizimit asimetrik.*

*Rezistenca ndaj ndryshimeve, veçanërisht nga ana e institucioneve qendrore dhe komoditeti i status quo ekziston, ndjesia e drejtuesve aktualë vendorë për të pasur pushtet të madh në territor të madh është evidente. Por interesi publik është ai që e thyen këtë rezistencë.*

#### 4. Përmbledhje dhe analizimi i boshllëqeve dhe prespektivës

Ekonomia e shkallës rezulton vështirë të matet në mënyrë empirike në reformën territoriale në praktikë. Rasti i bashkive shqiptare ku sipas raportit të vitit 2021 të Ministrisë së Financave 12 bashki kanë probleme financiare, 10 bashki me vështirësi financiare dhe me vështirësi serioze financiare 4-5 bashki. Pra, zmadhimi nuk e solli ekonominë e shkallës.

Lidhur me vështirësitë financiare të bashkive Monitor <https://www.monitor.al/bashkia-e-vores-dhe-kavajes-te-parat-qe-qeveria-behet-gati-ti-marre-ne-administrim/> analizon si më poshtë. ”Ministria e Financave ka evidentuar se 7 bashki të vendit ndodhen në vështirësi të mëdha financiare, por Bashkia e Vorës dhe Kavajës paraqiten më rëndë për shkak se borxhet në vitin 2021 për secilën zunë më shumë se 90 për qind të shpenzimeve faktike të vitit që shkoi.

Drejtoria e Financave vendore në Ministrinë e Financave ka formuluar një raport të detajuar për gjendjen financiare të bashkive, ku konstatohet se, në vitin 2021 shtatë bashki kanë një status si njësi në vështirësi financiare, konkretisht bashkitë Roskovec, Poliçan, Cërrik, Malësi e Madhe, Vorë, Belsh e Kavajë.

“Situata në Bashkinë e Kavajës dhe të Vorës është shumë më serioze ku detyrimet e prapambetura shënojnë respektivisht 91.23% dhe 90.54% të shpenzimeve faktike në vitin 2021” thuhet në raportin e Ministrisë së Financave. Sakaq paralelisht me këtë raport Ministria e Financave ka hapur një konkurs në të cilin synon të rekrutojë disa administratorë që në emër të qeverisë qendrore do të marrin në dorë administrimin financiar, fillimisht për dy bashkitë që janë në gjendje të vështirë, Vora dhe Kavaja.

Në bashkinë e Vorës, detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2021 ishin sa 53.13% e shpenzimeve totale të miratuara. Situata është mbi mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (12.90%) dhe mbi


treguesin e totalit te njësive vendore (12.93%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2021, detyrimet e prapambetura në Bashkinë e Vorës ishin 90.54% Treguesi i vështirësisë financiare është përkeqësuar shumë në tre vitet e fundit, nga 1.78% në 2019 në 53.13% në 2021.

Ndërsa në Bashkinë e Kavajës, detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2021 ishin 68.05% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Kavajës. Në përqindje të shpenzimeve faktike 2021, detyrimet e prapambetura janë 91.23%.

Përveç bashkive në vështirësi financiare, janë evidentuar edhe disa bashki kanë probleme financiare, konkretisht bashkitë: Peqin, Tropojë, Tepelenë, Rrogozhinë, Konispol, Lezhë, Kuçovë, Pogradec, Delvinë e Dimal.

Ndërsa 44 bashki të tjera nuk kanë probleme financiare. Ndërsa bashkitë me performancë shumë të mirë financiare gjatë vitit 2021, evidentohen bashkitë Gjirokastrë, Patos, Këlcyrë, Shkodër, Korçë me stok më të vogël se 1% të detyrimeve.

Vihet re se bashkitë që demonstrojnë probleme financiare apo janë në vështirësi financiare janë më së shumti bashkitë me shpenzime të planifikuara për frymë për vitin 2021 nën mesataren prej 21,306 lekë për banorë.



Burimi: <https://financa.gov.al>

Por edhe praktikat dhe literatura tregon se marrëdhënia midis madhësisë së qeverisjes vendore dhe efikasitetit të aktiviteteve të saj financiare është një nga pyetjet më të rëndësishme të studimeve të qeverisjes vendore. Është marrëdhënie e vështirë dhe delikate.

Megjithatë, ka pasur studime që janë skeptike në lidhje me përdorimin e shkrirjes territoriale si një mënyrë për të përmirësuar kushtet financiare të qeverive vendore të pafinancuara fiskale (për



shembull Dollery, Crase, 2004). Dollery dhe Fleming (2006) analizuan ekonomitë e shkallës gjatë reformës komunale në Australi. Gjetjet e tyre kanë sugjeruar se është e pamundur të përcaktohet një madhësi standarde e komunës/bashkisë që do të siguronte kushtet më efektive për ofrimin e të gjitha shërbimeve komunale. Shërbimet që kërkojnë më shumë kapital njerëzor (p.sh. shërbimi shëndetësor, shërbimet sociale) gjenerojnë ekonomi të ulët të shkallës sepse rritja e këtyre shërbimeve do të thotë se karakteri i tyre kërkon një numër më të madh punonjësish.

Nga ana tjetër, në lidhje me shërbimet 'kapitale intensive' si heqja e mbetjeve dhe kanalizimi, mund të shfaqen tendenca interesante pasi shërbimet ofrohen për një numër më të madh familjesh. Gjatë dy dekadave të fundit, në nivelin e autoriteteve të qeverisjes vendore në Australi, shërbimet "kapitale/intensive" janë zhvendosur në shërbimet komunale "punë/intensive".

Si rezultat, ndikimi i ekonomive të shkallës në kostot operative ka qenë vazhdimisht në rënie. Hulumtimi në shërbimet vendore intensive kapitale i kryer Bel (2012) dhe vërtetoi evidencën empirike të ekonomive të shkallës duke marrë parasysh se madhësia e tyre varet nga struktura e vendbanimit të lokalitetit, nga specifikat e shërbimit publik dhe nga modeli i prodhimit. Rezultate të ngjashme treguan hulumtimi nga komunat irlandeze (Callanan et al. 2014) Kështu, bashkimi i komunave është efektiv në atë që lejon një shkallë më të lartë të përdorimit të aseteve fikse në pronësi të bashkisë, duke përdorur përfitimet e specializimit përveç kursimet e bëra në blerjen e inputeve në vëllime më të mëdha. Kursimet në blerjen e shërbimeve dhe pronës mund të realizohen nga komunat edhe në rast të bashkëpunimit efektiv ndërkomunal. Kjo marrje e përbashkët e shërbimeve ka ndodhur edhe në Sllovakia nëpërmjet institutit të Zyrës së Përbashkët Komonale.

Nga ana tjetër, mund të shfaqen probleme të caktuara si pasojë e shkrirjes, që lidhet me menaxhimin e një territori më të madh dhe me prishjen e marrëdhënieve ndërmjet përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe popullatës. Në përgjithësi, shumica e bashkimeve territoriale kombinohen me tezën se bashkitë më të mëdha funksionojnë në mënyrë më efektive krahasuar me ato të vogla. Rëndësia e ekonomive të shkallës rritet edhe për faktin se në kuadër të procesit të decentralizimit, pushtetet vendore ofrojnë gjithnjë e më shumë shërbime publike të reja dhe më specifike.

Çfarë lexohet më sipër është paraqitur për të treguar se nuk është vetëm rasti me reformën në Shqipëri, por për të treguar se reforma të tilla janë delikate kudo, dhe kur nuk shkojnë mirë ekspertiza propozon zgjidhje alternative dhe politika mund ti konsiderojë ato.

Një tjetër argument që tregon se zmadhimi i juridiksionit territorial nuk dha rezultat theksuar fort në zona rurale janë dhe të ardhurat e këtij sektori që sipas raporteve të financave vendore.al, Co-plan dhe Ministrisë së Financave rezultojnë si më poshtë.

## V.II Pushteti ekonomik i bashkive

Bashkitë në tërësi, por bashkitë e reja për të cilën po analizojmë, do të gëzojnë këtë pushtet ekonomik ku burimet kryesore do të jenë nga transfertat e pakushtëzuar që sot sipas Ligjit 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” është jo më pak se 1% e PBB në nivel kombëtar. Duhet theksuar se tanimë ky 1% do të përpjestohet për 90 bashki, sipas formulës përkatëse. Pra, ajo që bie në sy është një rishpërndarje e kësaj transferte në më shumë njësi vendore. Kjo është konsideratë pozitive. Por edhe përfitime nga taksat e ndara janë burim tjetër për bashkitë.

Edhe sipas Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2018

<https://panel.klsh.org.al/storage/phpVdzyFL.pdf> thuhet: *’Reforma Administrative-Territoriale nuk ka përmbushur objektivat: legjislacioni i ri nuk zbatohet plotësisht, procesi i përhithjes së funksioneve të reja, punonjësve, aktiveve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve nuk është arritur të*

*realizohet me sukses. Në shumicën e bashkive rezulton nivel i ulët efektiviteti në mbledhjen e të ardhurave të veta dhe në përdorimin e fondeve në dispozicion. Pavarësisht se Reforma Administrative-Territoriale ishte e domosdoshme, ajo nuk ka reflektuar plotësisht parimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Për pasojë, rezultojnë mospërputhje mes objektivave të reformës dhe politikave fiskale dhe buxhetore të qeverisë qendrore të cilat kanë cenuar autonominë vendore duke minuar kështu forcimin e decentralizimit dhe autonomisë së bashkive. Buxheti qendror alokon për NjQV rreth 1% e GDP-së që është niveli më i ulët rajonal, duke mos i ndihmuar bashkitë në ushtrimin e plotë të kompetencave dhe në rritjen e nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve. Ndërmjet bashkive në rang vendi ekziston një pabarazi financiare dhe konstatohen ndërhyrje të pushtetit qendror në pushtetin vendor, me efekt negativ për buxhetin e bashkive dhe stabilitetin e autonomisë financiare”.*

Por, bashkitë burim kanë dhe të ardhurat e tyre, të ardhura që janë nga sektori rural bujqësor, toka, vaditje, pyje, kullota etj, si dhe nga taksa e tarifa të tjera për shërbime të caktuara, transkaksioni i pronave dhe nga biznesi dhe ekonomia private. Ajo që duhet të ndodhë është se këto bashki pritet të sigurojnë më shumë të ardhura nga toka dhe sektori i bujqësisë meqë pushteti është më afër dhe fuqia ekzekutive ka më peshë, por dhe ndjesia qytetare është më e lartë, pasi paguan për atë pushtet që ka mundësi ti ushtrojë presion dhe t’ja kontrollojë vendimarrjen më kollaj.

Referuar më sipër nënvizojmë se bashkitë e reja përse i përket burimeve ekonomike parimishtë dhe ligjërishtë do ta realizojnë ekonominë e tyre mbi këto ‘pushtete’

**a-Pushteti nga taksat** e bashkisë = taksa dhe tarifa vendore + taksat e ndara/banorë (totali taksave/tarifave për banorë)

**b-Pushteti financiar** i bashkisë = transferta qeveritare (sipas formulës) + transferta të kushtëzuara + të ardhura të veta + grante specifike/banorë.

**c-Shpenzimet e bashkisë:** bashkitë bëjnë këto shpenzime sot sipas këtyre tre grupeve kryesore: shpenzime për investime, shpenzime operative dhe shpenzime personeli. Sipas raporti te financa vendore.al botim i CO-Plan (<http://financatvendore.al>) për vitin 2022 raporti për të tre grupet ishte afërsisht si më poshtë: Shpenzime për investime 20-23%, shpenzime operative 31-33% dhe shpenzime për personelin 45%.

### V.III Cfarë pritet nga krijimi bashkive te reja?

Sot në një njësi administrative, (ish komuna dhe bashkia para reformës) në këto institucione në varësi të bashkive, ka një Administrator dhe ka zëvendësuar kryetarin e zgjedhur, dhe ka punonjës që punojnë sipas detyrave që ka njësi administrative që nuk janë ekzekutive. Sipas të dhënave tona numri i punonjësve në një njësi administrative varion nga 11-17 si mesatare. Por ka edhe njësi të shumta me një numër më të madh.

Nëse i referohemi të dhënave nga Shoqata e Komunave të cilit i referohet edhe studimi mbi reformën nga (SIDA) Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në vitin 2012, numri mesatar i punonjësve në një komunë ishte mesarisht sa është sot në një NjA. Por, nuk është ky qëllimi ynë, të krahasojmë të shkuarën, por të analizojmë impaktin nga riorganizimi i ri, i kostove dhe shpenzimeve për personel.

Studimi ynë që çon në shtimin e 33 bashkive të reja, dhe analiza njësi për njësi, na çon në këto rezultate. 33 bashkitë e reja krijohen nga bashkimi i rreth 100 njësive administrative. Në këto 100 NjA janë të punësuar mesatarisht 1100-1700 punonjës.

Këto i kushtojnë sot buxhetit bashkiak paga, sigurime etj. Me riorganizimin e ri këta punonjës do të vendosen në strukturën organike të 33 bashkive të reja tanimë më pushtet kushtetues dhe ekonomik, me kompetenca rregullatore, administrative, shërbime dhe investimi. Në një llogjikë të thjeshtë del që në një nga bashkitë e reja minimalisht të punojnë po aq sa po punojnë sot në NjA.

Pra numri i punonjësve në një bashki të re do të jetë nga 37-58 punonjës, ose mesatarisht jo më shumë se 50 punonjës në një bashki, bashkë me kryetarin. Ndërkohë që riorganizimi zëvendëson 100 administratorë me 33 kryetarë të zgjedhur.

Pra, krijimi i bashkive të reja në variantin optimal nuk do të ketë kosto shtesë për shpenzime personeli. Nje variant tjetër i mundshëm, por që nuk ka siguri, është që për territore më të vogla të cilat kane këto bashki nevojiten më pak kosto që vijnë nga një strukturë më efçente. Edhe pse mund të hamendësojmë shumë variante të shpenzimeve për personel, ajo që na bind është se nuk ka humbje ekonomike nga krijimi i bashkive të reja së paku nga kostot për shpenzime personeli. Por edhe nëse kërkohet një numër më i madh personeli, dhe ka disa kosto shtesë më të larta operative, sërisht ndikimi i madh që ka ofrimi i pushtetit afër qytetarit, dhe avanazhet e tjera që kemi analizuar më sipër i bëjnë këto kosto të padiskutueshme në ekonominë kombëtare.

Duke mbajtur parasysh analizën më sipër, për një decentralizim asimetrik, por edhe rajonalizimin e shërbimeve publike, furnizimi me ujë në vazhdim etj) potencialisht nuk ka rrezik për kosto të shtuara për stafe të pajustificuara. Sikundër sistemi i qeverisjes vendore është asimetrik në shumë parametra si popullësi dhe sipërfaqe etj, dhe i tillë është kudo, dhe modeli në Shqipëri mund të jetë i tillë dhe ne s’kemi pse frikësohemi kur themi se do të krijohen njësi vendore rurale dhe me kompetenca të caktuara.

***Nëse bëjmë një përmbledhje se çfarë presim nga bashkitë e reja konkludojmë se potencialisht do të kemi:***

- Përmirësimi i menaxhimit të territorit të ri vendor më të përqendruar urban dhe rural.
- Mbrojtja e territorit, veçanërisht me veprimtari për shfrytëzim të pakontrolluar të pyjeve dhe pasurive të tjera rurale.
- Menaxhimi i tokës, pyjeve, kullotave për shkak të mungesës së rrjeteve të ujitjes, kanalizimeve etj.
- Një menaxhim më i mirë i territorit në zona rurale dhe qyteza
- Territori dhe konfigurimi i ri do të shoqërohet me shumë dinamizëm dhe konkurrueshmëri institucionale por jo vetëm.
- Rritja e punësimit të të rinjve, rivitalizim të jetës në fshatra, ‘amortizim’ i shpopullimit etj.
- Një dimension i ri i zhvillimit ekonomik rural, duke krijuar një nyje administrative dhe ekonomike, sociale dhe politike. etj

Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore, ndonëse me peshë ndjeshëm më të ulët sesa të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën, kontribuan me rreth 584 milionë lekë (në rritje me rreth 7% në terma vjetorë) në kategorinë e të ardhurave nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme në vitin 2021. Në ndryshim nga elementi i përqendrimit të të ardhurave nga taksa e ndërtesës në një numër të kufizuar bashkish, të ardhurat nga taksa mbi token bujqësore rezultojnë të jenë të shpërndara ndërmjet bashkive. Niveli më i lartë i kësaj takse u mblodh në bashkinë Fier (rreth 14% e totalit), Divjakë (rreth 5% e totalit) dhe Rrogozhinë (rreth 5% e totalit), lidhur dhe me karakterin bujqësor të ekonomive të këtyre bashkive. ( <http://financatvendore.al> )

Këto shifra në arsyetimin tonë shkakun e kanë së pari në pafuqinë e bashkisë qendër për të kontrolluar territorin në largësi gjeografike të tilla, në interesin e ulët, në organizimin strukturor të bashkisë dhe të njësisë administrative, në faktin e perceptimit që qytetarë në zona rurale me “nuk kam përfaqësim, nuk paguaj” mungesa e një inventari të fermerëve dhe fermave apo bizneseve agrobujqësore, por dhe presioni i ulët administrativ etj.

Ndaj, një zgjedhje alternative është ristrukturimi organizativ i bashkive, për të transferuar peshën politike, administrative dhe financiare në këto entitete rurale.

#### -Shërbimet dhe funksionet e tjera

Por edhe përsa i përket financimit të funksioneve të transferuara në pushtetin vendor në vitin 2016, në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale në vlerën 8.7 miliard lekë. Në buxhetin e vitit 2022, <https://financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2022/> transfertat e pakushtëzuar sektoriale për: Arsimin parashkollor është rritur me 11 përqind; Arsimin parauniversitar është rritur me 6 përqind; Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi është rritur me 13 përqind; Administrimi i pyjeve është rritur me 17 përqind; Ujitjen dhe kullimin është rritur me 7 përqind, Rrugët rurale është rritur me 8 përqind.

#### -Pabarazi në shpërndarjen e shërbimeve.

Shifrat tregojnë një nënfinancim për këto shërbime në tërësi. Por problem tjetër dhe më me rëndësi këtu është se sa përqind e kësaj shume kanë shkuar për shërbime, dhe investime në ish komuna/njësi administrative. Nga të dhënat tona për 100 lek investime të bashkisë shkon deri në 10-15% në zona rurale, për të njëjtin numër popullësie. (sipas Census 2011 në zona rurale bëjnë 48% e popullësisë) Pra aspekti financiar dhe ekonomike, edhe pse me rëndësi nuk është argument i fortë për të qëndruar me këtë konfigurim territorial siç e kemi sot. Por edhe konsolidimi nuk ul domosdoshmërisht kostot, dhe kjo nuk duhet të krijojë asnjë panik.

#### Përfaqësimi qytetar në vendimmarrje

Është një boshllëk tjetër shumë i madh dhe me peshë të madhe, marrë në konsideratë dhe nivelin e demokracisë dhe kulturës tonë kombëtare dhe ashpërsisë politike që ekziston te ne.

Në këtë aspekt vihet re qartë se në 61 bashkitë që ka sot vendi, mbi 80-90% e keshilltarëve (1600 gjithsej) përfaqësojnë zona urbane në shkallë kombëtare. Edhe këtu problemi mendoj se kërkon zgjidhje nga aspekti i riorganizimit territorial sesa administrativ. Dhe kjo arrihet me rikonfigurimin territorial dhe administrativ të bashkive sipas qarqeve aty ku mundet dhe domosdoshmërisht duhet. Ndaj, një numer më i madh bashkish në zona rurale do e çonin edhe pushtetin politik dhe përfaqësimin me të drejtë ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Analiza më poshtë tregon sa është ky boshllëk përfaqësimi dhe si kompozohet. Koncepti klasik i decentralizimit vjen nga filozofi dhe ekonomisti i shquar, John Stuart Mill. “*Qëllimi i të pasurit një përfaqësim lokal nënkupton që ata që kanë interesa të përbashkëta, të cilat nuk i ndajnë me bashkatdhetarët e tjerë në tërësi, mund t’i menaxhojnë vetë interesat e tyre. Çdo qytet ka interesa specifike, qoftë i vogël apo i madh, por që janë të përbashkëta për komunitetin e si rrjedhim çdo qytet, pa dallim shtrirjeje gjeografike apo popullësie, duhet të ketë këshillin e vet. Dhe këtë duhet ta arrijmë.*”

Siç është analizuar dhe argumentuar më sipër përsa i përket kriterit popullsi në ndarjen territoriale sërisht nuk gjenden lidhje të forta, por kjo lidhje është më së shumti një vullnet i përshtatshmërisë

me kontekstin lokal. Analiza dhe shifrat tregohen se vende të ndryshme kanë numër popullsie të ndryshëm për njësi të qeverisjes vendore siç kemi shpjeguar më sipër nga praktikat në vende të ndryshme.

#### Ngarkesa administrative në kolonat e arkitekturës së shtetit

Sipas Instat-it në Shqipëri ka afërsisht 1200 agjensitë/institucione qeveritare dhe jo qeveritare që përbëjnë arkitekturën e shtetit shqiptar nga aspekti i politikave dhe shërbimeve publike dhe administrative. Ajo që bie nëse këtu është fakti se nga 1200 të tilla rreth 900 i përkasin pushtetit qëndror dhe 300 atij vendor (bashki, ndërmarrje publike dhe institucione në varësi të bashkive). Ne nuk kemi qëllim në këtë rast të analizojmë arkitekturën, numri apo marrëdhëniet ndërmjet tyre. Por ajo që duam të theksojmë në këtë analizë të arkitekturës është fakti se edhe shtimi me 33 bashki të reja që konsolidojnë mirë qeverisjen vendore, territorin rural, por dhe atë urban, nuk krijojnë ngarkesë administrative që shaktojnë lodhje të kësaj arkitekture nga pikëpamja administrative.

[http://www.instat.gov.al/media/401906/nd\\_rmarrjet\\_n\\_sektorin\\_public\\_n\\_shqip\\_ri\\_shtator\\_2017.xlsx](http://www.instat.gov.al/media/401906/nd_rmarrjet_n_sektorin_public_n_shqip_ri_shtator_2017.xlsx)

#### Riorganizimi territorial përballë risqeve

Më poshtë do të analizojmë shkurt lidhjet midis risqeve potenciale nga riroorganizimi dhe niveli i tyre. Çdo reformë e tillë në territorin por edhe çdo ndryshim strukturor në çfarëdo niveli organizimi qëndror apo vendor, sigurisht ka risqe. Por, është me rëndësi që risqet të jenë sa më të lehta dhe me ndikim të ulët siç kemi analizuar në këtë studim. Sipas mendimit tonë referuar tërë informacionit që ne kemi mbi situatën, mbi administratën publike dhe vendore, kulturën organizative dhe sjelljen e saj, dimensionin politik me qasje konsensuale interesin e madh qytetar etj, mendoj që raporti i rriskut me nivelin është si me poshtë:

Kategoria e riskut	Niveli i riskut
Rrisku strategjik	I ulët
Rrisku financiarë	Nga i ulët në mesatar
Rrisku juridik/ rregullatorë	Nga i ulët në mesatar
Rrisku operacional	I mesëm

\*më lart analizuar në kapitullin ‘Përgatitje për rishikimin e reformës territoriale’ faktorët që na konkludojnë këtu.

#### Modeli dhe Nivelet e pushtetit vendor, boshllëku dhe prespektiva

Edhe kjo çështje e modelit dhe nivelet e pushtetit vendor ka pikëpyetjet e veta dhe zgjidhjet nuk janë të lehta. Siç kemi treguar më sipër dhe me figurë në vende të ndryshme kanë model dhe nivel të ndryshëm të pushtetit vendor. (ref tab Nalas dhe CMRE) Disa vende fqinje si Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova nuk kanë nivel të dytë të pushteti vendor. Vende të tjera e kanë atë.

Shqipëria ka një histori të qëndrueshme me nivelin e dytë. “Rrethi” si nivel i dytë i pushtetit vendor në Shqipëri i ka rezistuar kohët më shumë se sa çdo nivel tjetër në këto 100 vite. Pas viteve 1990 rrethi pati një rol me peshë në qeverisjen vendore deri në vitin 2000. Deri në atë kohë Shqipëria kishte 36 rrethe. (ligji 7572/1992 “per pushtetin vendor”) në vitin 2000 u bë një ‘reformim i këtij pushteti të nivelit të dytë, duke kaluar nga 36 rrethe në 12 qarqe. Duhet theksuar perceptimi i ‘rrethit’



të dikurshëm ndihet mjaft mirë edhe sot. Sipas opinionit tonë ka ardhur për dy arsye.

Së pari, se 36 rrethet kanë pasur funksionalitet të mirë dhe qytetet por jo vetëm e kanë ndjerë peshën qeverisëse të rrethit, por edhe arsye tjetër që e lidhim me faktin e bindjes se pesha e 12 këshillave të qarqeve ka një rënie të ndjeshme pas vitit 2000. Akoma më e zbehtë është roli i këtij niveli pas vitit 2013, dhe me krijimin e 61 bashkive thuajse është jashtë loje, dhe nuk bëhet fjalë të shikojmë performancën. Literatura dhe praktikat shikojnë një lidhje të peshës së këtij niveli me numrin por dhe pushtetin e nivelit të parë. Duhet theksuar se reforma e 2014 krijoi 18 bashki mbi bazë rrethi. (Kuçova-Dibër-Bulqizë-Krujë-Peqin-Gramsh-Mallakastër-Kolonjë-Devoll-Pogradec-Kukës-Has-Tropojë-Lezhë-Mirditë-Kurbin-Malësi e Madhe-Delvinë)

Pra, një numër i vogël dhe pushtet i madh për bashkitë si niveli i parë i qeverisjes vendore, e nxjerrin qarkun si nivel të dytë në hije të plotë. Por, ndodh e kundërta. Një numër më i madh njësisish vendore në nivelin e parë, një decentralizim asimetrik, dhe dhënia e përgjegjësive ekzekutive e forcojnë rolin e nivelit të dytë. Nga ana tjetër, hipotetikisht nëse shkohet te modeli i 36 rretheve, 36 bashki, atëherë mendoj se niveli i dytë është i panevojshëm.

## VI Reformimi i nivelit të dytë dhe rajonet zhvillimore

Një qartësim: Në Shqipëri sot kemi Ligjin Nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”. Ky ligj ka për qëllim sipas përcaktime në nenin 2:

### Qëllimi i ligjit

- a) të përcaktojë instrumentet e posaçme dhe kuadrin institucional e financiar për zhvillimin rajonal dhe kohezionin në Republikën e Shqipërisë;
- b) të përcaktojë kuadrin strategjik dhe institucional të hartimit të politikave afatgjata zhvillimore rajonale në zbatim të politikave kombëtare, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, shoqëror e kulturor rajonal;
- c) të sigurojë që autoritetet politikëbërëse të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të rajoneve;
- d) ç) të sigurojë harmonizimin e strategjive sektoriale në një politikë të përbashkët zhvillimore rajonale, duke e mbështetur atë edhe me buxhetin përkatës.

Rajonet e zhvillimit:

1. Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në katër rajone zhvillimi.
2. Rajonet e zhvillimit janë territoret për të cilat hartohet, zbatohet dhe vlerësohet politika kombëtare për zhvillimin dhe kohezionin rajonal. Rajonet e zhvillimit nuk janë njësi administrative në kuptim të legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

Kemi dhe studime të Coplan (<https://www.co-plan.org/en/publikimet/>) dhe programe që mbështesin zbatimin e këtij ligji (co-funded by the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and the Austrian Development Agency (ADA), implemented in partnership with the Government of Albania. <http://rdpa.al/programme-summary-2/>)

Në këtë studim ne nuk do analizojmë këtë ligj, pasi ligji vetë shprehet qartë se nuk po krijojnë rajone si njësi administrative të në kuptimin e nivelit të dytë të qeverisjes vendore, por qartësojmë për të theksuar se propozimi ynë për reformimin e nivelit të dytë mund të realizojë një sinergji të mirë me

qëllimin e këtij por dhe me përgjegjësi të tjera siç kemi propozuar, por çështja e numrit është objekt diskutimi dhe çështje e vendimmarresit.

Në raportin që ne prezantojmë, i referohemi nivelit të dytë të pushtetit vendor sipas përkufizimeve ligjore që përcakton Kushtetuta dhe ligji për qeverisjen vendore, si njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore neni 5 pika 4, ligji 139/2015 dhe si përfaqësues të një uniteti administrativo-territorial, të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike dhe interes të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhem me kufijtë e bashkive që e përbëjnë atë sipas nenit 5 pika 5 e Ligjit 139/2015. Në qasjen tonë dhe në parimin e racionalitetit të të mirave të prodhuara, sugjerojmë që përgjegjësitë, detyrat dhe roli i përcaktur nga ligji për ndarjen dhe kohezionin social, ti transferohen rajoneve të reja, të cilat janë organe kushtetuese dhe më përfaqësues nga bashkitë (ekzekutivi dhe legjislativi).

## VI.I Konfigurimi aktual

Ndarja administrative 2015\* (12 qarqe dhe 61 bashkitë përbërëse të çdo qarku)

1. Qarku Berat: Bashkitë: Berat, Ura Vajgurore, Kuçovë, Skrapar, Poliçan
2. Qarku Dibër: Bashkitë: Peshkopi, Bulqizë, Burrel, Klos
3. Qarku Durrës: Bashkitë: Durrës, Shijak, Krujë
4. Qarku Elbasan: Bashkitë: Elbasan, Cerrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd, Përrenjas
5. Qarku Fier: Bashkitë: Fier, Patos, Roskovec, Lushnje, Divjakë, Ballsh
6. Qarku Gjirokastrë: Bashkitë: Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Dropull
7. Qarku Korçë: Bashkitë: Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll, Pogradec
8. Qarku Kukës: Bashkitë: Kukës, Has, Tropojë
9. Qarku Lezhë: Bashkitë: Lezhë, Mirditë, Kurbin
10. Qarku Shkodër: Bashkitë: Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fush- Arrëz
11. Qarku Tiranë: Bashkitë: Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë Rrogzhinë
12. Qarku Vlorë: Bashkitë: Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq, Delvinë.

Struktura e shtetit unitar

Qeveria qendrore
Qeverisje vendore
12 Këshilla Qarqesh Këshilli i përbërë nga përfaqësues të nivelit të ulët I zgjedhur në mënyrë indirekte kryetar këshilli me funksion ekzekutiv
61 bashki Këshilli i përbërë nga anëtarë të zgjedhur drejtpërdrejt Kryetar i këshillit i zgjedhur në mënyrë direkte nga rradhët e këshilltarëve Kryetar i zgjedhur drejtpërdrejt me funksion ekzekutiv
340 Njësi Administrative Njësitë administrative (ish komunat) me rol jo ekzekutiv, jo të zgjedhur, pa pushtet ekonomik dhe juridik.

2995 fshatra- struktura komunitare të përbëra nga kryetarët e fshatit, rol pjesëmarrës
--

Burimi: \*Ligji 115/2014 për ndarjet territoriale në Republikën e Shqipërisë.

Praktika në vende të ndryshme



Burime: UN Women Review of Local Government Organization. Based on 120 countries.

Kuadri ligjor për nivelin e dytë

Ashtu si për nivelin e parë – bashkitë, edhe për nivelin e dytë – qarqet, është përcaktimi kushtetues (ref. neni 108-113) si dhe ligji 139/2015 ‘për vetëqeverisjen vendore’.

Por edhe këtu për të përcaktuar sa nivele pushteti vendor na duhet sërish duhet të shikojmë disa kritere.

Në aspektin e teorisë ekonomike, roli kryesor caktuar për qeveritë rajonale ose vendore është që të ofrojnë shërbime brenda një zone gjeografike të caktuar për banorët që janë të gatshëm të paguajnë për to.

**Efikasiteti** i këtij niveli varet nga roli dhe funksionet që i jep qeveria qendrore por edhe vetë niveli i parë i pushtetit vendor. Por në çdo rast vlera e këtij niveli qëndron kur përfitimet nuk kalojnë në juridiksionet fqinje si rezultat i koordinimit të mirë. Por në çdo rast në respekt të parimit të ‘Subsidiaritetit dhe Përgjegjshmërisë Lokale’. Në kontekstin e përdorimit të fondeve me destinacion rajonal, efikasiteti i këtij niveli merr një rëndësi akoma më të madhe por dhe strategjike dhe integrues.

**Eksternalitetet.** Ofrimi i disa shërbimeve rezulton në eksternalitetet. Sipas Boyne, George, 1992, Supra, fq. 336. kostot e një shërbimi specifik në një juridiksion lokal të shpërndahen në banorë të një juridiksioni tjetër. Për shembull, një rrugë në një bashki mund të ofrojë përfitime për banorët e bashkive fqinje të cilët gjithashtu ngasin mbi të. Por edhe një veper arti, apo urë me interes ndërbashkiak. Një mënyrë për të hequr atë që rezulton joefikase dhe me prioritet për secilën njësi vendore është të dizajnosh një nivel të dytë qeverisjeje me juridiksione administrative në mënyrë që të gjitha përfitimet nga një shërbim i caktuar publik të gëzohen brenda kufijve të këtij territori rajonal.

Por, kjo kërkon një strukturim të qartë të shpërndarja e përgjegjësisë të shpenzimeve në një model me dy nivele, dhe kjo kërkon një analizë më të thelluar.



### Konsolidimi i nivelit të dytë midis avantazheve dhe disavantazheve

#### **Avantazhet:**

- Efektivitet në shërbimet të rajonalizuar.
- Rishpërndarja ndërmjet zonave të pasura dhe të varfra
- Koordinimi i ofrimit të shërbimeve
- Më shumë ndikim lokal me politikëbërësit kombëtarë
- Veprime më të unifikuara për problemet rurale që bëjnë mos respektimi kufijtë politikë p.sh. përmbajtjet, epidemitë, krimi dhe ndotja e mjedisit,

#### **Disavantazhet:**

- Kërcënimi për autonominë lokale, përgjegjshmërinë dhe angazhimin qytetar
- Rajoni mund të jetë shumë i madh për të qenë i pranueshëm.

### Perspektiva Evropiane

Niveli i dytë i qeverisjes vendore sot në kushtet e globalizimit, politikave të kohezionit rajonal, në frymën e rajonalizimit por dhe faktorë të tjerë nga prespektiva evropiane duhen konsideruar. Qoftë politika e BE për rajonet dhe makrorajonet, por edhe referuar rezolutave të Kongresit të autoriteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës, sugjerojmë konfigurim tjetër edhe për nivelin e dytë ashtu si dhe për nivelin e parë.

*(Autoritetet vendore të nivelit të dytë – qeverisja e ndërmjetme në Europë: Rezoluta 351 (2012)*

*1. Shumë shtete anëtare në Këshillin e Evropës kanë një traditë të gjatë të një strukture të qeverisjes vendore të organizuar në disa nivele. Secili vend, sipas traditave dhe historisë së tij, formon arkitekturën e tij institucionale, me synimin për të arritur ofrimin e shërbimeve më të synuara, një nivel të mirë përfaqësimi politik me transparencë dhe llogaridhënie dhe një shpërndarje efektive të kompetencave midis niveleve të ndryshme të qeverisjes.*

*2. Për më tepër, në shumicën e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, një sërë funksionesh të rëndësishme u janë besuar autoriteteve lokale të ndërmjetme, si ato që kanë të bëjnë me mjedisin, zhvillimin ekonomik, transportin dhe arsimin. Për këto funksione këto autoritete kanë burimet e tyre. Në përputhje me parimin e autonomisë fiskale, ato autoritete të ndërmjetme përfitojnë nga burimet fiskale.)*

\*BE-ja imponon ndonjë kërkesë (rrallë) sa i përket organizimi territorial, i cili mund të shihet nga larmishmëria e marrëveshjeve në shtetet anëtare ekzistuese Në të vërtetë Traktati mbi Bashkimin Evropian (neni 4) specifikon se Bashkimi do të respektojë identitetet kombëtare përsa i përket strukturave politike dhe kushtetuese të qeverive rajonale dhe lokale.

Shqipëria si vend që ka hapur negociatat me BE (korrik 2022) punon për hartimin e të dhënave rajonale për PBB sipas klasifikimit NUTS (treguesit ekonomikë sipas rajoneve NUTS janë përcaktuesit e rëndësishëm të përshtatshmërisë për fondet strukturore të BE). Por duhet theksuar se përcaktimi i rajoneve NUTS as kërkon e as parandalon një reformë territoriale.

Rajonet NUTS\* janë përcaktuar në bazë të disa kriterëve të popullsisë:

NUTS I (3-7 milionë banorë për vendet e mëdha apo të gjithë vendin për ato të vogla),  
NUTS II (800,000-3 milionë) dhe NUTS III (150,000-800,000).

Në përgjithësi, ata janë të lidhur me rajonet ekzistuese administrative sipas kësaj ndarjeje të numrit të popullsisë. Por në qoftë se nuk ka asnjë ndarje administrative që korrespondon me një nivel të caktuar NUTS, nuk ka kushte për ti krijuar ato (ose për të ndryshuar ato ekzistuese). Kjo nuk do të thotë që nuk ngrihen çështje për "rajonalizimin" apo zhvillimin ekonomik rajonal në debatin politik kombëtar, por për disa shtete anëtare, një apo më shumë nivele të NUTS përbëjnë thjesht çështje statistikore.

Situata e Shqipërisë është si vijon. Vendi në tërësi do të jetë një rajon NUTS i vetëm. 12 qarqet ekzistuese korrespondojnë me nivelin NUTS III (150,000-800,000 banorë), por po kështu do të formonin dhe nëse do të kishim më pak qarqe pas riorganizimit. Numri i rajoneve NUTS II është fleksibël: Shqipëria mund të zgjedhë midis një dhe tre (të cilët do të formoheshin secili nga dy ose më shumë qarqe aktuale).

Çështja thelbësore është se përcaktimi i rajoneve statistikore nuk rregullon çështje të ndryshme lidhur me reformën territoriale. Të gjitha këto, për shembull, janë krejtësisht të realizueshme, sipas raportit të SKL int\_Sida\_ShKSh kemi:

- tre rajone NUTS II (thjesht) statistikore me 12 qarqet ekzistuese si rajone administrative NUTS III
- një rajon statistikor NUTS II me 4-6 rajone administrative të reja NUTS III
- një deri në tre rajone administrative si NUTS II me qarqet e vjetra që do të mbesin si rajone statistikore NUTS III.

 *NUTS 1 = makroqarqet e vendeve anëtare të Europës (nga 3 -7 milionë banorë)*

*NUTS 2 = qarqet e vendeve anëtare të BE-së (nga 800,000 - 3 milione banorë)*

*NUTS 3 = nënqarqet e NUTS 2 (midis 150,000- 800,000 banorë)*

*NUTS 4 = nivelet lokale (mikroqarqet)*

*NUTS 5 = niveli më i ulët vendor, bashkitë.*

*Tregues të Zhvillimit Rajonal /Indikatorët e zgjedhur, 2018*

*Sources: MULTI-DIMENSIONAL REVIEW OF THE WESTERN BALKANS © OECD 2021*

*Honorati et al. (2018[10]), Job Dynamics in Albania: A Note Profiling Albania's Labour Market,*

*<http://documents.worldbank.org/curated/en/209671528985738916/pdf/Albania-Job-Dynamics-Final.pdf> ;*

*INSTAT (2019[5]), Regional Statistics Yearbook, 2019, [www.instat.gov.al/media/6470/rsy\\_compressed.pdf](http://www.instat.gov.al/media/6470/rsy_compressed.pdf)*

*(modifikimi i tabelës nga eksperti).*

Rajoni (qarku)	Popullësia (total)	Nr i bashkive 2015	Popullësia (%)	GDP për frymë	Shkalla e brendshme neto e migrimit për 1000 banorë	Shkalla e punësimit	Shpërndarja e it (% e totalit të të punës)	Varfëria (2012)	Mjekët për
Tiranë	889 578	5	31.7	7 065	8.1	48	52	13.9	1.5
Fier	296 446	6	10.6	5 258	-3.0	58	7	17.1	1.1
Durrës	289 877	3	10.3	5 069	2.8	48	12	16.5	1.4
Elbasan	276 765	7	9.9	3 565	-4.6	61	5	11.3	1.1
Korçë	209 034	6	7.5	3 811	-4.0	63	4	12.4	1.2
Shkodër	203 945	5	7.3	3 679	-2.3	57	5	15.5	1.1
Vlorë	126 294	7	4.5	4 294	-7.8	56	5	11.1	2.0
Berat	126 294	5	4.5	4 265	-7.8	66	3	12.3	1.3
Lezhë	125 998	3	4.5	3 792	-2.3	42	3	18.4	1.2
Dibër	119 963	4	4.3	3 830	-13.6	46	2	12.7	0.9
Kukës	76 994	3	2.7	3 093	-8.8	61	1	22.5	1.3
Gjirokastrë	62 188	7	2.2	5 183	-13.4	63	2	10.6	1.9
		<b>61</b>							

Përgjegjësitë, funksionet dhe shpenzimet për nivelin e dytë

*Potencialisht* niveli i dytë mund të kryejë disa funksione sipas tabelës më poshtë. Por, kjo kërkon një analizë më të thellë pasi të vendoset konfigurimi i këtij niveli, dhe paralel me ushtrimin për decentralizimin asimetrik siç kemi shpjeguar më sipër. Gjithsesi, ne po bëjmë një parashikim se çfarë funksionesh mund të marrë.

<b>Funksioni</b>	<b>Justifikimi</b>
Planifikim urban në Bashki- Njësitë e reja por edhe të tjera	Bashkitë, kryesisht ato rurale, por edhe të tjera për arsye të kapaciteteve por edhe për arsye të harmonizimit të politikave mund t'ja kërkojmë këtij niveli këtë shërbim.
Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri	Një sistem më i përqëndruar me këtë shërbim mund ti shërbejë më me energji të përqëndruar njësisive vendore
Shërbimin për parqet rajonale	Me të njëjtin justifikim për bashkitë, por edhe për të lehtësuar punën e bashkive dhe më shumë kordinim
Planifikim dhe projektim për sistemin e ujit dhe kanalizimeve	Në kuadër të rajonalizimit të këtij shërbimi, niveli i dytë mund të hartojë projekte ndërbashkiake.
Strehim social	Këtu mund të marrë një rol më të madh për faktin se shumë bashki edhe sot e kanë problem, por edhe për faktin se bashkitë mund të hartojnë listën dhe prioritetet dhe niveli i dytë mund të jetë siguresi i këtij shërbimi vendor dhe ndërvendor.
Roli social, arsimit dhe shërbimi shëndetësor parësor	Politika të harmonizuara dhe përqëndruara në këto dy sektorë mund të jenë me efektive, ndërlidhja me agjensitë e punës, shëndetësisë dhe arsimit.
Administrimi i sistemeve ujore/bazeneve	Një rol rregullator dhe kontrollor do ishte një shërbim përtej një njësie vendore.
Roli si zhvillues dhe konsulent rajonal	Bashkitë sipas nevojës mund të kërkojnë këto asistencë apo konsultime në nivelin e dytë.


Edhe në këtë rast, kërkohet më shumë analizë që do ti lidhin këto funksione me buxhetet përkatëse pasi të qartësohen edhe llojet e kompetencave për çdo funksion si psh, kompetenca rregullatore, administrative, shërbime dhe investimi. Theksojmë se këto duhet të rregullohen me ndryshime dhe akte ligjore parësore dhe dytësore.

Nga analizimi i problemeve, analiza e funksioneve, ajo e politikave dhe çfarë problematikash shfaq sot organizimi i pushtetit vendor, qoftë nga aspekti territorial dhe ai rregullator, sugjerojmë zgjidhje duke ndjekur kuadrin logjik të **McKinsey 7S Framework**.

Në vijimësi të analizës së boshllëqeve kemi ndjekur këtë model pasi na bën të qartë se si elementet

organizative në konsolidime institucionale dhe administrative janë të ndërlidhura, dhe merret parasysh ndikimi më i gjerë i ndryshimeve të bëra në fushën e pushtetit vendor.

**Vizioni:** Shqipëria ka një pushtet vendor të konsoliduar me përfaqësim qytetar, efektiv, dhe të decentralizuar. Ky vizion qëndron në rrugën evropiane të integritit të Shqipërisë dhe kërkon ndërhyrje në sistem.



**Sistemi:** sistemi që kemi sot i pushtetit vendor është me dy nivele. Edhe këtu ngrihet pyetja: me dy apo një nivel. Siç kemi analizuar më sipër dhe referuar praktikave nga vende të ndryshme, sistemi aktual me dy nivele është koherent. Por, ky sistem kërkon rregullime dhe korrigjime të të dy niveleve.

Sistemi me dy nivele ka vlere të rëndësishme edhe përsa i përket qasjeve demokratike për qeverisjen me shumë nivele (multi level governance) që lidhet me shpërndarjen e pushtetit dhe shërbimeve vertikalisht dhe horizontalisht. Por edhe nivele të ndryshme përfaqësimi janë të shëndetshme për demokracinë.

Sugjerojmë që Shqipëria sërisht edhe me këtë reformë riorganizimi për konsolidimin e pushtetit vendor të mbajë dy nivele të pushtetit vendor.

**Struktura** e pushtetit vendor: siç tregohet në analizën më sipër edhe struktura e ndarjes dhe organizimit të pushtetit në dy nivele duhet të ndryshojë drejt interesave qytetare për më shumë shërbime demokrati lokale dhe qeverisje sa më afër të mundshme për qytetarët edhe të largët në vendbanime.

Sugjerojmë që të shtohen njësi të qeverisjes vendore. Sipas analizës tonë bazuar në kriteret më sipër, ky numer shkon diku dhe jo më shumë se 33 bashki të reja. (lista me poshtë).

Pra, ne sugjerojmë që numri i njësi në nivelin e parë të pushtetit vendor të jetë 61+33 bashki të

reja. (Shiko listën më poshtë). Me këto riorganizime mendojmë që koncepti i njësisë administrative vjen duke u shuar si koncept dhe strukture administrative. Kjo kërkon dhe akte ligjore ose akte të këshillit bashkiak. Po kështu, sugjerojmë që pozicioni i administratorit e humbet kuptimin, tani meqë kemi bashki me të mbledhur (territor homogjen) me administratë dhe institucione të zgjedhura: kryetar dhe këshill bashkiak. Pra, bashkitë e reja janë juridiksione territoriale homogjene, janë juridiksione administrative të përqendruar si një e tërë dhe e vetme, bashkia është entitet kushtetuesi dhe bashkitë ekzistuese. Përgjegjësite dhe kompetencat janë subjekt i ndryshimeve ligjore, që na çojnë në një decentralizim asimetrik. (jo çdo njëra është në gjendje të bëj gjithçka).

Në përgjithësi, për kategorizimin e bashkive, ekzistojnë tre lloje bashkish me qasje asimetrike:

1. bashki urbane (kufijtë e tyre përfshijnë zonën urbane);
2. bashki urbane-rurale, të cilat përfshijnë si qytetet brenda kufijve administrativë, ashtu edhe zonat jashtë kufijve të qytetit;
3. bashki rurale pa qytete brenda territorit të tyre, ose me një qendër qyteze. Struktura e bashkive të propozuar në këtë studim i përket grupit të tretë. (lista më poshtë).


## VII. Reformimi i nivelit të parë

### VII.I Fakte shifra të dhëna krahasimore për bashkitë sot dhe pas ndryshimeve

Ndryshimet që ne propozojmë nuk kanë ndonjë ndikim të dukshëm përse i përket lidhjes ndërmjet numrit të popullsisë për njësi të qeverisjes vendore. Kështu siç tregon dhe tabela dhe grafiku, propozimi ynë:

- e rrit numrin e bashkive me popullsi nën 10 000 banorë krahasuar me 2 të tilla nga reforma e 2014 në 9.
- ndërsa bashki në fashën 10-20 mijë propozimi ynë krijon 21 të tilla, nga 12 që krijoi reforma 2014.
- ndërsa për fashën e popullsisë 20-30 mijë propozimi ynë krijon 12 nga 4 që krijoi reforma 2014.
- në fashën e popullsisë 30-40 mijë krijohen 16 bashki nga 10 që krijoi reforma e vitit 2014.
- në fashën e popullsisë 40-50 mijë nga propozimi ynë krijohen 15 bashki nga 9 që krijoi reforma 2014.
- në fashën 50-60 mijë me propozimin tonë do të ketë 10 bashki nga 7 në reformën e 2014.
- në fashën 60-70 mijë numri i bashkive ndryshon nga 1 në asnjë.
- në fashën 70-80 mijë numri i bashkive bie në 1 nga 2 të tilla nga reforma e 2014.
- në fashën 80-90 mijë nuk ndryshon, mbetet përsëri 2.
- në fashën 90-100 mijë do të ketë vetëm 1 bashki nga 2 me reformën e 2014.
- në fashën 100-200 mijë nuk ndryshon, mbetet përsëri 4.
- në fashën 200-300 mijë do të ketë vetëm 2 bashki nga 4 me reformën e 2014.
- në fashën 300-400 mijë në projektin tonë nuk krijohet asnjë bashki, krahas 1 që krijoi reforma e 2014 me këtë fasho.
- në fashën mbi 400.000 ishte 1 bashki dhe mbetet po një në projektin e riorganizimit.

Popullsia	2015		2023	
	Nr i Bashkive	Bashkitë	Nr i Bashkive	Bashkitë
Deri në 10000	2	Libohovë, Pustec	9	Shishtavec, Orosh, Voskopojë, Libohovë, Pustec, Leskovik, Lunik, Kolonjë, Ksamil
10000 - 20000	12	Klos, Memaliaj, Përmet, Kolonjë, Delvinë, Poliçan, Skrapar, Tepelenë, Pukë, Konispol, Këlcyrë, Fushë Arrëz	21	Klos, Shpirag, Memaliaj, Përmet, Delvinë, Skrapar, Kastriot, Tepelenë, Drenovë, Pukë, Maqellarë, Poliçan, Kotë, Fratar, Konispol, Orikum, Këlcyrë, Bicaj, Fushë Arrëz, Shupenzë, Lurë
20000 - 30000	4	Tropojë, Himarë, Has, Dropull	12	Bregu i matët, Bulqizë, Tropojë, Mirditë, Himarë, Mallakastër, Pojan, Has, Dropull, Milot, Otlak, Selenicë
30000 - 40000	10	Bulqizë, Mallakastër, Mat, Mirditë, Finiq, Gramsh, Belsh, Selenicë, Prrrenjas, Roskovec	16	Kukës, Bradashesh, Shpat, Mat, Krujë, Starovë, Finiq, Dibër, Zadrimë, Gramsh, Librazhd, Belsh, Dushk, Prrrenjas, Roskovec, Novoselë
40000 - 50000	9	Cërrik, Shijak, Librazhd, Rrogozhinë, Patos, Devoll, Vorë, Dimal, Peqin	15	Sarandë, Fushë Krujë, Cërrik, Farka, Shijak, Levan, Kuçovë, Maliq, Rrogozhinë, Ardenicë, Patos, Devoll, Vorë, Dimal, Peqin
50000 - 60000	7	Kukës, Sarandë, Divjakë, Malësi e madhe, Kucovë, Vau i Dejës, Gjirokastër	10	Divjakë, Pogradec, Malësi e madhe, Lushnjë, Kurbin, Sukth, Vau i Dejës, Gjirokastër, Lezhë, Dajt
60000 - 70000	1	Maliq	0	
70000 - 80000	2	Dibër, Kurbin	1	Berat
80000 - 90000	2	Kavajë, Krujë	2	Kavajë, Kashar
90000 - 100000	2	Berat, Pogradec	1	Korçë
100000-200000	4	Kamëz, Lushnjë, Korçë, Lezhë	4	Vlorë, Elbasan, Fier, Kamëz
200000-300000	4	Elbasan, Shkodër, Fier, Vlorë	2	Durrës, Shkodër
300000-400000	1	Durrës	0	
mbi 400000	1	Tiranë	1	Tiranë



### Ku ndodh riorganizimi i bashkive?

Siç kemi shpjeguar më lart, ndarja dhe riorganizimi brenda qarkut ka qënë kriter baze për riorganizimin e nivelit të parë të pushtetit vendor. Ndryshimet në konfigurim kanë prekur 11 qarqet e Shqipërisë përveç Gjirokastrës. Arsyeja ka qënë e thjeshtë se në këtë qark banojnë afërsisht 60.000 banorë që administrohen nga 7 bashki. Kjo tregon një “ngopje” me pushtet dhe përfaqësim në këtë qark. Por, ne nuk kemi vendos kufizime edhe në këtë rast, si dhe në raste të tjera.

Numri i bashkive që preken nga riorganizimi: siç kemi analizuar më sipër bazuar në listën e kriterëve janë 22 bashki që preken nga riorganizimi për konsolidim. (Tirana-Berat-Dibër-Durrës-Shijak-Elbasan-Fier-Kavajë-Rrogozhinë-Kolonjë-Korçë-Krujë-Kukës-Kurbin-Lezhë-Lushnjë-Mallakastër-Mirditë-Poliçan-Shkodër-Vlorë-Selenicë). Por nga ky riorganizim preket dhe Bashkia Kamëz, por që nuk çon në rritje të numrit të bashkive. Ky ndryshim lidhet me bashkimin e NjA Paskuqan me Bashkinë Tiranë që ne konsiderojmë është natyrshme pjesë e kësaj, dhe zhvillimit të kryeqytetit nga veriu. Ndërsa NjA Zall Herr të bashkohet me Kamzën. Natyrshëm territorialisht por jo vetëm, por edhe që Kamza të zgjerohet me zonë të gjelbër/rurale.

Riorganizimi i këtyre bashkive na çon në krijimin e 33 bashkive të reja. Neni 87 i ligjit 139/2015. (lista ne Aneks)

- 2 bashki të reja që propozohen krijohen nga bashkimi i NjA që i perkasin bashkive të ndryshme si:
  - Bashkia Shpirag (Berat-Poliçan)



-Bashkia Otlak (Berat-Kucovë)

- 3 bashki krijohen nga 1 NjA e vetme-Orikumi (kthehet bashki siç ishte deri ne 2015) Ksamili dhe Maqellara.
- 28 bashki krijohen nga bashkimi i dy ose më shumë NjA.

\*Gjatë studimit na ka rezultuar se ka një numër të madh fshatrash, pjesë të një NjA që kërkojnë të shkojnë me bashkinë tjetër apo NjA tjetër. Kjo për arsye të lehtësirave, konektivitetit etj. (shiko anexin) Për këto kemi propozuar dispozita ligjore me afate.


## VII.II Tipologjia e bashkive të reja

Ashtu siç kemi analizuar në këtë raport, reforma e vitit 2014 krijoi bashki të tipit Urban-Rural, pra të 61 bashkitë sot janë të tilla, përkundrejt faktit që para reformës bashkitë ishin qartësisht më të ndara. Edhe riorganizimi që ne propozojmë nuk e eliminon këtë asimetri. Pra, bashkitë e reja janë me orientim rural pothuajse.

Nëse bëjmë një ndarje bashki me qytete dhe bashki pa qytete, atëherë projekti i riorganizimit prezantohet i tillë:

nga 33 bashki të reja të propozuara, 7 prej tyre kanë 'Qytet': Bashkia Ishëm -Qytetin Sukth, Bashkia Fushë Krujë-Qytetin Fushë Krujë, Bashkia Levan- qytezën Levan, Bashkia Leskovik-qytetin Leskovik, Bashkia Orosh-qytezën Repts, Bashkia Orikum- qytetin Orikum dhe Bashkia Milot- qytetin Milot. Dhe propozohet që qendra e këtyre bashkive të jenë pikërisht këto qytete.

(\*lidhur me përcaktimet qytet, nëse i jemi referuar emërtimeve nga përcaktimet ligjore sot, dhe siç i njohin bashkitë këto, edhe pse pranojmë që është çështje e debatueshme përcaktime, si urbane, qytetet etj, që lidhen me densitetin e numrit të banorëve për njësi siperfaqe.)



Me këtë riorganizim që propozojmë ndryshon dhe numri i bashkive për çdo qark siç tregojnë

grafiqet.

Në qarkun Tiranë shtohen 3 bashki të reja nga 5 që ka sot.

Në qarkun Fier shtohen 4 Bashki të reja nga 6 që ka sot.

Në qarkun Durrës shtohen 2 bashki të reja nga 3 që ka sot.

Në qarkun Elbasan shtohen 3 bashki të reja nga 7 që ka sot.

Në qarkun Korçë shtohen 5 bashki të reja nga 6 që ka sot.

Në qarkun Shkodër shtohen 0 bashki te reja nga 5 që ka sot.

Në qarkun Vlorë shtohen 4 bashki të reja nga 7 që ka sot.


Në qarkun Berat shtohet 2 bashki nga 5 që ka sot.

Në qarkun Lezhë shtohen 4 bashki të reja nga 3 që ka sot.

Në Dibër shtohen 4 bashki të reja nga 4 që ka sot.

Në Kukës shtohen 2 bashki të reja nga 3 që ka sot.


Në Gjirokastrë nuk ka ndryshime siç kemi shpjeguar më sipër.




Siç shikohet nga paraqitje grafike, nga riorganizimi territorial, Qarku Korçë dhe Vlorë riorganizohen

nga pikëpamja territoriale dhe administrative me nga 11 bashki, Qarku Elbasan dhe Fier me nga 10 bashki, Qarku Tiranë dhe Dibër me 8 bashki, Qarqet Gjirokastrë, Berat dhe Shkodër me nga 7 Bashki, ndërsa Qarqet Durrës, Shkodër dhe Kukës me nga 5 bashki.

Me prezantimin e grafikëve më poshtë jemi përpjekur të tregojmë raportin e popullsisë për Njësi të Qeverisjes vendore në Shqipëri me ndarjen e re dhe të krahasojmë këto të dhëna me mesataren në disa vende sipas grupimeve që grafiku tregon.



Burimi: CMRE 2020 për BE, OECD, EJJ, WB. Të dhëna të tjera janë nga burime të ndryshme.




*\*Nuk ka informacion për 33 bashkitë e reja sipas Census. Për arsye studimore, kemi supozuar vlerën e 33 bashkive të reja sipas Censusit bazuar në përqindjen e ndryshimit të totalit të popullsisë sipas Rregjistrit të Gjendjes Civile me totalin e popullsisë sipas Censusit për vitet përkatëse. (59%)*

Pra, siç dukshëm evidentohet nga analiza dhe grafiket, numri i popullsisë në bashkitë e reja është 3 herë më i madh thajse nga vendet e BE-së dhe 1.5 herë më i madh se mesatarja e vendeve të OECD. Pra, siç tregohet në tabelën dhe grafikun më poshtë kemi krahasimin e mesatares se popullsisë për 61 bashki dhe për 94 bashki që propozohen për vitin 2023.

Shpërndarja e popullsisë sipas qarqeve, numri i bashkive dhe popullsia mesatare për bashki

Në këtë tabelë kemi bërë një krahasim të shpërndarjes së popullsisë në të 12 qarqet dhe numrin e bashkive që kemi sot, dhe numrin e bashkive sipas riorganizimit.

Qarku	Popullsia(total)	Nr i bashkive 2015	Mesatarja e popullsisë së bashkive për qark 2015	Nr i bashkive e 2023	Mesatarja e popullsisë së bashkive për qark 2023	Popullsia (%)
Tiranë	889578	5	177916	8	111197	31,7
Fier	296446	6	49408	10	29645	10,6
Durrës	289877	3	96626	5	57975	10,3
Elbasan	276765	7	39538	10	27676	9,9
Korçë	209034	6	34839	11	19003	7,5
Shkodër	203945	5	40789	5	40789	7,3
Vlorë	126294	7	18042	11	11481	4,5
Berat	126294	5	25259	7	18042	4,5
Lezhë	125998	3	41999	7	17999	4,5
Dibër	119963	4	29991	8	14995	4,3
Kukës	76994	3	25665	5	15398	2,7
Gjirokastër	62188	7	8884	7	8884	2,2
<b>Totali</b>	<b>2803376</b>	<b>61</b>		<b>94</b>		<b>100%</b>



Rritja e numrit të bashkive qartësisht ka çuar në uljen e mesatares së popullsisë për njësi të qeverisjes vendore në të 11 qarqet, përveç Qarkut Gjirokastrë dhe Shkodër që nuk preken nga riorganizimi. Në këtë qark 2.2% e popullsisë do qeverisen sërish nga 7 bashki. Ndërsa qarku Dibër që përbën 4,3% të popullsisë kombëtare do të qeveriset nga 7 bashki krahasuar me 4 bashki që ka sot.

Në qarkun Tiranë që përfaqëson 31.7% të popullsisë, qytetarët do të qeverisen sipas propozimit të ri nga 8 bashki krahasuar me 5 që ka sot.

### **Numri i këshilltarëve për çdo qark**

Nr.	Qarku	Nr. i këshilltarëve
1	Tiranë	258
2	Fier	244
3	Durrës	145
4	Elbasan	224
5	Korçë	221
6	Shkodër	143
7	Vlorë	221
8	Berat	139
9	Lezhë	161
10	Dibër	138
11	Kukës	93
12	Gjirokastrë	127
	<b>Totali</b>	<b>2114</b>

Përfaqësimi zgjedhor në bashkitë e reja



Konfiguracioni i ri i pushtetit vendor plotëson edhe boshllëkun e përfaqësimit. Siç tregojnë të dhënat dhe grafiqet më poshtë ku boshllëku mbushet me bashkitë e reja dhe me këshillat e reja bashkiake, që nga llogaritja e numrit të këshilltarëve për banorë sipas Ligjit 139/2015, arrin në 2114 këshilltarë bashkiakë në 94 bashki. Pra, bashkitë e reja do të kenë trupën e të zgjedhurve me mbi 600 këshilltarë. Numri i popullsisë në këto 33 bashki të reja arrin në afro 870000 banorë (RrGjcC) dhe me 450000 me (census).


**33 Bashkitë e reja**

Nr.	Bashkia	Popullsia	Nr. i anëtarëve të Këshillit Bashkiak
1	Kashar	87923	31
2	Sukth	52621	31
3	Dajt	50630	31
4	Farka	48072	21
5	Fushë-Krujë	48249	21
6	Levan	45992	21
7	Ardenicë	42259	21
8	Bradashesh	37915	21
9	Shpat	37037	21
10	Starovë	36007	21
11	Zadrimë	34379	21
12	Dushk	33834	21
13	Novoselë	31983	21
14	Bregu i Matit	29346	21
15	Pojan	25716	21
16	Milot	21682	21
17	Otlak	21374	21
18	Shpirag	19183	15
19	Kastriot	15693	15
20	Drenovë	14998	15
21	Maqellarë	14425	15
22	Kotë	13979	15
23	Fratar	13556	15
24	Orikum	12029	15
25	Bicaj	11181	15
26	Shupenzë	10777	15
27	Lurë	10728	15
28	Leskovik	9911	15
29	Shishtavec	9281	15
30	Lunik	8801	15
31	Ksamil	7716	15
32	Voskopojë	7681	15
33	Orosh	7074	15

**872032**

**627**






Siç shihet nga grafiku, 43 bashki nga 94 përfaqësohen me nga 21 anëtarë të këshillave bashkiakë. 30 bashki përfaqësohen me 15 anëtarë, 14 bashki përfaqësohen me 31 anëtarë, 4 bashki përfaqësohen me 41 anëtarë, 2 bashki përfaqësohet me 51 anëtarë dhe 1 bashki përfaqësohet me 61 anëtarë.

Nga analiza e mësipërme na rezulton nga riorganizimi në tërësi, por mbi të gjitha bashkitë e reja, që krijimi i këtyre bashkive të reja na siguron trekëndëshin e “artë”. Ky trekëndësh do të thotë që kemi një bazë të mirë përfaqësimi, shërbime lokale më të mira, komunitet me tradita dhe turizëm rural të përmirësuar. Por, për momentin bindemi se pjesa e trekëndëshit që lidhet me përfaqësimin është një argument më i fortë se dy pjesët e tjera.

Përsa i përket pjesës së traditës dhe turizmit, mendimi jonë është se do të ketë një rigjallërim, rivitalizim dhe rritje interesi. Ndërsa, lidhur me shërbimet kërkohet dhe duhet shumë punë dhe mbështetje sidomos në mandatin e parë. Nga ana tjetër, duke bërë bashkë këto tre elemente me diferencimet e tyre, mendojmë që do të sjellin edhe një frenim potencial të shpopullimit si produkt.





## VIII Riorganizimi i nivelit të dytë


Përsa i përket strukturës së nivelit të dytë, për ato arsye të më sipër, sugjerojmë dy skenarë:

**Skenari A** - të kalojmë nga 12 qarqe në 6 qarqe/rajone, nëpërmjet bashkimit të dy qarqeve natyrisht të bashkangjitur territorialisht. Dhe nëse shkohet për këtë qasje qarqet e mundëshme mund të jenë:

1-Shkodër+Lezhë; 2-Dibër+Kukës; 3-Tiranë+Durrës; 4-Elbasan+Korçë; 5-Fier+Berat; 6-Vlorë+Gjirokastrë.

Varianti me 6 rajone: raporti me popullsinë dhe numrin e bashkive.

Nr	Rajoni (Qarku)	Popullsia (total)	Nr. i bashkive 2015	Nr. i bashkive 2023	Popullsia (%)
1	Shkodër & Lezhë	570938	8	12	12.5%
2	Dibër & Kukës	281838	7	13	6.1%
3	Tiranë & Durrës	1653332	8	13	36.1%
4	Elbasan & Korçë	795640	13	21	17.4%
5	Fier & Berat	736598	11	17	16.1%
6	Vlorë & Gjirokastrë	533440	14	18	11.8%
<b>Totali</b>		<b>4571786</b>	<b>61</b>	<b>94</b>	<b>100%</b>



Ky mund të përbejë riorganizimin më të thjeshtë, dhe ka si avantazh një përqëndrim të lehtë të nivelit të dytë, por edhe perceptimi qytetar është larg së “tremburi” se po na ikin institucionet.

Avantazh tjetër i këtij modeli është edhe shpërndarja e barazlanguar gjeografikisht për ato shërbime dhe role që ka ky institucion. Në keto 6 rajone, veç rolit me pushtetin vendor dhe shërbimeve të rajonalizuara, mund të vendosen edhe institucione apo agjensi të dekoncentruara të qeverisë qëndrore. Psh. drejtoritë e arsimit, shëndetësisë, mbrojtja civile e sociale, etj. Ky model organizimi bën që nga 6 qarqe të mëdha (rajone), 4 prej tyre kanë dalje në det.

Disavantazhi është emërtimi i këtyre qarqeve, por nëse i lëmë po kështu ky kthehet në avantazh dhe memorija mbetet.


**Skenari B**

Varianti me 3 Rajone. Kjo ndarje vjen si propozim i bazuar në klasifikim statistikor që përkon me Nuts 2 ku shqipëria është ndarë në 3 rajone. ( <http://www.instat.gov.al/al/temat/statistikat-e-përgjithshme-dhe-rajonale/rajonet/#tab4>). Por ne sugjerojmë që qarku Durrës të jetë pjesë e rajonit A-J.Kjo bazuar në ndjeshmërinë e komuniteteve, për të krijuar një shpërndarje të NjQV dhe si një rajon që përfshin kryeqytetin të ketë më shumë hapësirë dhe akses ekonomik nga vija dhe industria e bregdetit.

Sugjerojmë që këto rajone të identifikohen dhe emërohen me emrat e deteve nga ku kanë dalje dhe kufirin ujorë detar, si më më poshtë:

\* <https://tviliria.wordpress.com/2019/08/08/cili-det-e-lag-vloren-adriatiku-apo-joni/>

	<b>Rajoni (Qarku)</b>	<b>Popullsia (total)</b>	<b>Nr. i bashkive 2015</b>	<b>Nr. i bashkive 2023</b>	<b>Popullsia (%)</b>
1-A	<b>Rajoni Adriatik</b> Shkodër, Lezhë, Dibër, Kukës,	852776	15	25	18.65%
2-AJ	<b>Rajoni Adriatiko-Jonian</b> Tiranë, Durrës & Elbasan	2101875	15	23	45.98%
3-J	<b>Rajoni Jonian</b> Vlorë, Korçë, Fier, Berat, Gjirokastrë	1617135	31	46	35.37%
<b>Totali</b>		<b>4571786</b>	<b>61</b>	<b>94</b>	<b>100%</b>



Përfaqësimi politik i nivelit të dytë

**Për skenarin A më parë me 6 qarqe:**

Sipas nenit 73 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillit të qarkut caktohet në përpjesëtim me numrin e popullsisë, si më poshtë:

- Bashkitë me popullsi deri në 20 000 banorë, 2 përfaqësues.
- Bashkitë me popullsi 20 001 deri në 50 000 banorë, 4 përfaqësues.
- Bashkitë me popullsi 50 001 deri në 100 000 banorë, 5 përfaqësues.
- Bashkitë me popullsi mbi 100 000 banorë, 5 + nga një përfaqësues shtesë për çdo 1 deri në 50 000 banorë mbi 100 000 banorë.

Brenda numrit të përfaqësuesve për çdo bashki, sipas pikës 1, të këtij neni, përfshihet kryetari i bashkisë, si dhe përfaqësuesit e tjerë që zgjidhen nga këshilli i bashkisë. Praktika na ka dëshmuar se ky nivel i dytë i qeverisjes vendore është kompozuar me përfaqësues nga ‘forca mazhoritare’ në bashki, gjë që ka sjellë një këshill të polarizuar.

Me riorganizmin që propozojmë për nivelin e dytë sugjerojmë një zgjedhje të balancuar dhe sa më shumë përfaqësues. Këshilli vendor i nivelit të dytë, për vetë rolin që merr tani duhet të jetë sa më shumë i balancuar me forcat politike për të siguruar vendimmarrje sa më konsensuale dhe gjithëpërfshirëse. Ndaj sugjerojmë formulën si më poshtë:

Përfaqësuesi t	26 Bashki me 20.000 banorë 15 KB	43 Bashki me 20.001-50.000 banorë 21 KB	12 Bashki me 50.001-10.0000 banorë 31 KB	6 Bashki me 100.001-200.000 banorë 41 KB	1 Bashki me 200.001-400.000 banorë 51 KB	1 Bashki me mbi 400.000 banorë 61 KB
1	Kryetari	Kryetari	Kryetari	Kryetari	Kryetari	Kryetari
2	KB-O	KB-O	KB-O	KB-O	KB-O	KB-O
3		KB-M	KB-M	KB-M	KB-M	KB-M
4			KB-free	KB-O	KB-O	KB-O
5				KB-M	KB-M	KB-M
6				KB-free	KB-O	KB-O
7					KB-free	KB-M
8						KB-free
<b>Mesatarisht</b>	<b>7.5</b>	<b>7</b>	<b>7.75</b>	<b>6,8</b>	<b>7.3</b>	<b>7.6</b>

*KB-Këshilltarë Bashkie.*

*KB-O këshilltarë bashkie nga opozita*

*KB-M këshilltarë bashkie nga mazhoranca*

*KB-Free një këshilltar tjetër nga grupe të tjera përfaqësimi*

Me këtë formulë, çdo përfaqësues nga secila bashki përfaqëson mesatarisht mbi 7 këshilltarë bashkiak në nivelin e dytë. Sigurisht dhe kjo nuk është formula magjike dhe kërkon akte rregullatore për të eliminuar çdo konflikt dhe paqartësi. Avantazhi i kësaj është përfaqësimi i gjerë. Diasavanatazhi është numri i madh i pjesëmarrësve në mbledhjen e këshillit, dhe humbjet e performancës.

**Për skenarin me 3 rajone**

Nëse do të kemi 3 rajone sugjerojmë që përfaqësimi politik të jetë më i koncentruar për të shmangur “numri i madh, efektivitet i ulët”. Konkretisht mund të shkohet me këtë formulë:

Përfaqësuesit	26 Bashki me -20.000 banorë 15 KB	43 Bashki me 20.001-50.000 banorë 21 KB	12 Bashki me 50.001-10.0000 banorë 31 KB	6 Bashki me 100.001 - 200.000 banorë 41 KB	Bashki me 200.001 -400.000 banorë 51 KB	1 Bashki me mbi 400.000 banorë 61 KB
1	Kryetari	Kryetari	Kryetari	Kryetari	Kryetari	Kryetari
2	KB-O	KB-O	KB-O	KB-O	KB-O	KB-O

*Shënim: Në rast se ky kompozim dërgon në këshillin e rajonit një numër që barazon mazhornacën dhe opozitën dhe pamundëson votimin me 50+1, atëherë sugjerojmë që një këshilltar të vijë nga bashkia ka numrin më të madh të popullsisë brenda atij rajoni.*

Edhe në këtë rast, synimi është të kemi një këshill rajonal me ekuilibra të qëndrueshëm.

**Skenari alternativ:**

Rritet numri i bashkive dhe nuk ndryshojnë qarqet.

Rajoni (qarku)	Popullsia(total)	Nr.bashkive 2015	Nr.bashkive 2023	Popullsia(%)
Tiranë	1183916	5	8	25.9
Fier	509169	6	10	11.1
Durrës	469416	3	5	10.3
Elbasan	448543	7	10	9.8
Korçë	347097	6	11	7.6
Shkodër	345163	5	5	7.5
Vlorë	388232	7	11	8.5
Berat	227429	5	7	5.1
Lezhë	225775	3	7	4.9
Dibër	171419	4	8	3.7
Kukës	110419	3	5	2.4
Gjirokastër	145208	7	7	3.2
		<b>61</b>	<b>94</b>	100

*(popullsia sipas RGjC)*

Ky skenar nuk konsiderohet negativ. Qarku ka kompozim relativisht të vogël përse i përket numrit të bashkive për çdo qark që varion si mesatare 7.5 bashki për një qark. Ruhet status quo dhe memoria institucionale e këtij institucioni. Disavatazhi është perceptimi që mbart në publik dhe efektiviteti i tij që len për të dëshiruar. Përse i përket përgjegjësive dhe funksioneve, kjo do të varet nga vullneti politik dhe rezultatet e ushtrimit mbi decentralizimin asimetrik. Lidhur me zgjedhjet sugjerojmë të njëjtën formulë.

**Strategjia:** për të realizuar këto ndryshime, kërkohet së pari vendimi politik. Ndaj sugjerojmë që parlamenti ta trajtojë në momentin më të parë. Këto ndryshime duhet të bëhen në kohën që nuk krijohen konflikte me afatet e zgjedhjeve periodike vendore. Por, ndërkohë kërkohen dhe vendime të tjera dhe akte ligjore që e bëjnë sistemin të mos ndalojë dhe ndërkohë bëhen rregullime dhe transferime sipas modelit të ndarjes së miratuar nga parlamenti. Ndërkohë që është në përgatitje e sipër dhe strategjia kombëtare për decentralizimin, kërkohet që ndryshimet territoriale dhe ato administrative apo efektet respektive të merren në konsideratë. Ndërkohë që do të ketë ndikim në mjedisin social dhe administrativ, kjo kërkon nga institucionet të punojnë dhe komunikojnë me qytetarët, të ftojnë donatorët të mbulojnë me asistencë sa më mirë në këtë periudhë “tranzitore”. Agjensia për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore të marrë një rol më të madh në këtë periudhë derisa të stabilizohen bashkitë e reja, kryesisht dhe administrata e re e tyre. Kjo kërkon mbështetje me burime dhe rritje kapacitetesh dhe aftësish për njësitë vendore.

**Aftësia** – Bashkia e re do të ketë funksione dhe përgjegjësi siç ja përcakton ligji. Kryesisht bashkitë e reja do të administrojnë jetën sociale ekonomike në zona rurale. Funksione kyçe të tyre do të jenë ato që ka nevojë komuniteti më së shumti, dhe për këtë kërkohet të përcaktohen prioritetet e qarta se cilat aftësi ka më shumë nevojë bashkia e re. Psh. i duhen arkitekte apo agronomë, i duhet inxhinier kompjuterash apo inxhinier pasiazh, apo planifikues rural etj. Por, këto aftësi duhet të organizohen bazuar në ato që posedojnë sot njësitë administrative. Këto aftësi duhet të jenë të qëndrueshme por edhe duhet të respektohet parimi i konkurrencës.

**Stafi** i bashkive të reja, do të ketë një fazë 6-12 mujore për tu stabilizuar. Si një organizatë e re, bashkia, pra kryetari dhe këshilli bashkiak, duhet të bëjnë kujdes me aftësitë e burimeve njerëzore. Këtu nuk fillojnë nga zero. Aftësitë janë aty. Janë burimet njerëzore që punojnë aktualisht në njësitë administrative. Kryetari do të bëjë organizim strukturor të brëndshëm dhe do të ndërtojë po me këto burime një administratë të përqëndruar duke e konsideruar bashkinë tanimë si një të tërë.

Fuqia e burimeve njerëzore = numri i kapaciteteve njerëzore të njësisë administrative X numrin e NJA/administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore.

**Stili** lidhshipi i ri i bashkive të reja, kryetari dhe këshilli bashkiak, duhet të ndërmarrin veprimet e duhura, dhe të dinë si të veprojnë dhe ndërveprojnë. Ato duhet të jenë përbashkues vlerash dhe të kenë një qasje sa më integruese të të gjithë njësive administrative që krijojnë bashkinë e re. Puna e tyre duhet të fillojë shpejt dhe me kujdes për të organizuar strukturën e re bashkiake dhe të vendosë prioritet për politikat e zhvillimit lokal, të bëjë vlerësimin e nevojave për çdo fshat dhe sektor zhvillimi. Lidhshipi i ri duhet të dëgjojë mirë zërat e qytetareve, tju shpjegojë mbi bashkinë e re dhe vizionin e saj, si edhe të marri mbështetjen e tyre për bashkëpunim.

## **IX. Procesi i reformës dhe afati kohor**

### **Përgatitja e zgjidhjeve për të reduktuar efektet negative dhe frikën e mundshme të palëve të interesuara**

Një qëndrim politik nga të gjithë aktorët për efektet dhe rëndësinë e këtij riorganizimi është i domosdoshëm për të evituar çdo paqartësi dhe efekt negativ në komunitet, por edhe për aktorë të tjerë e partnerë me qeverisjen vendore. Popullsia nuk është e shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjithë territorin dhe zhvillimi ekonomik po kështu.

Ndaj krijojmë mundësi të riorganizimeve të ndryshme në nivele të administratës lokale dhe rajonale. Kompetencat e autoriteteve lokale dhe rajonale mund të ndryshojnë, por qytetarët nuk do të kenë efekte negative, por çdo shqetësim duhet të konsiderohet.

Qëndrime të tilla duhet të qartësojnë dhe qetësojnë aspekte kritike që lidhen me ruajtjen e identitetit, tensionet që rrjedhin interesa të fshatrave, pengesat për aksesin e qytetarëve në shërbimet administrative lokale, të shkaktuara kryesisht nga ndarja e bashkive, prishja e staut quos politike por dhe i drejtuesve aktual në njësi vendore, të garantojnë vazhdimësi të shërbimeve, e mos nxitet paniku mbi bashkinë e ‘vogël’ etj.

Riorganizimi që propozohet nuk ka asnjë efekt negativ mbi minoritetet, pasi riorganizimi që ne propozojmë nuk i prek fare këto zona dhe këto bashki.

Media dhe aktorë të shoqërisë civile, programe dhe donatorë duhet të bëjnë pjesë mbështetëse e konsolidimit të pushtetit vendor nëpërmjet riorganizimit natyral të tij, dhe të rishikojnë aktivitetet dhe programet e tyre.

Bashkitë dhe këshillat e qarqeve aktuale duhet të qëndrojnë në frontin e parë të këtyre ndryshimeve pozitive për komunitetin dhe të jenë sa më fleksibël.

Qeveria duhet tju komunikojë qytetarëve dhe sigurojë bashkive të reja mbështetje me mjete financiare.

Minimalisht dyfishimi i PPB-së nga 1% që është sot në 2% për 94 bashkitë e reja. Edhe çdo rregullim tjetër ligjor që lidhet me këtë proces riorganizimi duhet të konsultohet, bëhet publike dhe tju komunikohet qytetarëve.

Këto aktivitete dhe afate kërkojnë seriozitet maksimal pas vullnetit të shprehur nga Kuvendi i Shqipërisë. Këtë kërkojnë që Ministria e Brendshme si lider në këtë proces të organizohet në funksion të riorganizimit të pushtetit vendor.

**Hapat e nevojshme propozohen si vijon:**

<b>Nr</b>	<b>Aktivitet</b>	<b>Afatet</b>
1	Ngritja e Komisionit të posaçëm	Ezauruar me vendimin e Kuvendit nr 13/2022
2	Faza përgatitore	Mars -Qershor-Shtator 22
3	Dëgjesat në komisionin e posaçëm	Korrik –Shtator 22
4	Përgatitje dhe puna kërkimore e ekspertëve	Korrik - Shtator 22
5	Pergatitja e raportit nga ekspertët	Shtator 22
	Prezantimi raportit ne komisionin e posaçëm	Java parë e Tetorit
6	Miratimi konsensual i raportit me propozimet përkatëse	Java e fundit e Tetorit
7	Miratimi në Kuvend (votim me shumicë të cilësuar)	Java e fundit e Tetorit
8	Miratimi i ndryshimeve kushtetuese (nr 108-113)	Java e parë e Nëntor
9	Përgatitja për ligjin e ri të ndarjes territoriale (zëvendësimin/amendimin e ligjit 115/2014) Harta e re territoriale.	Java parë Nëntor
10	Faza Tranzitore, pergatitje e udhëzimeve për ndarjen, transferimi, dhe vazhdimsinë e njësisve vendore	Nëntor 22 –Mars 23
11	Pergatitje për zgjedhjet periodike vendore me riorganizimin e ri	Janar –Maj 23
12	Rishikim kuadrit ligjor dhe analiza për decentralizim asimetrik dhe financiar që ti konvergjoj ndarjes së re	Në vazhdimësi
13	Për vitin 2023 NJQV të operojnë me ligjin 139/2015 dhe aktet e nevojshme.	Janar 23-Dhejtor 23
14	Azhornimi/përgatitja e ligjit të ri ose amendimi ligjit 139/2015, miratimi i tij në funksion të ndarjes së re	Nentor 23 (futet në fuqi më 1 janar 24)
14	Strategjia kombëtare e decentralizimit	Qershor 23 - Nëntor 23
15	Rishikimi i akteve ligjore për decentralizimin fiskal, dhe akte të tjera rregullatore për funksionet.	Process ongoing
16	Ndryshime në Ligjin për korrigjime të kufijve që nuk krijojnë pasojë në numrin e bashkisë (ndërmjet bashkive)	Të përfundojë në fund të vitit 2026 dhe në zgjedhjet e tjera vendore të mos ketë më probleme të tilla

Agjenda e propozuar, sigurisht lë shumë detaje të procesit për tu diskutuar. Këto detaje duhet të përcaktohen nga qeveria dhe institucionet e tjera vendim-marrëse në kohën dhe koherencën e duhur.

#### -Përgatitja e dispozitave kalimtare

Qeveria duhet të rekomandojë me akte një kornizë të fortë për të ruajtur disiplinën normale buxhetore gjatë fazës së tranzicionit, për të ruajtur asetet dhe për të siguruar çdo transferim të personelit të bashkive ose rajoneve që po reformohen trajtohen me efikasitet.

Çdo reformë territoriale ka nevojë për një fazë kalimtare ose rregullore që ndihmojnë në transferimin e sistemit të vjetër në një kuadër të ri. Vetë reforma, pavarësisht efekteve të mundshme pozitive afatgjata, është një proces i vështirë për komunitetet lokale.

Shembuj të dispozitave të tilla kalimtare duhet të përfshijnë: Punësimi në administratën e qeverisjes vendore. Ndryshimi i territorit mund të çojë në disa raste në zvogëlimin e numrit të punonjësve ose të paktën zhvendosje të vendeve të punës etj. Këtu nuk shikoj asnjë problem, pasi kemi në memorie të afërt institucionale praktikat e vitit 2015 e më pas nga reforma aktuale.

Borxhi i trashëguar i pushtetit vendor është një tjetër shembull. Kush do të ishte përgjegjës për pagimin e borxhit, pasreforma, dhe si duhet të shmangen situatat në të cilat bashkite e reja do të mbartin këto. Por, nga ana tjetër do të jenë përgjegjës për kthimin e borxhit bashkitë aktuale. Dhe kjo përbën ngarkesë për këto, marrë në konsideratë se iu ikën një pjesë territori dhe kapitali. Mundësi më e mirë, si e mesme e artë, është që borxhin ta marrë përsipër qeveria qendrore. Kjo ka efekte pozitive pasi shënon një herë e mirë “borxhin zero” për të gjitha bashkitë, dhe këtu fillon starti për të pare efektivitetin e çdo bashkie dhe performancën e tyre fiskale.

Borxhi i bashkive në fund të vitit 2021, sipas raporteve të ministrisë së financave ishte 6.5 miliard lekë. Ky volum borxhi nuk përbën ngarkesë dramatike për buxhetin qeveritar (duhet respektuar çdo qindarkë e ekonomisë së çdo shqiptari) por momenti konsolidimin të pushtetit vendor vlen më shumë. Nuk përjashtohen efektet pozitive ekonomike që mund të arrihen përmes riorganizimit të brendshëm të vetë bashkive të reja por edhe të atyre ekzistuese.

Rritja e numrit të Bashkive çon në ndryshime të lehta në numrin e këshilltarëve në këshillat e pushtetit vendor. Reforma e riorganizimit territorial që ne prezantojmë çon në një rritje të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve siç kemi analizuar më sipër nga 1600 në 2000 dhe sigurisht çon në rritje të numrit të pozitive përfaqësuese nga subjekte të ndryshëm.

Konfigurimi i numrit të këshilltarëve në të gjithë bashkitë mendoj të jetë siç është parashikuar në ligjin 139/2015 në nenin 46, me këtë formulë.

Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë:

Bashkitë deri në 20 000 banorë 15 anëtarë;

Bashkitë nga 20 001 deri në 50 000 banorë 21 anëtarë;

Bashkitë nga 50 001 deri në 100 000 banorë 31 anëtarë;

Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë 41 anëtarë;

Bashkitë nga 200 001 deri në 400 000 banorë 51 anëtarë;



Bashkitë mbi 400 000 banorë 61 anëtarë. (shiko analizën, tabelat dhe grafikët më sipër).

Pra, këtu nuk mendoj se ka nevojë për ndryshime të dispozitave ligjore.

#### -Zbatimi dhe vlerësimi

Zbatimi i reformës për konsolidimin e pushtetit vendor siç kemi shpjeguar më sipër kërkon mbështetje me të gjitha mjetet dhe nga të gjithë aktorët politikë dhe jo politikë, qendror, rajonalë dhe lokalë.

Zbatimi dhe vlerësimi duhet të jetë një proces i vazhdueshëm nga të gjithë. Së pari, sugjeroj që vetë kuvendi ta mbajë në agjendë, qeveria dhe institucionet e tjera. Praktika e post reformës 2015 ku monitorimi mbi efektshmërinë e reformës dukej sikur sduhet të prekej ishte një qasje jo e mirë. Sugjerojmë që çdo vit të bëhet një analizë dhe vlerësim i ndikimit nga ky riorganizim me qëllim që të kapen dhe trajtohen problemet në kohën e duhur.

## **X. Propozime dhe rekomandime konkrete mbi modelin e pushtetit vendor në Shqipëri**

### **A: Sistemi territorial**

Bazuar në analizën tonë të detajuar më sipër arrijmë në përfundimin se:

1. Modeli i pushtetit vendor në Shqipëri duhet të jetë me dy nivele. Me nivelin e parë që përfaqësohet nga bashkitë dhe nivelin e dytë nga rajonet.
2. Shqipëria me 2.8 milion banorë sipas census 2011 dhe 4.5 milione banorë sipas Rregjistrit të Gjëndjes Civile, dhe me një sipërfaqe 28.000km<sup>2</sup> ka nevojë për një ndarje territoriale administrative të nivelit të parë me 94 bashki.
3. Niveli i dytë i pushtetit vendor mund të organizohet me 6 apo 3 rajone.

### **B: Sistemi Administrativ**

Propozime dhe rekomandime mbi ndryshimet ligjore:

1. Ligji i ri për ndarjen territoriale (zëvendësuesi i ligjit 115/2014)
2. Përgatitje e dispozitave ligjore për periudhën tranzitore për bashkitë dhe rajonet.
3. Strategji e re për decentralizimin dhe ushtrimi për decentralizimin asimetric.
4. Azhurnimi i ligjit për vetëqeverisjen vendore (139/2015) me funksionet e reja për të dy nivelet e pushtetit vendor.
5. Mbështetje dhe autonomi financiare dhe me çdo instrument bashkitë dhe rajonet.
6. Bashkisë së kryeqytetit duhet ti jepet status i veçantë me ligj (ky është një sugjerim por nuk është pjesë e studimit dhe analizës tonë dhe sna është kërkuar)
7. Ligj për referendimet lokale

### **C: Sistemi Zgjedhor**

Në analizën tonë jemi përpjekur të kontribuojmë në rritjen e përfaqësimit sa më të gjërë politik në të dy nivelet e pushtetit vendor. Por, nuk është se kemi ndaluar thellësisht në qasjen ndaj sistemit zgjedhor. Ne kemi sugjeruar një formulë përfaqësimi të bashkive në nivelin e dytë për të dy skenarët. Por, sistemi zgjedhor është më i gjërë se kaq.

Mund të prekë jo vetëm mënyrën e të zgjedhurit dhe përfaqësimit në këshilla bashkiakë dhe rajonale, por edhe mënyrën se si zgjidhet kryetari i bashkisë.

Sot kryetari zgjidhet në mënyrë nominale përkundrejt listës shumëemërore që zgjidhen këshilltarët. Në vende të ndryshme kryetari zgjidhet nga lista e këshillit dhe nga rradhët e tij.

Sikundër hedhim për diskutime edhe përcaktimin e mandatit për kryetarin nga tre që është, në dy. Është çështje e diskutueshme me avantazhe dhe disavantazhe, por është çështje gjykimi nga vendimmarrësi.

## Opsionet për konsolidimin e pushtetit vendor

### 1. Riorganizimi dhe ristrukturimi i bashkive brenda qarkut

Metoda	Bazuar në kriteret e përcaktuara (Lista më sipër)
Rezultati i pritshëm	Krijimi i 33 bashkive të reja. 94 bashki gjithsej në Shqipëri. 2100 këshilltarë vendorë. Numri mesatar i popullsisë për bashki shkon afro 32.000 banorë, më lehtësisht i administrueshëm. Më shumë demokraci lokale, më shumë shpresë dhe prespektivë rurale.
Avantazhet:	Më shumë pushtet afër qytetarëve, më shumë shërbime rurale, më shumë përfaqësim lokal, nga 1600 këshilltarë përfaqësimi rritet në 2100 në shkallë kombëtare. Më shumë vëmendje për zhvillimin rural, dhe më shumë rigjallërim të jetës në zona rurale etj. Por edhe bashkive të tjera do të kenë një filozofi tjetër ndaj urbanizimit. Më shumë qeverisje territoriale. Territore më homogjene, traditë me e përqendruar, shanse për të nxitur jetën sociale dhe politike në zona të thella, do mundësojnë frenimin e shpopullimit. Niveli i dytë ridimensionohet pozitivisht.
Diasavantazhet	Perceptimi i prishjes së status quos. Krijimi i kategorive të ndryshme të bashkive që ngrenë pikëpyetje mbi ekonominë e shkallës. Paqartësi se si të vlerësohen kapacitetet për të ofruar shërbime, apo, se si të alokohen burimet ndërmjet funksioneve të ndryshme. Probleme të mundëshme koordinimi ndërmjet bashkive ekzistuese dhe rajoneve, bashki pa qytete etj.

**2. Riorganizimi mbi bazën e referendumeve lokale**

Metoda	Referendume lokale
Rezultati i pritshëm	Mund të kërkohet rikthim në traditën e ish-komuna dhe bashkive siç ishin para reforme nga disa komunitete.
Avantazhet:	Është forma më demokratike, më kushtetuese dhe e përcaktuar dhe nga Karta Evropiane e Vetqeverisjes Vendore të Këshillit të Evropës në nenin 5. Shqipëria e ka ratifikuar dhe miratuar kartën në vitin 2000. Niveli i dytë mer një rol të rëndësishëm.
Diasavantazhet	Rikthim i fragmentarizimit, ose ndarje jo kuptimplota, kthehet në modë ndarja dhe bashkimi, influenca politike, është një proces vazhdimësie, nuk mund të vihen kufizime kohore etj.

### 3. Bashkim vullnetar drejt rretheve për vitin 2027

Metoda	Bashkitë e vogla bien dakort për ta bërë këtë mbi bazë vullnetare. Qeveria e inicion dhe e mbështet procesin gradual, me orientimin se ‘cila do të shkojë ku’.
Rezultati i pritshëm	I dyshimtë, edhe pse ndonjë bashki e vogël kërkon të bëjë lojën dhe protagonizmin për tu bashkuar. Shumica mund të kërkojnë të ruajnë status quon. Në zgjedhjet periodike vendore potencialisht drejt “rretheve” të viteve para 2000.
Avantazhet:	Reformat Ad hoc me shtrirje në kohë janë plotësisht në përputhje me demokracinë lokale. Autoritetet lokale nuk detyrohen të bashkohen kundër dëshirës së tyre.
Diasavantazhet	Ka gjasa që të rezultojnë joefektive duke gjykuar nga përvoja shqiptare dhe ajo ndërkombëtare. Reforma të tilla kur mendohen të jenë të mëvonshme harrohen ose neglizhohen qëllimisht. Rreziku i humbjes së mundësisë politike me ndyshimet e pushtetit. *Kthimi te bashkitë ‘rrethe’ eleminon përfundimisht nivelin e dytë, dhe e bën atë të panevojshëm.

4. **Kthimi tek rrethet për vitin 2023\*.**

Metoda	Një rast i veçantë i ristrukturimit brenda kufijve të rrethit, do të duhet të korrespondojnë me 36 rrethet historike. Mund të ketë përjashtime lidhur me bashkitë e minoriteteve etnike.
Rezultati i pritshëm	Numri i bashkive që krijohen është 36 plus 3 bashki nga minoritetet etnike. 25 bashki të tjera shkrihen jashtë vullnetit të tyre. Popullsia mesatare prej 72.000 banorë. Të gjitha bashkitë e reja do të kenë, të paktën një qendër urbane.
Avantazhet:	Hap kurajoz drejt një qeverisje mjaft të përqëndruar, me perspektivën e përmirësimit thelbësor të ofrimit të shërbimeve. Autoritetet e reja lokale kanë disa rrënjë historike dhe kulturore të përbashkëta.
Diasavantazhet	Qeverisja, është në mënyrë të konsiderueshme, më larg nga njerëzit dhe do të kërkojë masa plotësuese për të mbrojtur demokracinë lokale. Është e qartë që do të gjenerojë opozitë, të konsiderueshme, lokale. Shumë bashki apo qytete zhduken. Kontrolli dhe qeverisja territoriale mund të shfaqë probleme. <b>Kthimi te bashkitë ‘rrethe’ eleminon përfundimisht nivelin e dytë, e bën të panevojshëm.</b>

\*Sida-Skl\_ShKSh\_2014

## 5. Riorganizimi i nivelit të dytë.

### Skenari A riorganizimi me 6 qarqe

<b>Metoda</b>	Bashkimi i qarqeve dy e nga dy
<b>Rezultati pritshëm</b>	i Nga 12 qarqe kalohet në 6 qarqe të mëdha/rajone. Numri i bashkive në 1 nga 6 qarqet/rajonet shkon mesatarisht nga 13-17 bashki. Popullsia mesatare u shkon nga 6.7% -17.3% të shkallës kombëtare.
<b>Avantazhet:</b>	Autoritetet e reja rajonale kanë disa rrënjë historike dhe kulturore të përbashkëta, memorje të përbashkët që ruhet edhe nga emri i qarkut si bashkim i dy emrave të çdo qarku. Psh Qarku/Rajoni Shkodër-Lezhë.
<b>Diasavantazhet</b>	Emri me dy emra, por që kthehet në avantazh të memories. Do perceptohet si pushtet i madh nga bashkitë por dhe nga agjensi të tjera.

### Skenari B riorganizimi me 3 rajone.

<b>Metoda</b>	Bashkimi i qarqeve dhe krijimi i 3 rajoneve
<b>Rezultati pritshëm</b>	i Nga 12 qarqe kalohet në 3 rajone. Numri mesatar i bashkive për rajone rritet. Popullsia mesatare....
<b>Avantazhet:</b>	Politikat rajonale dhe kombëtare janë më të harmonizuara, rriten burimet finaciare dhe asetet rajonale, më shumë konkurrencë, përfitime më të shumta nga instrumentet e BE, zhvillimet sektoriale marrin prioritet. Emertimi i qarqeve në mesin e vijës bregdetare do jetë vlerë e shtuar identifikuese brenda vendit dhe ndërkombëtarisht.
<b>Diasavantazhet</b>	Largimi i pushtetit nga qytetarët por dhe nga niveli i parë, rritje e rivalitetit politik, etj.

### Skenari Alternativ


<b>Metoda</b>	Status quo e Nivelit të dytë.
<b>Rezultati pritshëm</b>	i Qëndrojnë po me 12 qarqe dhe me 94 bashki
<b>Avantazhet:</b>	Ruhet status quo e qarkut, ka më shumë ‘shanse’ për nxitje të

	bashkëpunimit ndërvendor, është më pranë bashkive etj.
<b>Diasavantazhet</b>	Autoriteti i qarkut do të vazhdojë të zbehet, pushteti i tij do të mbetet i ulët. Nuk ka inovacion. Por, rritje e numrit të bashkive ja ripozicionon dhe ridimensionon rëndësinë dhe pushtetin.



## Aneksë

### Harta dhe vendndodhja e bashkive të propozuara



*me ngjyrë të kuqe vendndodhja e bashkive të propozuara.*

**Lista e bashkive të propozuara nga PD**

Nr.	Qarku	Bashkitë e reja	Bashkitë Ekzistuese	Numri i bashkive dhe popullsia në bazë qarku
1	<b>Berat</b>	<p><b>1. Bashkia Shpirag</b> (<i>Sinjë, Velabisht dhe Terpan (Polican)</i>)</p> <p><b>2. Bashkia Otllak</b> (<i>Otllak, Roshnik, Lumas</i>)</p>	<p>Berat</p> <p>Kuçovë</p> <p>Dimal</p> <p>Skrapar</p> <p>Poliçan</p>	<p>Në Qarkun <b>Berat</b> propozojmë të shtohen <b>2 (dy)</b> njësi vendore nga (5) që ka sot.</p> <p>126.294 banorë</p> <p>4.5% e popullsisë</p>
2	<b>Dibër</b>	<p><b>3. Bashkia Maqellarë</b> (<i>Maqellarë</i>)</p> <p><b>4. Bashkia Kastriot</b> (<i>Kastriot, Fushë Cidhen, Sllovë dhe Kalaja e Dodës</i>)</p> <p><b>5. Bashkia Lurë</b> (<i>Lurë, Arrëz, Zall Dardhë dhe Rec</i>)</p> <p><b>6. Bashkia Shupenzë</b> (<i>Shupenzë, Gjoricë Ostren, Trebishtë</i>)</p>	<p>Dibër</p> <p>Bulqizë</p> <p>Mat</p> <p>Klos</p>	<p>Në qarkun <b>Dibër</b> propozojmë të shtohen <b>4 (katër)</b> njësi të reja vendore nga (4) që ka sot.</p> <p>119.963 banorë</p> <p>4.3% e popullsisë</p>
3	<b>Durrës</b>	<p><b>7. Bashkia Ishëm</b> (<i>Sukth, Ishëm, Manëz</i>)</p> <p><b>8. Bashkia Fushë Krujë</b> (<i>Bupq dhe Nikël</i>)</p>	<p>Durrës</p> <p>Shijak</p> <p>Krujë</p>	<p>Në Qarkun <b>Durrës</b> propozojmë të shtohet <b>2 (dy)</b> njësi të reja vendore nga (3) që ka sot.</p> <p>289.877 banorë</p> <p>10.3% e popullsisë</p>
4	<b>Elbasan</b>	<p><b>9. Bashkia Shpat</b> (<i>Shushicë, Gjinar, Zavalinë, Tregan, Gjergjan</i>)</p> <p><b>10. Bashkia Bradashesh</b></p>	<p>Elbasan</p> <p>Cërrik</p> <p>Belsh</p> <p>Peqin</p> <p>Gramsh</p> <p>Librazhd</p> <p>Prrenjas</p>	<p>Në Qarkun <b>Elbasan</b> propozojmë të shtohen <b>3 (tre)</b> njësi të reja vendore nga (7) që ka sot.</p> <p>276.765 banorë</p> <p>9.9% e popullsisë</p>

		<p>(<i>Papër, Bradashesh, Funar, Gracen, Labinot Mal dhe Labinot Fushë</i>)</p> <p><b>11. Bashkia Lunik</b> (<i>Lunik, Orenjë, Steblevë</i>)</p>		
5	<b>Fier</b>	<p><b>12. Bashkia Levan</b> (<i>Levan, Frakull, Cakran</i>)</p> <p><b>13. Bashkia Dushk</b> (<i>Dushk i Madh, Ballgat, Golem, Hysgjokaj, Karbunarë</i>)</p> <p><b>14. Bashkia Ardenicë</b> (<i>Kolonjë, Bubullimë, Fier Shegan, Allkaj dhe Krutje</i>)</p> <p><b>15. Bashkia Fratar</b> (<i>Fratar, Selitë, Greshicë, Hekal dhe Kutë</i>)</p>	<p>Fier Patos Roskovec Lushnjë Divjakë Mallakastër</p>	<p>Në Qarkun <b>Fier</b> propozojmë të shtohen <b>4(katër)</b> njësi të reja vendore nga (6) që ka sot. 296.466 banorë 10.6 % e popullsisë</p>
6	<b>Korçë</b>	<p><b>16. Bashkia Voskopojë</b> (<i>Voskopojë, Voskop dhe Lekas</i>)</p> <p><b>17. Bashkia Leskovik</b> (<i>Leskovik, Bermash, Qendër Leskovik</i>)</p> <p><b>18. Bashkia Drenovë</b> (<i>Drenovë- Molla-Vithkuq</i>)</p> <p><b>19. Bashkia Pojan</b> (<i>Pojan, Bulgarec</i>)</p> <p><b>20. Bashkia Starovë</b> (<i>Bucimas, Cërravë, Trebinjë, Dardhas</i>)</p>	<p>Korçë Maliq Pustec Kolonjë Devoll Pogradec</p>	<p>Në Qarkun <b>Korçë</b> propozojmë të shtohen <b>5 (pesë)</b> njësi të reja vendore nga (6) që ka sot. 209.034 banorë 7.5% e popullsisë.</p>

7	<b>Kukës</b>	<p>21. <b>Bashkia Shishtavec</b> (<i>Shishtavec, Zapod dhe Topojan</i>)</p> <p>22. <b>Bashkia Bicaj</b> (<i>Bicaj, Bushtricë, Ujmisht, Kalis dhe Grykë Cajë</i>)</p>	<p>Kukës Has Tropojë</p>	<p>Në Qarkun <b>Kukës</b> propozojmë të shtohen <b>2 (dy)</b> njësi të reja vendore nga (3) që ka sot. 76.994 banorë 2.7% e popullsisë.</p>
8-	<b>Lezhë.</b>	<p>23. <b>Bashkia Bregu i Matit</b> (<i>Shënkoll, Zejman dhe fshati Barbullojë e re</i>)</p> <p>24. <b>Bashkia Orosh</b> (<i>Orosh, Fan</i>)</p> <p>25. <b>Bashkia Zadrinë</b> (<i>Balldre, Dajç, Kallmet dhe Blinisht dhe Ungrej</i>)</p> <p>26. <b>Bashkia Milot</b> (<i>Milot dhe Fushë Kuqe</i>)</p>	<p>Lezhë Mirditë Kurbin</p>	<p>Në Qarkun <b>Lezhë</b> propozojmë të shtohen <b>4 (katër)</b> njësi të reja vendore nga (3) që ka sot. 125.998 banorë 4.5% e popullsisë.</p>
9	<b>Shkodër</b>		<p>Shkodër Malsi e Madhe Vau Dejës Pukë Fushë Arrëz</p>	<p>Në Qarkun <b>Shkodër</b> nuk propozohen të shtohen njësi të reja vendore nga (5) që ka sot. 203.945 banorë 7.3 % e popullsisë</p>
10	<b>Tiranë</b>	<p>27. <b>Bashkia Farkë</b> (<i>Farkë, Petrelë, Baldushk, Bërzhitë, Krrabë</i>)</p> <p>28. <b>Bashkia Kasha</b> (<i>Kasha, Ndroq, Pezë, Vaqarr</i>)</p>	<p>Tiranë Kamëz Vorë Kavajë Rrogozhinë</p>	<p>Ne Qarkun <b>Tiranë</b> propozojmë të shtohen <b>3(tre)</b> njësi të reja vendore nga (5) që ka sot. 889.578 banorë 31.7 % e popullsisë</p>

		<b>29. Bashkia Dajt</b> <i>(Dajt, Shëngjergj, Zall Bastar dhe Zall Herr)</i>		
11	<b>Vlorë.</b>	<b>30. Bashkia Kotë</b> <i>(Kotë, Brataj dhe Sevaster)</i>  <b>31. Bashkia Novoselë</b> <i>(Novoselë dhe Shushicë)</i>  <b>32. Bashkia Orikum</b>  <i>sic ka qenë para ndarjes territoriale</i>  <b>33-Ksamil</b>  <i>(ish komuna)</i>	Vlorë Selenicë Himarë Sarandë Konispol Finiq Delvinë	Në <b>Qarkun Vlorë</b> propozojmë të shtohen <b>4 (katër)</b> njësi të reja vendore nga (7) që ka sot. 26.294 banorë 4.5% e popullsisë
12	<b>Gjirokastrë</b>		Gjirokastrë Libohovë Tepelenë Memaliaj Përmet Këlcyrë Dropull	Në qarkun Gjirokastrë nuk ka propozim për ndryshim. Qarku ka 7 bashki. Ka një popullsi prej 62.000 banorë 2.2% e popullsisë
	<b>Totali</b>	<b>33 bashki të reja</b>	<b>61 Bashki Ekzistuese</b>	<b>94 Njësi të Qeverisjes Vendore</b>

**QARKU BERAT**

Nr.	Njësi të qeverisjes vendore			Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia			
I.	Berat	Qyteti Berat	Berat	Qyteti Berat	Berat	Qyteti Berat
			Shpirag	Velabisht	Velabisht	Fshatrat; Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Velabisht, Veterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnje, Duhanas, Kodras
					Sinjë	Fshatrat; Sinjë, Mbolan, Mbjeshevë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmënzëzë 1, Osmënzëzë 2, Plashnik i Vogël, Molisht
					Tërpan	Fshatrat; Tërpan, Teman, Paraspuar, Tozhar, Vokopolë, Dodovec, Rehovë, Zhapokikë, Çorogjaf, Panarit, Plashnik i Madh, Lugas, Zhitom i Madh, Zhitom i Vogël
			Otlak	Otlak	Otlak	Fshatrat; Lapardha 1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e Sipërme, Orizaj, Otlak
					Roshnik	Fshatrat; Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimas, Perisnak, Qafë Dardhë, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël, Vojnik, Rabjak
					Lumas	Fshatrat; Lumas, Luzaj, Pëllumbas, Katundas, Zelevizhdë, Belesovë, Mëndrak, Sheqës, Bardhaj, Pashtraj, Vodëz, Krekëz, Koritëz
			Ura Vajgurore	Qyteti Ura - Vajgurore	Ura- Vajgurore	Qyteti Ura Vajgurore, Fshatrat; Bistrovicë, Konisbaltë, Pashalli, Vokopolë, Skrevan
					Poshnje	Fshatrat; Poshnje, Polizhan, Çiflik, Arrëz, Agim, Banaj, Gajdë, Malas Gropë, Syzez, Sheq Gajdë, Hingë, Kuç
					Kutalli	Fshatrat; Kutalli, Sqepur, Drenovicë, Samaticë, Pobrat, Rërëz, Protoduar, Goriçan Qendër, Goriçan Çlirim, Malas Breg
					Cukalat	Fshatrat; Donofrosë, Slanicë, Cukalat, Allambres, Krotinë, Çetë
					Kuçovë	Qyteti Kuçovë
					Kozare	Fshatrat; Havalehas, Kozare, Feras Kozare, Salcë Kozare, Vlashuk, Demollarë, Fier Mimar, Zdravë, Gegë, Drizë, Frashër
					Perondi	Fshatrat; Perondi, Magjatë, Tapi, Goraj, Velagosht, Rreth Tapi, Polovinë
					Çorovodë	Qyteti Çorovodë
					Qendër Skrapar	Fshatrat; Zogas, Kalanjas, Dhores, Veseshë, Polenë, Osojë, Grepckë, Liqeth, Rehovicë, Orizaj, Cerovë, Veleshnjë, Nishicë, Sharovë, Çerenisht, Buzuq, Munushtir, Radësh, Koritë, Mollas, Gradec, Vërzehzhë, Slatinjë, Storrë
					Bogovë	Fshatrat; Bogovë, Kakrukë, Dobrushë, Përparim, Bargullas, Novaj, Nishovë, Jaupas, Selan
					Vëndreshë	Fshatrat; Lavdar, Spatharë, Therapel, Valë, Vëndreshë e Madhe 1, Vëndreshë e Vogël 2, Vëndreshë e Malit 3, Ibro
					Çepan	Fshatrat; Çepan, Muzhakë, Rog, Zabëzran i Ri, Zabëzran, Blezëncë, Malind, Muzhëncë, Sevran i madh, Sevran i Vogël, Qeshibes, Strënc, Kakos, Prishtë
					Potom	Fshatrat; Potom, Gjergjovë, Koprëncë, Gërmenj, Visockë, Qafë, Helmës, Backë, Melskë, Nikollarë, Dyrmish, Staraveckë
					Leshnje	Fshatrat; Turbohovë, Kapinovë, Krastë, Krushovë, Faqekuq, Gostëncë, Leshnje, Vlushë, Bërsakë
					Gjerbës	Fshatrat; Mëlovë, Zaloshnjë, Gjerbës, Ujanik, Gradec, Strafcikë, Vishanj, Barçi 1, Barçi 2, Kuç, Rehovë, Grëmsh, Gjogovicë, Floq
					Zhepë	Fshatrat; Grevë, Posten, Kovaçanj, Gurazez, Çorrotat, Cericë, Zhepë, Leskovë, Trebël, Dunckë, Rromas, Tërrovë, Dobrenj, Buranj, Luadh, Shpatanj
					Poliçan	Qyteti Poliçan
					Vërtop	Fshatrat; Mbrakull, Vërtop, Kapinovë, Zgërbonjë, Vodicë, Fushë Peshtan, Peshtan, Drenovë, Lybeshë, Tomor i Madh, Tomor i Vogël, Bregas

QARKU DIBËR

Nr.	Njësi të qeverisjes vendore		Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
	Qarku	Bashkia			
II.	DIBËR	Dibër	Qyteti Peshkopi	Peshkopi	Qyteti Peshkopi
				Tomin	Fshatrat; Tomin, Brezhdan, Cetush, Dohoshisht, Pilafe, Pollozhan, Rrashnapojë, Selane, Ushtelenxë, Bahute, Staravec, Shimçan, Zimur, Zdojan
				Melan	Fshatrat; Melan, Cerjan, Rabisht, Zagrad, Begjunec, Trepçë, Grevë, Illicë, Bellovë, Pejkë, Pjeçë, Trenë
				Muhurr	Fshatrat; Muhurr, Bulaç, Fushë-Muhurr, Hurdhë-Muhurr, Rreth-Kale, Shqath, Vajmëdhej
				Luzni	Fshatrat; Katund i Ri, Hotesht, Lishan i Poshtëm, Lishan i Sipërm, Arap i Sipërm, Arap i Poshtëm
				Selishtë	Fshatrat; Selishtë, Kacni, Lukan, Murrë, Qafë-Murrë, Selishtë e Sipërme
		Maqellarë	Maqellarë	Maqellarë	Fshatrat; Maqellarë, Bllatë e Poshtme, Bllatë e Sipërme, Burim, Çernen, Fushë e Vogël, Katund i Vogël, Kërçisht i Sipërm, Kërçisht i Poshtëm, Kllobçisht, Kovashicë, Majtarë, Pocest, Pesjak, Podgorc, Vojnik, Dovolani, Erebarë, Grezhdan, Herbel, Popinar, Gradec
		Kastriot	Kastriot	Kastriot	Fshatrat; Kastriot, Brest i Sipërm, Brest i Poshtëm, Kishavec, Kandër, Kukaj, Vakuf, Fushë-Kastriot, Borovjan, Deshat, Limjan, Sohodoll, Sohodoll i Vogël, Vrenjt, Përgjegje
				Fushë Çidhën	Fshatrat; Fushë Çidhën, Blliqe, Laçe, Rrenz
				Sllovë	Fshatrat; Sllovë, Kallë, Vleshë, Zall-Kalis, Dypjakë, Palaman, Sllatinë, Shumbat, Venisht, Trojak
				Kala e Dodës	Fshatrat; Ceren, Kullas, Ploshtan, Radomirë, Shullan, Tejzë, Ujëmirë, Vasie
		Lurë	Lurë	Lurë	Fshatrat; Fushë-Lurë, Borie-Lurë, Arth, Gurë-Lurë, Lurë e Vjetër, Arrëmollë, Krej-Lurë, Pregj-Lurë, Sumej, Vlashej
				Arras	Fshatrat; Arras, Gur i Zi, Lazrej, Kodër Leshaj, Mustafe, Sinë e Sipërme, Sinë e Poshtme, Çidhën, Grykë Nokë
				Zall-Dardhë	Fshatrat; Zall-Dardhë, Lashkizë, Lugej, Menesh, Nezhaj, Qa, Soricë, Shënleshën, Tartaj
				Zall-Reç	Fshatrat; Zall-Reç, Bardhaj-Reç, Draj-Reç, Gur-Reç, Hurdhë-Reç, Kraj-Reç, Ndërshenë, Qafdraj, Tharkë
		Shupenzë	Shupenzë	Shupenzë	Fshatrat; Shupenzë, Vlashaj, Boçevë, Homesh, Okshatinë, Kovashicë, Zogjaj, Shtushaj, Topojan, Mazhicë, Gjurash, Bllacë
				Ostren	Fshatrat; Ostren i Madh, Radovesh, Kojavec, Lejçan, Orzhanovë, Okshtun i Madh, Oreshnjë, Okshtun i Vogël, Ostren i Vogël, Tuçep, Lladomericë, Pasinkë, Tërbaç
				Trebisht	Fshatrat; Klenjë, Gjinovec, Trebisht-Balaj, Trebisht-Çelebi, Trebisht-Mucinë, Vërnice
		Bulqizë	Qyteti Bulqizë	Bulqizë	Qyteti Bulqizë, Fshatrat; Vajkal nr1, Vajkal nr 2
				Martanesh	Qyteti Krastë, Fshatrat; Gjon, Lenë, Peshk, Val, Stavec, Mëlcu, Ndërfushas
				Fushë-Bulqizë	Fshatrat; Fushë - Bulqizë, Dushaj, Dragua, Koçaj
				Zerqan	Fshatrat; Zerqan, Krajkë, Peladhi, Smollik, Sofraçan, Sopot, Strikçan, Tërnovë e Madhe, Tërnovë e Vogël, Valikardhë, Zall-Sopot, Zall-Strikçan, Godvi
				Gjoricë	Fshatrat; Gjoricë e Sipërme, Gjoricë e Poshtme, Çereneç i Sipërm, Çereneç i Poshtëm, Viçisht, Lubalesh
		Mat	Qyteti Burrel	Burrel	Qyteti Burrel
				Baz	Fshatrat; Baz, Fushë-Baz, Rreth Baz, Karicë, Drita
				Derjan	Fshatrat; Derjan, Urxallë, Barbullej, Dukagjin, Gjoçaj, Lam i Madh, Zall Gjoçaj
				Rukaj	Fshatrat; Bruç, Prellë, Rremull, Rukaj, Laç, Urakë
				Macukull	Fshatrat; Macukull, Dej Macukull, Shëlli, Vig, Shqefën
				Komsi	Fshatrat; Komsi, Kodër Qerre, Frankth, Selixë, German, Batër e Vogël, Batër e Madhe, Midhë, Fshati Burrel, Zall-Shoshaj
				Lis	Fshatrat; Lis, Vinjoll, Gjalish, Burgajet, Zenisht, Shoshaj, Mallunxë
				Ulëz	Fshatrat; Qyteti Ulëz, Kokërdhok, Stojan, Madhesh, Lundre, Bushkash
		Klos	Qyteti Klos	Klos	Qyteti Klos, Fshatrat; Bejnë, Klos Katund, Shëngjin, Plani i Bardhë, Fullqet, Dars, Fshat, Bel, Unjate, Pleshë, Cerrujë, Patin, Bërshi
				Xibër	Fshatrat; Xibër Murriz, Petralbë, Shkallë, Xibër Hane, Gur i Bardhë, Ketë
				Suç	Fshatrat; Kurdari, Kurqelaj, Skënderaj, Suç, Kujtim
				Gurrë	Fshatrat; Rripë, Gurrë e Vogël, Mishtë, Shulbatër, Dom, Gurrë e Madhe

**QARKU DURRËS**

Nr.	Njësi të qeverisjes vendore			Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia			
III.	Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës
					Katundi i ri	Fshatrat; Katundi i Ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik
					Rrashbull	Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanhije, Xhafzotaj,
			Sukth	Sukth	Sukth	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori
					Manëz	Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kameras, Radë, Shkallë, Fshat Manëz
					Ishëm	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjericaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,
			Fushë - Krujë	Fushë - Krujë	Fushë - Krujë	Qyteti Fushë Krujë, Fshatrat; Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luze 2, Larushke 2, Arrameras 2
					Bubq	Fshatrat; Bubq, Bilaj, Budull, Mazhë – Madhe, Mazhë – Vogël, Mallkuç, Murqinë
					Nikël	Fshatrat; Nikël, Tapizë, Qerekë, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurcaj, Zezë
			Shijak	Qyteti Shijak	Shijak	Qyteti Shijak
					Maminas	Fshatrat; Maminas, Karreç, Vlashaj, Karpen, Bodinak, Metallë, Bilalas, Rubjek
					Xhafzotaj	Fshatrat; Xhafzotaj, Pjezë, Rreth, Sallmone, Koxhas, Borake, Guzaj, Vllazërimi
					Gjepalaj	Fshatrat; Gjepalaj, Hardhishtë, Çizmeli, Eminas i Vogël, Likesh, Kënetë, Shtrazë, Shahinaj, Shetëll
			Krujë	Qyteti Krujë	Krujë	Qyteti Krujë, Fshatrat; Barkanesh, Picërragë, Brret
